



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**PROGRAMI I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
2015-2018**

Përmbajtja

A. PARIMET DHE SHTYLLAT E PROGRAMIT QEVERISËS	5
1. ZHVILLIMI EKONOMIK, PUNËSIMI DHE MIRËQENIA	6
1.1. Politika fiskale të favorshme	6
1.1.1. Përshkallëzimi i TVSH-së	7
1.1.2. Ulja e pragut të TVSH-së	7
1.1.3. Pushimet nga taksat	8
1.1.4. Integrimi i ATK-së, DK-së dhe mbledhja e TVSH-së në brendi	8
1.1.5. Lirimet doganore	8
1.2. Politika tregtare konkurruese dhe përmirësimi i mjedisit biznesor	9
1.2.1. Hapja e tregut	9
1.2.2. Funkcionalizimi i zonave të tregtisë së lirë	9
1.2.3. Luftim i ekonomisë joformale	10
1.2.4. Eliminimi i barrierave ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë	11
1.3. Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	11
1.4. Promovimi i investimeve	12
1.4.1. Krijimi i partneriteteve strategjike në fushën e investimeve	13
1.4.2. Lehtësimi dhe promovimi i investimeve nga diaspora	13
1.4.3. Avancimi i partneritetit publiko-privat	15
1.5. Efikasiteti i shpenzimeve, madhësia e sektorit publik dhe rregullat fiskale	15
1.6. Sistemi financiar i qëndrueshëm dhe në funksion të zhvillimit ekonomik	17
1.7. Fondi për Investim dhe Punësim	17
1.8. Investimi në energji, miniera dhe mbrojtja e mjedisit	19
1.8.1. Rregullimi i statusit të Ndërmarrjes “Trepça” nëpërmjet ligjit të veçantë	19
1.8.2. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese	19
1.8.3. Dekomisionimi i kapaciteteve gjeneruese të vjetruara	20
1.8.4. Avancimi i projekteve të ngrohjes qendrore	20
1.8.5. Liberalizimi i tregut energjetik dhe minerar	21
1.8.6. Përfshirja e Kosovës në rrjetin e gazsjellësit	21
1.8.7. Mbrojtja e Mjedisit	21
1.8.8. Masat për përkrahjen e mbrojtjes së mjedisit	21
1.9. Zhvillimi i bujqësisë	21
1.9.1. Masat për përkrahjen e bujqësisë	21
1.9.2. Rritja e fondit për subvencione dhe grante	22
1.9.3. Reformat ligjore për mbrojtje të bujqësisë	22
1.9.4. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore	23
1.9.5. Mbështetja për sektorin e blegtorisë	23
1.9.6. Promovimi i kulturave të reja bujqësore dhe i bujqësisë organike	23
1.9.7. Mbrojtja e resurseve pyjore	24
1.10. Infrastruktura	24
1.10.1. Infrastruktura rrugore	24
1.10.2. Infrastruktura hekurudhore	25
1.11. Telekomunikacioni dhe teknologjia e informacionit	25
1.11.1. Marrja e kodit telefonik shtetëror	25
1.11.2. Privatizimi i VALA-s pas ristrukturimit të nevojshëm	26
1.11.3. Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të telefonisë mobile	26
1.12. Zhvillimi i turizmit	27
1.12.1. Zhvillimi i resorit turistik multifunksional “Brezovica”	28

1.12.2.	<i>Zhvillimi i turizmit rural dhe malor</i>	28
1.12.3.	<i>Mbrojtja e resurseve natyrore</i>	28
1.13.	Përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve publike	29
1.14.	Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe ndërmarrjet shoqërore	30
1.15.	Ujërat	30
1.15.1.	<i>Plani për menaxhimin e ujërave</i>	30
1.15.2.	<i>Trajtimi i ujërave të zeza</i>	31
1.15.3.	<i>Investimet në sistemin e ujitjes</i>	31
1.16.	Politikat sociale, mirëqenia sociale dhe solidariteti ndërshoqëror	31
1.16.1.	<i>Parimet e politikave të mirëqenies sociale</i>	31
1.16.2.	<i>Trajtim i kategorive të veçanta</i>	32
1.16.3.	<i>Ruajtja e standardit të jetës së atyre që varen nga shteti</i>	32
1.16.4.	<i>Promovimi i ndërmarrësisë për të zvogëluar varësinë nga asistenca sociale</i>	33
2.	SUNDIMI I LIGJIT DHE SHTETI LIGJOR	34
2.1.	Avancimi i legjislacionit në fushën e drejtësisë	36
2.2.	Luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar	37
2.3.	Rregullimi dhe unifikimi i drejtësisë civile	38
2.4.	Integrimi i plotë i komunave veriore në sistemin e drejtësisë	38
2.5.	Vazhdimi i reformës së Administratës Publike	38
2.6.	Rritja e transparencës dhe e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje	40
2.7.	Vazhdimi i reformës zgjedhore	40
2.8.	Zbatimi i Strategjisë për Partneritet me Shoqërinë Civile	41
2.9.	Garantimi i lirisë së shprehjes dhe i lirisë së mediave	41
2.10.	Aprovimi i Ligjit për Parandalimin e Pjesëmarrjes në Konfliktet e Jashtme	42
2.11.	Lufta kundër terrorizmit	42
2.12.	Aprovimi i Ligjit për Gjykatën e Posaçme	42
3.	AGJENDA EVROPIANE DHE POLITIKA E JASHTME	43
3.1.	Parimet	43
3.2.	Njohjet	43
3.3.	Integrimi Evropian	44
3.4.	NATO-ja dhe siguria	46
3.5.	Marrëdhëniet shumëpalëshe (multilaterale)	48
3.6.	Partneritetet strategjike	50
3.7.	Politika ndaj rajonit	51
3.8.	Diplomacia ekonomike	54
3.9.	Diaspora	57
3.10.	Diplomacia publike	59
3.11.	Diplomacia parlamentare	60
3.12.	Shërbimi i Jashtëm	60
4.	ARSIMI, SHKENCA, KULTURA, RINIA DHE SPORTI	63
4.1.	Arsimi dhe shkenca	63
4.1.1.	Reformat strukturore në arsim	63
4.1.2.	Rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim	64
4.1.3.	Sigurimi, garantimi dhe rritja e cilësisë së arsimit	65
4.1.4.	Menaxhimi i institucioneve të arsimit	67
4.1.5.	Integrimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	68

4.1.6.	Promovimi i shkencës dhe i hulumtimeve	68
4.1.7.	Financimi i arsimit dhe i shkencës	68
4.2.	Kultura.....	69
4.2.1.	Përkrahja e krijimtarisë kulturore	69
4.2.2.	Përmirësimi i infrastrukturës fizike	71
4.2.3.	<i>Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore</i>	72
4.3.	Rinia	73
4.3.1.	Fuqizimi i rinisë dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje	73
4.4.	Sporti	74
4.4.1.	Zhvillimi, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit	74
4.4.2.	Modernizimi i infrastrukturës sportive	76
5.	SHËNDETËSI MODERNE	78
5.1.	Prioritetet	78
5.2.	Reformimi i Ministrisë së Shëndetësisë	80
5.3.	Financimi i sektorit të shëndetësisë	80
5.4.	Individi në qendër të vëmendjes.....	80
5.5.	Menaxhimi dhe llogaridhënia	80
5.6.	Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve ngjithëse	81
5.7.	Edukimi dhe shkollimi specialistik dhe sub-specialistik.....	81
5.8.	Edukimi publik shëndetësor	81
5.9.	Sektori farmaceutik	81
5.10.	Licencimi dhe Akreditimi i institucioneve shëndetësore	82
5.11.	Zhvillimi i partneritetit dhe dialogu social	82
5.12.	Sektori privat	82
5.13.	Orientimet programore sipas niveleve të shërbimeve shëndetësore	83
5.14.	Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	84

A. PARIMET DHE SHTYLLAT E PROGRAMIT QEVERISËS

Synim parësor i Qeverisë së Republikës së Kosovës është të ndërtojë një qeverisje efektive, kompetente dhe të përgjegjshme, që do të forcojë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë për vitalitetin e Kosovës si shtet i ri dhe i pavarur; të forcojë demokracinë qytetare, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të secilit; të promovojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien nëpërmjet ekonomisë sociale të tregut; të sigurojë lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe të promovojë shoqërinë e dijes; të ndërmarrë politika që e rrisin cilësinë e jetës, që ofrojnë mundësi të barabarta për qasje në arsim e shëndetësi cilësore, në jetën sociale dhe në shërbimet publike përgjithësisht.

Në bazamentin e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në filozofinë e saj vepruese janë vlerat demokratike evropiane, si: respekti për traditën, liria, drejtësia dhe toleranca, transparenca, liria e të shprehurit, liritë individuale dhe kolektive, që paraqesin fundamentin e shoqërisë moderne evropiane të Kosovës. Në të gjitha politikat e saj, Qeveria do të promovojë dhe forcojë vizionin për Kosovën shtet i pavarur, demokratik, dhe i integruar në strukturat euroatlantike. Qeveria do të angazhohet fuqishëm për funksionim të pavarur të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, duke krijuar kushte për ngritje të efikasitetit të tyre.

Qeveria angazhohet që brenda gjashtë muajve të hartojë Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Kosovës për periudhën afatmesme 2015-2020, duke bërë që për herë të parë në historinë e saj Kosova të ketë një strategji gjithëpërfshirëse zhvillimi. Strategjia e re do të fokusohet në politika që stimulojnë rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Strategjia do të reflektojë, në masë të madhe, masat e propozuara në këtë program qeverisës si dhe masa që rrisin aftësinë konkurruese të ekonomisë kosovare në tregun rajonal dhe më gjerë, rritjen e punësimit dhe zhbllokimin e potencialeve për rritje ekonomike që nuk janë shfrytëzuar deri më tani, siç janë minierat, energjetika, teknologjia informative dhe komunikuese, etj. Strategjia do të marrë parasysh kriteret mjedisore në procesin e zhvillimit ekonomik dhe shfrytëzimin afatgjatë të resurseve natyrore që ka Kosova. Strategjia do të nxjerrë në pah rëndësinë e potencialit të kapitalit njerëzor që ka Kosova për promovimin e zhvillimit ekonomik.

Strategjia kombëtare e zhvillimit do të shoqërohet masa për përmirësimin e kapaciteteve institucionale të Kosovës për menaxhimin e politikave zhvillimore. Sa më shumë që Kosova avancon në procesin e integritit evropian, aq më shumë rriten kërkesat për forcimin e kapaciteteve institucionale. Me ndihmën intensive të Komisionit Evropian, Qeveria do të adaptojë një sistem të integruar të planifikimit, si një nga praktikat më të avancuara të vendeve në tranzicion.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përqendrohet në këto shtylla kryesore:

- I. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia;
- II. Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- III. Agjenda evropiane dhe politika e jashtme;
- IV. Arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor; dhe
- V. Shëndetësia moderne.

1. ZHVILLIMI EKONOMIK, PUNËSIMI DHE MIRËQENIA

Zhvillimi ekonomik, promovimi i punësimit dhe rritja e mirëqenies do të bazohen në iniciativën private, konkurrencën dhe tregun e hapur, si forcat kryesore që sigurojnë prosperitet ekonomik. Roli i Qeverisë do të jetë në ofrimin e kornizës institucionale, brenda së cilës zhvillohen aktivitetet ekonomike, me qëllim të sigurimit të kohezionit të brendshëm të ekonomisë dhe të shoqërisë.

Qeveria do të angazhohet fuqishëm për integrimin në tregjet rajonale dhe globale. Do të përmirësohet mjedisi për gjenerimin e ideve ndërmarrëse, për tërheqjen e investimeve të jashtme dhe për promovimin e punësimit, duke siguruar, në të njëjtën kohë, shfrytëzim racional të resurseve për brezat e tanishëm dhe të së ardhmes. Zhdukja e varfërisë do të jetë objektivi qendror i politikave ekonomike dhe sociale.

Qeveria do të punojë shumë për të gjeneruar rritje të qëndrueshme ekonomike, e cila siguron stabilitet makroekonomik, fiskal dhe social, si dhe reformë strukturale ekonomike, ku prodhimi vendës, promovimi i eksportit dhe i dijes do mundësojnë gradualisht zvogëlimin e deficitit tregtar.

Qeveria do të promovojë investimet, duke ulur kostot për bizneset nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës adekuate rrugore dhe hekurudhore, të telekomunikimit, energjisë dhe ujërave. Politikat ekonomike të Qeverisë do të sigurojnë përfshirje aktive në zhvillimin ekonomik të vendit të bashkatdhetarëve tanë që punojnë dhe jetojnë në shtetet e tjera.

Orientimet e lartpërmendura do të bazohen në këto parime fundamentale buxhetore: (i) qëndrueshmëri buxhetore dhe stabiliteti makro-fiskal në fushën e menaxhimit të financave publike; (ii) koherencë në mes të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, duke ndjekur politikën e ngarkesave të ulëta tatimore në interes të zhvillimit të sektorit privat. Fuqizimi i sektorit privat do të vazhdojë të realizohet nëpërmjet hartimit të politikave, të cilat do të derivojnë nga dialogu publiko-privat, me synim që politikat fiskale, tregtare, tërheqjes së investimeve të jashtme, përmirësimit të mjedisit biznesor dhe zhvillimit të fuqisë punëtore, të jenë promotor i rritjes së sektorit privat dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Vazhdimësia në realizimin e reformave strukturore në ekonomi, përkatësisht përshpejtimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi shtetërore dhe promovimi i modeleve të partneritetit publiko privat, me qëllim të tërheqjes së kapitalit të huaj privat dhe përmirësimit të shërbimeve të ofruar për qytetarët e Kosovës, do të jetë komponentë e rëndësishme në kuadër të politikave zhvillimore për realizimin e reformave drejt ekonomisë së tregut.

1.1. Politika fiskale të favorshme

Qeveria do të promovojë politikat fiskale të cilat derivojnë nga objektivat ekonomike, duke stimuluar investimet e reja, punësimin dhe tërheqjen e kapitalit të jashtëm. Sistemi i përshtatshëm tatimor dhe mjedisi i favorshëm biznesor janë shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat në vend. Prandaj, përmirësimi i vazhdueshëm i

sistemit tatimor dhe përputhshmërisë tatimore janë prioritetet themelore të Qeverisë së Kosovës. Kjo ambicie ka për synim zgjerimin e bazës së resurseve për të financuar zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe agjendën e kohezionit social, si dhe në të njëjtën kohë ruajtjen e përparësisë konkurruese të mjedisit biznesor të vendit.

Ne synojmë që me reformim të politikave tatimore të arrijmë:

- Rritje të të hyrave të përgjithshme në buxhet, krahas mbajtjes së niveleve të ulëta tatimore, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme të investimeve të huaja;
- Ruajtje të një mjedisi të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm tatimor, kushte këto të cilat janë të rëndësishme për rritjen e biznesit vendor dhe tërheqjen e investitorëve të huaj;
- Zgjerimin e bazës tatimore nëpërmjet reformës fiskale, si dhe përmirësimet në inkasim nëpërmjet luftimit të zbrazëtirave ligjore dhe evazionit fiskal.

Qeveria do të aplikojë një politikë tatimore të thjeshtë, me procedura të thjeshta të deklarimit të tatimeve, nëpërmjet avancimit të sistemit elektronik të raportimit dhe kontrollit. **Politikat** tatimore do të ruajnë parimet kryesore, siç janë aftësia konkurruese e bizneseve, parashikueshmëria e politikave fiskale, gjithëpërfshirja, drejtësia dhe transparenca. Në fokus do të jetë rritja e vazhdueshme e mirëqenies sociale dhe e standardit jetësor, nëpërmjet rritjes së pagave, pensioneve, kategoritë e dala nga lufta, si dhe skemave sociale.

Qeveria do të punojë në përmbylljen e procesit të fiskalizimit të të gjitha bizneseve, nëpërmjet: ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për pajisje me kuponë fiskalë, duke ofruar stimuj për informatorët në këtë proces; inkurajimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në deklarimet financiare, duke ulur obligimet dhe thjeshtësuar procedurat e raportimeve tatimore. Paralelisht me ngritjen e të hyrave nga tatimi i brendshëm, do të ulet pragu i pagesës së TVSH-së në mënyrë progresive.

1.1.1. Përshkallëzimi i TVSH-së

Qeveria gjatë pjesës së parë të mandatit do të shqyrtojë përshkallëzimin e TVSH-së. Një veprim i tillë kërkon ndërmarrjen e analizave dhe vlerësimeve për të përcaktuar se cilat produkte bazike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve do të lirohen nga TVSH-ja. Kjo do të nënkuptonte uljen e normës së TVSH-së për produktet bazike, si: buka, qumështi, vaji, uji i pijshëm etj., në përputhje me praktikën më të mira dhe direktivat e Bashkimit Evropian lidhur me këtë çështje. Në të njëjtën kohë, mbajtja e TVSH në 0% për produktet primare bujqësore do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e prodhimit dhe në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, duke bërë zëvendësimin e produkteve të importuara me ato vendore.

1.1.2. Ulja e pragut të TVSH-së

Duke pasur parasysh që një numër i konsiderueshëm i bizneseve janë të kategorizuara nën pragun aktual të TVSH-së prej 50,000 euro, ulja e pragut do të kontribuonte në përmirësimin e konkurrencës të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në këtë kontekst, Qeveria do të angazhohet për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në funksion të uljes së pragut të

TVSH-së deri në 20,000 euro, e cila do t'u mundësojë shumë bizneseve që të operojnë më lehtë dhe të rriten. Kjo do të rriste bazën tatimore për rreth 1,500 biznese dhe do të krijonte të hyra shtesë. Çdo ulje e pragut do të bëhet në harmonizim të plotë me ngritjen e kapaciteteve të ATK-së për t'u ballafaquar me një volum më të shtuar të punës. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet ruajtjes së thjeshtësisë të sistemit tatimor të Kosovës, faktor ky me të cilin është karakterizuar Kosova deri më tani.

1.1.3. Pushimet nga taksat

Në kuadër të politikave tatimore, do të aplikohen pushimet tatimore për bizneset që investojnë një shumë të konsiderueshme dhe gjenerojnë vende të reja të punës. Kjo politikë do të kontribuojë në zhvillimin e mëtutjeshëm të ndërmarrjeve të reja dhe stimulimin e investimeve të reja në vend, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Është parim i përgjithshëm i pushimeve tatimore që ato funksionojnë më së miri kur e kanë afatin e skadencës të përcaktuar. Këto politika nxisin investime të reja, hapin vende të reja të punës, gjenerojnë rritje ekonomike dhe përmirësojnë mirëqenien sociale. Duke marrë parasysh përvojat më të mira ndërkombëtare dhe me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, do të përgatitet një pako për investitorë që do të lirojë ata nga tatimi në korporata dhe nga pagesa e TVSH-së për investimet kapitale në varësi të nivelit të investimeve që bëjnë dhe numrit të vendeve të punës që hapin.

1.1.4. Integrimi i ATK-së, DK-së dhe mbledhja e TVSH-së në brendi

Brenda tri vitesh do të ngritën kapacitetet administrative për zhvendosjen graduale të grumbullimit të TVSH-së nga kufiri në brendi të vendit, pas shitjes së mallrave. Kjo do të lehtësojë barrën e bizneseve dhe do të rrisë likuiditetin e tyre.

Në këtë drejtim, vazhdimësia e reformimit të dy organeve kryesore për grumbullimin e të hyrave, Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës, do të bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave për komunitetin e biznesit nëpërmjet komunikimit dhe dialogut publiko-privat dhe promovimit të konkurrencës së drejtë në treg, duke trajtuar të gjitha subjektet juridike në mënyrë të barabartë. Planifikohet që gjatë mandatit të ardhshëm të bëhet unifikimi i këtyre dy administratave në një Agjenci të përbashkët për grumbullimin e të hyrave tatimore në vend. Shkrija e ATK-së dhe Doganës në një autoritet të vetëm të të hyrave do të bëhet në harmoni me proceset e integritit, meqë tarifatat doganore do të eliminohen me shumicën e partnerëve kryesorë tregtarë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve për tregti të lirë.

1.1.5. Lirimet doganore

Do të lirohet nga çfarëdo obligimi doganor importi i pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit. Këto pajisje përdoren sidomos nga brezi i ri në sektorin e shërbimeve. Kjo do ta mënjanojë ekonominë e zezë në këtë sektor, që vlerësohet të jetë rreth 20% e këtij sektori. Heqja e ngarkesës doganore për këto pajisje do të sigurojë rreth 30% rritje të këtij sektori.

1.2. Politika tregtare konkurruese dhe përmirësimi i mjedisit biznesor

1.2.1. Hapja e tregut

Rregullimi Kushtetues i ekonomisë së Republikës së Kosovës bazohet në parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë regjim tregtar liberal që bazohet në parimet e ekonomisë së tregut, me konkurrencë të lirë e që favorizon hapjen e tregjeve, si e vetmja mundësi për ngritje të qëndrueshme të aftësisë konkurruese. Marrëveshjet bilaterale të bashkëpunimit doganor do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shënimeve dhe deklarimit të rregullt të mallit sipas çmimeve reale me shtetet kryesore me të cilat kemi marrëdhënie tregtare substanciale. Thjeshtëzimi i mëturjeshëm i procedurave doganore me Shqipërinë do të jetë prioritet i përafritimit të ekonomive tona. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë t'i përmbahet, dhe besojë fuqishëm në parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, përfshirë zbatimin e vazhdueshëm të një regjimi liberal tregtar.

Në fushën e politikave tregtare, do të ndërmerren këto veprime, masa dhe instrumente:

- Hartimi i Planit Operacional dhe aplikimi për anëtarësim në Organizatën Botërore të Tregtisë, përfshirë hartimin dhe implementimin e legjislacionit të nevojshëm;
- Harmonizimi i legjislacionit tregtar me atë të Bashkimit Evropian, si pjesë integrale e MSA-së, përfshirë procedurat dhe marrëveshjet për “Njohje dhe Pranim të Përbashkët” të produkteve kosovare, veçanërisht të certifikatave përcjellëse sanitare, fitosanitare dhe atyre të sigurisë së produkteve ushqimore, duke mundësuar kështu eksport të lehtë të produkteve kosovare në tregjet rajonale dhe evropiane;
- Zgjerim të vazhdueshëm të listës së lirimeve doganore për produktet që prodhohen në sektorët me aftësi konkurruese;
- Stimulim financiar nga Fondi për Investim dhe Punësim për standardizim dhe certifikim ndërkombëtar për produktet që kanë potencial për eksport, si dhe ngritje të cilësisë dhe numrit të fuqisë punëtore të top 100 ndërmarrjet eksportuese;
- Lehtësim të tregtisë me vendet e rajonit nëpërmjet zbatimit të procedurave të thjeshtëzuara të importit dhe sistemit të Menaxhimit të Integruar të kufirit;
- Modernizim dhe rritje të efikasitetit të shërbimeve të Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinës;
- Anëtarësim në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare për standardizim.

1.2.2. Funkcionalizimi i zonave të tregtisë së lirë

Qeveria synon që nëpërmjet funksionalizimit të zonave të lira të krijohet hapësirë për bizneset që të operojnë me kosto më të favorshme. Qeveria gjatë katër viteve do t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, në mënyrë që t'i vejë në funksion zonat e lira ekonomike në Drenas, Gjakovë, Rahovec, Mitrovicë, Prizren dhe komuna tjera që do të shprehin interesim për jetësimin e një koncepti të tillë për investime të reja për kompani vendore dhe të huaja. Në këto zona do të caktohet edhe një kuotë (përqindje) për investimet që kanë prejardhje nga diaspora. Mitrovica në të kaluarën ka pasur një reputacion për industrinë e rëndë, të cilën mund ta rikthejë me revitalizimin e Trepçës dhe industrisë përcjellëse që është ndërtuar rreth saj, ku zona e lirë ekonomike do të ndikonte si katalizator në zhvillimin e tërë rajonit.

Gjakova, po ashtu, ka gëzuar një gamë të gjerë të bizneseve në industrinë e lehtë, i cili do të rikthehet me funksionalizimin e zonës së lirë ekonomike. Prizreni shquhet për numër të koncentruar të bizneseve artizanale, të cilat do të mund të zhvillohen me funksionalizimin e zonës së lirë të shpallur në këtë komunë.

1.2.3. Luftim i ekonomisë joformale

Prania e ekonomisë joformale është një ndër pengesat kryesore të rritjes së mëtutjeshme të ekonomisë. Në mungesë të konkurrencës së lirë, penalizohen bizneset e ndershme dhe konsumatori nuk është i mbrojtur. Qeveria gjatë këtij mandati do të ketë në fokus reduktimin e shkallës së ekonomisë joformale në vend, në nivelin e mesatares së Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, konform Strategjisë Kombëtare për Luftimin dhe Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare, si dhe në bazë të vlerësimit të ekonomisë joformale nga ana e ekspertëve të BE-së, do të punohet në ngritjen e vetëdijes mbi ndikimet e ekonomisë joformale dhe krimit financiar; forcimin e luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar, duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqëror; ndjekja penale efikase e veprimeve që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare; aplikimi i një qasjeje proaktive për bashkëpunim ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare; si dhe zhvillimi i legjislacionit kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas.

Qeveria nuk e sheh formalizimin e ekonomisë vetëm te forcimi i masave represive. Qeveria do të sigurojë gjithashtu stimuj dhe masa favorizuese, në mënyrë që të motivohen sipërmarrësit dhe punëtorët që të formalizohen. Prania e ekonomisë jo-formale është shpesh një dëshmi e rregullimeve dhe burokracive të tepruara, barrës fiskale apo mungesës së hapësirave të kreditimit. Qeveria do të përkushtohet të adresojë këto probleme, me theks të veçantë në sigurimin e mundësive të reja të kreditimit, të cilat do të shërbejnë si shtysë për bizneset që të formalizohen, dhe nëpërmjet kësaj të sigurojnë huamarrjen.

Ndër të tjera masat të cilat do të ndërmerren me qëllim të parandalimit dhe luftimit të ekonomisë jo-formale përfshijnë:

- i) Prezantimi i pakos së re tatimore, e diskutuar më sipër, duke synuar nxitjen e bizneseve të veprojnë në sektorin formal të ekonomisë;
- ii) Plotësimi i zbrazëtirave ligjore në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- iii) Fuqizimi i kapaciteteve institucionale si ATK, Doganat dhe institucionet tjera të cilat e mbikëqyrin funksionimin e bizneseve;
- iv) Rritja e bashkëpunimit ndër-institucional për të siguruar se bizneset operojnë në sektorin formal;
- v) Në sektorët ku ekonomia joformale është e lartë, si ndërtimtaria, do të vendoset një sistem kompleks i mbikëqyrjes së kompanive sa i përket punësimit të punëtorëve, qarkullimit të mallrave ndërtimore dhe kryerjes së punëve ndërtimore;

- vi) Në sektorin e hotelerisë, do të mbikëqyret dhe krahasohet punësimi i punëtorëve, qarkullimi i të ardhurave dhe i mallrave të përdorura, për të vlerësuar raportimin e drejtë të tatimit;
- vii) Në sektorin e shërbimeve (avokatët, shëndetësi, kontabilistët, auditorët, zhvilluesit e programeve softuerike, arkitektët, agjencitë e ndryshme, profesionet e tjera shërbyese etj.) do të futen në sektorin formal nëpërmjet një njësie të veçantë të Administratës Tatimore, e cila do t'i mbikëqyrë këto veprimtari;
- viii) Procesi i fiskalizimit do të vazhdojë konform strategjisë për fiskalizim, me ç' rast do të krijohen kushtet për konkurrencë të drejtë dhe të barabartë në treg;
- ix) Do të rishikohet sistemi i furnizimit, pajisjes dhe mirëmbajtjes së arkave fiskale. Një udhëzim i ri administrativ do t'i përcaktojë standardet për arka fiskale, varësisht prej llojit të biznesit, i cili do të liberalizojë plotësisht furnizimin me arka fiskale;
- x) Do të punohen në zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes së Brukselit, për të shtrirë kontrollin e plotë në pikat doganore në Jarinjë dhe Bërnjak, të cilat nuk kanë kontribuar në buxhetin e shtetit dhe kanë qenë burim kontrabande dhe ekonomisë jo-formale..

1.2.4. Eliminimi i barrierave ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë

Qeveria do të punojë në reforma në plotësimin dhe implementimin e legjislacionit për themelimin, funksionimin dhe mbylljen e bizneseve. Procedurat për t'u pajisur me leje të ndërtimit do të shkurtohen gjatë 4 viteve të ardhshme të Qeverisë. Qeveria do të vazhdojë të kërkojë nga Komunitat që të ulin kostot e njëhershme për leje ndërtimore dhe në të njëjtën kohë të reflektoj në trendët rajonale të tatimit në pronë. Qeveria do të thjeshtësojë procedurat dhe kostot për kyçe në rrjetin energjetik dhe në shërbimet e tjera publike për bizneset.

Korniza ligjore do të vlerësohet në baza të rregullta për efektet e saj dhe të ndryshojë në përputhje me zhvillimet në treg. Do të rritet roli i autoriteteve lokale në ofrimin e lehtësirave të bërit biznes, duke mundësuar kornizë ligjore të decentralizuar dhe diskresion të nevojshëm të autoriteteve lokale, për të nxitur garën e tyre në tërheqje të bizneseve në lokalitetet e tyre. Regjistrimi i bizneseve do të decentralizohet plotësisht dhe do të kalojë tek autoritetet lokale. Autoritete lokale do të kenë kompetenca të zgjeruara për dhënien e tokave me qira për investitorët, në përputhje me kriteret që përcaktohen me ligje dhe udhëzime administrative të veçanta nga ana e institucioneve qendrore.

1.3. Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Gjeneratori kryesor i rritjes ekonomike dhe vendeve të punës do të jetë sektori privat, në veçanti ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), nëpërmjet politikave që mundësojnë rritjen e investimeve të bizneseve, sidomos në prodhimtari dhe shërbime me vlerë të lartë shtuese. Do të avancohet ekonomia e dijes dhe aftësitë konkurruese vendëse, do të stimulohet prodhimi vendës dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve vendëse, si hap i parë drejt zvogëlimit të varësisë nga importet. Do të ndërmerren politika që rrisin kapacitetet prodhuese, vendet e punës, përmirësojnë bilancin tregtar, si dhe politika që e bëjnë Kosovën vend destinimi për investitorë të jashtëm. Në mënyrë specifike:

- Do të ndahet një fond i veçantë për bashkëfinancimin e projekteve investive të firmave vendore, kryesisht të NVM-ve, kur këto firma arrijnë të thithin donacione ndërkombëtare, sidomos në sektorët e Teknologjisë Informative (TI), në hulumtime, në ide inovative, në shërbime, prodhim dhe bujqësi;
- Do të mobilizohen mjetet e lira të fondeve të privatizimit në sistemin financiar, mobilizimit të fondeve të diasporës dhe linjave kreditore me institucionet financiare dhe ndërkombëtare, për të mbështetur investimet private;
- Do të ngritën kapacitetet e inkubatorëve të biznesit për firmat në sektorin e Teknologjisë Informative (TI) dhe të shërbimeve në përgjithësi, në të cilat Kosova ka filluar të përfshihet fuqishëm në tregun ndërkombëtar. Këta inkubatorë do të vendosen në parqet e biznesit dhe do të përfitojnë nga lirimet tatimore;
- Do të funksionalizohen zonat industriale nëpërmjet avancimit të mënyrës së menaxhimit të tyre bazuar në partneritetin publiko-privat. Bizneset nga diaspora në veçanti do të kenë prioritet të vendosen në zona industriale;
- Do të punohet në fuqizimin e mëtutjeshëm të Agjencisë për Promovimin e Investimeve dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve, në kuadër të MTI-së, përmes krijimit të një njësie të re për t'i mbështetur idetë ndërmarrëse të rinjve në veçanti, nëpërmjet konsulencës për regjistrimin e biznesit dhe konsulencës financiare. Kjo njësi e re do të menaxhojë gjithashtu një skemë për bashkëfinancimin e kredive që marrin bizneset fillestare në sektorë të caktuar;
- Do të fuqizohen të drejtat nga pronësia industriale dhe ajo intelektuale nëpërmjet avancimit të bazës ligjore dhe zbatimit efektiv të ligjit, në përputhje me standardet evropiane;
- Do të rritet efikasiteti i funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe të mbrojtjes së investitorëve, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të gjykatave vendëse në trajtimin efikas dhe në kohë rekorde të lëndëve që lidhen me bizneset.

1.4. Promovimi i investimeve

Orientimet strategjike të platformës për promovim të investimeve kanë të bëjnë me fuqizimin e sektorit privat dhe nxitjen e investimeve, duke përfshirë investimet e huaja direkt. Institucionet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), siç janë Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare, Agjencia Kosovare e Standardizimit do të jenë në funksion të përmbushjes së këtyre orientimeve strategjike. Në këtë drejtim do të shfrytëzohen edhe potencialet e Ministrisë së Diasporës, e sidomos rrjetet e biznesit që i ka krijuar në diasporë. Për të arritur këtë Qeveria e Kosovës gjatë këtij mandati do të fokusohet në:

- Shfrytëzimin e rritjes së madhësisë së tregut, si rrjedhojë e zbatimit të MSA-së, për promovim të investimeve strategjike në ekonomi;
- Kryerjen e studimeve dhe analizave për përparësitë konkurruese në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe aplikimin e masave stimuluese në këta sektorë;
- Përgatitjen dhe zbatimin e trajnimeve profesionale në të gjithë sektorët, regjionet dhe ndërmarrjet me potencial konkurrues, me theks të veçantë përmes mekanizmave të Fondit për Investim dhe Punësim;

- vazhdimin e dinamikës në reformën e të bërit biznes, sidomos nëpërmjet reformave konkrete që mundësojnë siguri të qartë juridike për investitorët.

1.4.1. Krijimi i partneriteteve strategjike në fushën e investimeve

Qeveria e Kosovës ka nënshkruar partneritetin strategjik me Shqipërinë, që mbështetet në katër shtylla: Politika e Jashtme dhe e Sigurisë, Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme, Ekonomia, Energjia, Transporti, Turizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit, Kultura, Arsimi dhe Shkenca, si dhe Marrëveshjen për bashkëpunim në sektorin e Teknologjisë Informative dhe Komunikuese. Strategjia e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik do të përbëjë përkushtim kryesor të dy Qeverive, duke synuar që të ofrojnë një klimë nxitëse për bizneset, në një treg të integruar, duke shfrytëzuar në mënyrë efektive e racionale potencialet e përbashkëta. Do të synohet oferta e përbashkët e një tregu të integruar për investimet nga diaspora shqiptare. Një theks i veçantë do t'i kushtohet energjetikës, duke komplementuar sistemet e dy vendeve hidro dhe termo dhe duke vendosur një sistem të përbashkët energjetik. Po ashtu, do të ndërtojmë bashkëpunim të ngushtë strategjik me vendet fqinjë dhe shtetet e Bashkimit Evropian për sektor të caktuar siç janë: Energjia, Transporti, Mbrojtja e Mjedisit, Teknologjia Informative dhe Komunikuese, Arsimi dhe Shkenca, Siguria etj.

1.4.2. Lehtësimi dhe promovimi i investimeve nga diaspora

Kosova konsiderohet si një nga vendet me diasporën më të madhe, me një potencial të jashtëzakonshëm për të kontribuar për zhvillimin e Kosovës. Diaspora kosovare ka luajtur një rol thelbësor gjatë historisë sonë dhe ka dhënë kontribut të çmuar për mbijetesën e vendit, qëndresën ndaj okupatorit, si dhe në zhvillimin ekonomik përgjatë dekadave. Kontributi kryesor i diasporës është nëpërmjet dërgesave (remitencave) për të ndihmuar mirëqenien e familjeve kosovare. Tashmë është dëshmuar se diaspora ka krijuar potencial shumë të madh dhe përfaqëson vlera të larta për vendin. Gjithashtu, nga përvojat e vendeve të tjera është dëshmuar se ky potencial i krijuar jashtë vendit mund të ketë rol shumë të madh në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Qeveria e Kosovës do të punojë që investimi nga diaspora të jetë me përfitim të dyanshëm, në njërën anë të krijohen kushtet që investitorët nga diaspora të gjejnë në Kosovë një ambient të përshtatshëm për të afaruar dhe fituar, dhe njëkohësisht që ky investim të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Qeveria e Kosovës të angazhohet maksimalisht për ta shndërruar potencialin ekonomik të Diasporës në një mundësi të jashtëzakonshme për tërheqje të investimeve nga Diaspora, pjesëtarë të së cilës tanimë kanë bërë emër në biznes dhe ndërmarrësi kudo në botë. Aktualisht remitencat në Kosovës kapin shifrat prej 13% të Bruto Produktit Vendor, ndërsa shumë pak janë të dedikuara për investime. Gjatë katër viteve të ardhshme duhet të rritet pjesa e remitencave që dedikohet për investime, në mënyrë që të gjenerohen vende pune dhe zhvillim ekonomik, duke përfshirë sektorin e prodhimit, shërbimeve dhe të bizneseve familjare.

Në këtë drejtim, Qeveria do të vazhdojë të promovoj lehtësira për Diasporën për hapjen dhe fillimin e bizneseve në Kosovë, duke siguruar mbrojtjen e investimeve të tyre nëpërmjet aplikimit të fondeve përkatëse për mbështetjen e bizneseve (Fondi për Garantimin e Kredive).

Paralelisht duhet të identifikohen investitorët nga Diaspora, meqë ata ende figurojnë në listën e përbashkët të investimeve të huaja në Kosovë dhe nuk dihet numri i saktë i tyre. Institucionet përgjegjëse, si Agjencia për Promovimin e Investimeve dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve duhet të shtojë përpjekjet institucionale në koordinimin e aktiviteteve për promovimin e investimeve nga Diaspora, përkatësisht ofrimin e shërbimeve mbështetëse të biznesit lidhur me mundësitë e investimeve në Kosovë, si dhe në organizimin e rregullt të forumeve, konferencave dhe panairove të biznesit në Diasporë dhe në Kosovë.

Qeveria e Kosovës do të ndërmerr masa specifike legjislative për lehtësimin e investimeve nga diaspora. Këto masa përfshijnë: lirimi nga taksa në korporatë, lirimi nga detyrimet e importit, pajisje dhe lëndën e parë të nevojitur për investime, zvogëlimi i numrit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit; Lehtësimi i procedurave dhe ulja e kostos për përfshirje në energji elektrike; Lehtësimi i procedurave për marrjen e tokës publike në shfrytëzim; krijimi i lehtësive kontraktuale me disa shtete, në të cilat jeton pjesa më e madhe e diasporës; marrëveshjet lidhur me evitimin e tatimit të dyfishtë; mbrojtja dhe promovimi i investimeve (nënshkrimi dhe marrëveshjet ndërshtetërore), krijimi i një dhome të veçantë në Gjykatën Themelore të Prishtinës që do t'i trajtonte kontestet e investitorëve të huaj, përfshirë investitorët nga diaspora, si dhe garantimi i investimeve të huaja nga shteti i Kosovës; Promovimi i praktikave të mira dhe i shërbimeve për të gjetur bashkinvestitorë nga Kosova.

Objekti i Qeverisë për lehtësimin dhe përfshirjes e diasporës në ekonominë e Kosovës do të zbatohet nëpërmjet krijimit të lehtësirave të ndryshme për investime, themelimin Fondi për Investim dhe Punësim, zhvillimit të sektorit të teknologjisë informative dhe komunikuese, bujqësisë, mineraleve, industrisë, arsimit, kulturës, sportit dhe shumë fusha të tjera.

Qeveria e Kosovës deri më tani ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt lidhjeve më të fuqishme me diasporën, në kuptimin e kornizës legjislative dhe institucionale. Qeveria e Kosovës do të punojë në këto drejtime:

- Zgjerimin dhe fuqizimin e rrjeteve ekzistuese të biznesit si dhe të unionit të tyre, për të shërbyer si lidhja e parë direkte me investitorët nga diaspora dhe ata të huaj;
- Në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që hasin investitorët nga diaspora kur investojnë në Kosovë;
- Krijimit të lehtësirave për të investuar në sektorin e shërbimeve, sidomos të shërbimeve të IT-të, bujqësisë, turizmit, mineraleve, industrisë, arsimit, kulturës, sportit dhe shumë fusha të tjera;
- Caktimit të një kuote për bizneset nga diaspora në zonat industriale;
- Caktimin e një përqindjeje nga Fondi për Investim dhe Punësim edhe për projektet investuese nga diaspora;
- Shfrytëzimin e potencialit intelektual dhe akademik të diasporës, për ta vendosur në funksion të zhvillimit të vendit dhe shkëmbimit të përvojave të fituara në vende të ndryshme;
- Saktësimin e statistikave zyrtare se cilat janë investimet e deritanishme nga diaspora, sepse deri më tani ato figurojnë në kuadër të investimeve të huaja në Kosovë, andaj

pak mund të thuhet se sa realisht ka investime në Kosovë. Një statistikë e tillë do të ndihmonte në specifikimin e politikave të tërheqjes së investimeve nga diaspora.

Në funksion të koordinimit të politikave për investimet nga diaspora do të krijohet Komiteti Ndërministror për Investimet nga Diaspora. Ky komitet ndërinstitucional do të operacionalizojë objektivat e këtij programi qeverisës, do të hartojë politikat e promovimit të koordinuar të përparësive që ofron Kosova për bizneset nga diaspora, do të punojë në identifikimin e barrierave për bizneset nga diaspora dhe heqjen e tyre, do të trajtojë ankesat që kanë bizneset të cilat kanë investuar në Kosovë etj.

Në këtë drejtim do të punohet gjithashtu që të krijohet një kornizë ligjore financiare për të mundësuar dhe promovuar bashkëpunimin në biznes në mes të diasporës dhe bizneseve kosovare, si dhe mobilizim të kursimeve të diasporës në tregun financiar kosovar nëpërmjet një sistemi të integruar dhe funksional ligjor dhe financiar, që mbron të drejtat e pronarëve dhe që siguron pacenueshmërinë e interesave, pronës dhe të drejtave të investitorëve dhe depozituesve.

1.4.3. Avancimi i partneritetit publiko-privat

Gjatë këtij mandati të qeverisjes, do të fuqizojmë Dialogun Publiko-Privat, me asociacionet e biznesit, nëpërmjet operacionalizimit të vazhdueshëm të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, duke hartuar dhe zbatuar Plane Afatshkurta dhe Afatmesme të reformave ekonomike në sektorët me aftësi konkurruese. Gjithashtu, do të fuqizohet mekanizmi i bashkëpunimit ATK-Doganë-Biznes, nëpërmjet Këshillit Konsultativ Ministri e Financave - Doganë –ATK –Biznes. Ndërsa pranë Zyrës së Kryeministrit do të themelohet Këshilli i Investitorëve të Huaj, me qëllim të ofrimit të garancive me të larta institucionale për investitorët aktualë dhe potencialë. Do të punohet në drejtim të promovimit sa më të madh të partneritetit publiko-privat nga ana e pushtetit lokal, nëpërmjet një legjislacioni adekuat dhe efikas.

1.5. Efikasiteti i shpenzimeve, madhësia e sektorit publik dhe rregullat fiskale

Qeveria do të angazhohet për një sektor publik të vogël dhe efikas, me dikastere qeveritare që janë funksionale dhe të madhësisë optimale, në përputhje me nevojat për shërbime ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Qeveria beson në politika buxhetore që ruajnë qëndrueshmërinë e buxhetit shtetëror. Ne do të angazhohemi për një disiplinë financiare sa i përket buxhetit të shtetit. Kjo qasje siguron drejtësi në shpërndarjen e barrës fiskale. Qeveria do të angazhohet për transparencë të plotë në shpenzimin e parasë publike, duke ua kthyer parane taksapaguesve nëpërmjet shërbimeve publike cilësore në arsim, shëndetësi, infrastrukturë dhe në funksionimin efikas të pushtetit qendror dhe lokal.

Në veçanti, do t'u jepet përparësi shpenzimeve kapitale që të prodhojnë efekte maksimale për ekonominë vendëse dhe përfitime të barabarta për të gjithë qytetarët. Organizatat buxhetore, të cilat funksionojnë me mision të ngjashëm dhe që kanë krijuar dualizëm me ministrinë përkatëse, do të shuhën ose do të integrohen në ministrinë përkatëse. Do të rishikohet funksionimi i të gjitha agjencive të pavarura.

Do të aplikohet plotësisht prokurimi elektronik në shpenzimin e parasë publike që bëhet nëpërmjet tenderimit. Kjo do të kursejë rreth 12% të shpenzimeve publike në projekte tenderuese dhe zvogëlim të shpenzimeve administrative deri në 30%. Do të analizohet mundësia e aplikimit të çmimeve referente të prokurimeve publike. Duke aplikuar këto reforma në prokurim, pra edhe prokurimin elektronik, mundësohet rritja e efikasitetit, transparencës, cilësisë së punëve dhe materialeve, shmangja e procedurave të komplikuar dhe shtohet vlera e parave. Dorëzimi i dokumentit tenderues, procedurat e vlerësimit dhe të gjitha hapat e tjerë do të jenë plotësisht transparentë. Kjo do të mundësojë eliminim të plotë të kontaktit të zyrtarëve të prokurimit me operatorët ekonomikë. Puna e secilit zyrtar do të jetë e gjurmueshme dhe transparente. Organet mbikëqyrëse të prokurimit publik do të mund të mbikëqyrin të gjitha proceset, e jo vetëm ato ku paraqiten ankesa nga operatorët ekonomikë. Do të aplikohet një sistem i ri-licencimit të zyrtarëve që punojnë në fushën e prokurimit publik. Do të ndërmerren tenderime gjithëpërfshirëse për mallra dhe shërbime që përdoren nga të gjitha autoritetet kontraktuese, për të mundësuar ekonomizimin e shkallës dhe uljen e çmimit të furnizimit.

Do të zbatohet projekti i E-Qeverisjes në të gjitha nivelet. Në arsim do të ndërliidhen të dhënat për shkolla në të gjitha komunat, për ta përcjellë progresin e nxënësve në secilën shkollë, efikasitetin e funksionimit të shkollave, punën e mësimit dhe nxënësve etj. Në shëndetësi do të finalizohet sistemi informativ shëndetësor. Ky sistem do të mundësojë evidencë të saktë të incidencës të sëmundjeve të ndryshme, caktimin e mjekëve të përgjithshëm për secilin qytetar dhe përcjelljen e historikut të kontrolleve shëndetësore të secilit qytetar.

Pas përfundimit të programit aktual me Fondin Monetar Ndërkombëtar, është e nevojshme të vazhdohet me një program të ri, i cili do të reflektonte pjekurinë institucionale të Kosovës. Pjesë e këtij programi është rregulla fiskale, që ka për qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së borxhit publik. Limiti i borxhit publik sipas ligjit të borxhit publik është 40% e Bruto Produktit Vendor dhe borxhi aktual arrin 10%.

Në mënyrë që të ruajmë stabilitetin makro-fiskal, Qeveria do të vazhdojë të mbajë deficitin buxhetor brenda rregullës fiskale prej 2% të Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ky deficit do të financohet kryesisht nga borxhi i jashtëm. Borxhi i jashtëm i institucioneve financiare ndërkombëtare është më afatgjatë dhe ofron norma të favorshme krahasuar me huazimin me norma komerciale. Nëpërmjet kësaj forme të mbulimit të deficitit buxhetor evitohet mbingarkesa e tregut vendorë të kreditimit dhe rritja e normës së interesit në tregun financiar vendor.

Qeveria e Kosovës do të punojë kujdesshëm sa i përket emetimit të letrave me vlerë, që ka filluar më 2012 dhe ka arritur **shtrirje** të maturitetit në letra me vlerë 2-vjeçare, si dhe zgjerimin e tregut primar për të përfshirë Trustin Pensional. Qeveria do të ndërmarrë hapat e nevojshme për funksionalizimin e tregut sekondar.

1.6. Sistemi financiar i qëndrueshëm dhe në funksion të zhvillimit ekonomik

Pavarësisht krizës globale financiare, Kosova ka pasur një stabilitet në tregun financiar. Shumë sektorë vazhdojnë të përballen me vështirësi për të siguruar financim adekuat për zhvillimin e biznesit. Vihet re një kërkesë shumë e madhe për kreditim dhe bankat, me gjithë stabilitetin financiar, profitabilitetin dhe likuiditetin, vazhdojnë të ofrojnë kredi me norma të larta të interesit, krahasuar me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian. Përkundër angazhimit të Qeverisë në anëtarësimin e Republikës së Kosovës në mekanizmat financiar ndërkombëtar (FMN, BB, BERZH), Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, nënshkrimit të marrëveshjes kornizë me Bankën Investive Evropiane, sektori privat ka nevojë për rritje të portfolios së kreditimit nga bankat komerciale me kushte më të favorshme. Për të adresuar këtë Qeveria e Kosovës do të ndërmarr veprime që përfshijnë:

- Zhvillimin e politikave për mobilizim të plotë të kursimeve financiare nga fondi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore;
- Krijimin e stimuljeve për mobilizim të kursimeve nga diaspora dhe kursimeve të tjera të qytetarëve dhe bizneseve. Këto fonde mund të vihen në funksion vetëm nëpërmjet një sistemi të integruar dhe funksional ligjor dhe financiar që mbron të drejtat e depozituesve, duke fuqizuar rolin mbikëqyrës të Bankës Qendrore;
- Anëtarësimin me të drejta të plota të Bankës Qendrore të Kosovës në Bankën Qendrore Evropiane;
- Eliminimin e çdo forme të cenimit të konkurrencës në tregun e bankave dhe të sigurimeve;
- Ndërmarrjen e vlerësimit kreditor të Kosovës dhe publikimin e informacionit mbi vlerësimin kreditor të vendit;
- Krijimin e parakushteve që normat e interesit në vend të bien në numra njëshifrorë. Përmes kësaj synohet motivimi i bizneseve, sidomos ndërmarrësit e rinj, nëpërmjet rritjes së ofertës kreditore, forcimit të konkurrencës në tregun kreditor, forcimit të së drejtës pronësore, vlerësimit më të mirë të kolateralit, njësi të veçantë në kuadër të gjykatave për kontestet që lidhen me kreditë bankare, etj.

1.7. Fondi për Investim dhe Punësim

Fondi për Investim dhe Punësim synon të kontribuojë në rritjen ekonomike të Kosovës, krijimin e vendeve të reja të punës, përmirësimin e qasjes në financa me kushte të volitshme për sipërmarrësit e rinj, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe korporatat. Kjo do të arrihet duke iu ofruar bizneseve fillestare qasje në financa, kredi më të lira ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe korporatave që synojnë t'i zgjerojnë bizneset e tyre. Investimet nga Fondi do të përqendrohen posaçërisht në aktivitetet ekonomike, që do të synojnë të rrisin punësimin, prodhimin dhe eksportin. Fondi pritet të krijojë edhe efekte të tërthorta, duke joshur investime të huaja direkte dhe duke krijuar biznese tjera në kuadër të zinxhirit të ofertave. Këto efekte do të rrisin besimin në ekonomi dhe do të ofrojnë stimulje për investime të tjera nga agjentë tjerë ekonomikë. Për më tepër, një rritje në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve pritet të zëvendësojë importet me prodhime vendore dhe do të rrisë eksportet. Gjithashtu, këto efekte do të kontribuojnë në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës dhe në zvogëlimin e varësisë nga remitencat dhe ndihma e huaj.

Nëpërmjet këtij Fondi, do të krijohen parakushtet për përkrahjen e sektorit privat, si dhe organizatat përgjegjëse për zhvillim ekonomik. Fondi destinohet për këto qëllime:

- Ofrimin e asistencës financiare në drejtim të përkrahjes së programeve trajnuese për nevojat e sektorit privat;
- Përkrahje në blerjen e makinerive për prodhim sipas sektorëve strategjikë për zhvillim;
- Përkrahje financiare për ndërmarrjet që kontribuojnë në hulumtim dhe zhvillim të produkteve apo shërbimeve të reja;
- Ofrimin e garancioneve për kreditimin e sektorit privat në bazë të sektorëve strategjik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, etj.;
- Avancimi i qeverisjes së mirë dhe transparencës në krijimin e implementimin e politikave ekonomike.

Në kuadër të Fondit do të përkrahen:

- Ndërmarrësit e rinj dhe bizneset e vogla në të gjithë sektorët e identifikuar;
- Bizneset e mesme për t'i zgjeruar kapacitetet e tyre prodhuese dhe/ose të rrisin cilësinë dhe standardet e prodhimit;
- Korporatat që planifikojnë të rrisin sektorë të pazhvilluar ose inovativ, të tillë si energjia alternative, teknologjia informative dhe komunikuese, sektorët e eksportit apo që rrisin ndjeshëm numrin e të punësuarve;
- Projekte të partneritetit publiko-privat (PPP); dhe
- Shërbime për bizneset për joshjen e investimeve të huaja direkte.

Ky Fond do të administrohet me transparencë dhe profesionalizëm, duke aplikuar nivelet më të larta të ekspertizës dhe eksperiencës ndërkombëtare dhe duke huazuar praktikat më të mira të ngjashme. Për ta ndërtuar dhe vënë atë në veprim, Qeveria do të mbështetet gjithashtu në bashkëpunimin e ngushtë me organizatat prestigjioze ndërkombëtare, në ekspertizë të avancuar dhe në ndihmën e vendeve mike perëndimore. Mbi të gjitha, menaxhimi i Fondit do të realizohet në mënyrë të pavarur nga çdo presion apo ndërhyrje politike, konform bazës ligjore që rregullon këtë mekanizëm.

Parakushtet themelore për implementimin e Fondit për punësim dhe zhvillim janë:

- Hartimi dhe ndryshimi i bazës ekzistuese ligjore;
- Lehtësimet tatimore të nevojshme për nxitje të investimeve të reja;
- Harmonizimi i qëllimeve të Fondit me Politikën e Integritit Evropian.

Në anën tjetër, aktivitetet për implementimin e Fondit konsistojnë në:

- Hartimin e Planit Operacional: "Përmirësimi i konkurrencës së sektorit privat nëpërmjet masave të fondit për punësim" në bashkëpunim me komunitetin e biznesit;
- Implementimin e aktiviteteve nga Plani Operacional, të drejtuara në zhvillimin e resurseve humane;
- Intervenimin me mjete të fondit në sektorin prodhues dhe atë shërbyes;

- Ristrukturimin dhe modernizimin e sektorëve me vlerë të lartë të shtuar dhe në të cilët Kosova ka përparësi krahasuese, bazuar një studim serioz të fizibilitetit;
- Implementimin e aktiviteteve që sigurojnë konkurrencë të barabartë në treg, me fokus të veçantë në qeverisjen e mirë dhe transparencën e aktiviteteve ekonomike të sektorit privat.

1.8. Investimi në energji, miniera dhe mbrojtja e mjedisit

Zhvillimi i sektorit të energjisë, minierave dhe teknologjisë informative e komunikuese është element kyç për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe investimeve të huaja. Furnizimi me energji elektrike kualitative, shërbime të bazuara në teknologji informative e komunikuese me çmime të volitshme është një ndër prioritetet e Qeverisë, duke marrë parasysh ndikimin e këtyre sektorëve në zhvillim ekonomik dhe jetën e qytetarëve. Në të njëjtën kohë, është shumë e rëndësishme që zhvillimi dhe eksploatimi i minierave ekzistuese dhe resurseve frekuencore si dhe hapja e minierave të reja duhet të jetë në funksion të ngritjes së mirëqenies sociale dhe ngritjes së standardit të jetës në vendin tonë.

1.8.1. Rregullimi i statusit të Ndërmarrjes “Trepça” nëpërmjet ligjit të veçantë

Në sektorin e minierave, do të aplikohet qasje strategjike për shfrytëzimin e pasurive minerale. Vendimet për të ardhmen e minierës së Trepçës dhe minierave të tjera të rëndësishme strategjike, do të bazohen në strategji të qartë që reflektojnë interesat ekonomike dhe shtetërore të Kosovës. Vendimmarrja për të ardhmen e pasurive natyrore të Kosovës, shfrytëzimin dhe menaxhimin e tyre duhet të jetë përgjegjësi e Parlamentit të Republikës së Kosovës. Prandaj, do të përgatitet Strategjia për Trepçën dhe Ligji për Trepçën si pasuri nacionale, e cila strategji do të ketë për qëllim ngritjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës, duke e ristrukturuar Trepçën në dy funksione bazë: kompania themelore që do të merret vetëm me eksploatimin e minierave dhe përpunimin e tyre dhe ndarja e shërbimeve përcjellëse të kësaj ndërmarrje.

Qëllim i ndarjes së ndërmarrjes në këto dy funksione është që Trepça të fokusohet në ngritjen e prodhimit të mineraleve dhe përpunimin e tyre, duke liruar “Trepçën” nga barra e mbajtjes së funksioneve të tjera që nuk ndërlidhen me qëllimin kryesor të prodhimit dhe përpunimit të mineraleve. Në katër vitet e ardhshme Qeveria e Kosovës nëpërmjet “Fondit për Punësim dhe Zhvillim” do të alokojë mjete të mjaftueshme për investime të reja në “Trepçë”, kryesisht në teknologji të re për eksploatim dhe përpunim të mineraleve në funksion të rritjes së prodhimit dhe eksportit, që rezulton në krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e bilancit tregtar të vendit tonë.

1.8.2. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese

Qeveria do të angazhohet për një shfrytëzim optimal të burimeve energjetike që ka Kosova, si një e mirë publike edhe për brezat e ardhshëm, duke përmbushur kriteret evropiane mjedisore. Brenda katër vjetësh të qeverisjes, do të sigurohet energji stabile dhe cilësore për amvisëri dhe biznese. Qeveria konsideron se sektori i energjisë është një nga shtyllat kryesore që mundëson zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Qëllimet kryesore të sektorit të energjisë janë:

- Të ketë energji të mjaftueshme për nevojat e Kosovës;
- Çmimet e energjisë të jenë të përballueshme për qytetarët dhe bizneset;
- Të mbrohet ambienti dhe të shfrytëzohen resurset në mënyrë efikase;
- Të ngritën investimet private dhe krijohen vende të reja të punës.

Gjatë mandatit të qeverisjes do të finalizohet tenderimi për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”. Ky termocentral do të përfshijë këto kapacitete: 2x300 MW të cilat parashihet të hyjnë në operim deri në 2021 dhe 600 MW të tjerë deri më 2023. Do të punohet në nxjerrjen e vendimit për zhvillimin e procedurave të tenderimit për ndërtimin dhe funksionalizimin e Hidrocentralit të Zhurit me kapacitet instalues prej 305 MW deri më 2017 me qëllim të ndërtimit dhe funksionalizimit në periudhën 2018-2022. Do të finalizohen studimet përkatëse deri në vitin 2017 dhe sipas vendimit të qeverisë do të zbatohen masat përkatëse me qëllim që të rehabilitohet termocentrali “Kosova B” gjatë periudhës 2018 - 2021. Do të unifikojmë tregun energjetik me Shqipërinë për të arritur komplementaritet.

Do të përmbushen obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (20:20:20) lidhur me kërkesat për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë. Qeveria ka për qëllim që të vazhdojë mbështetjen për investimet në energjinë e ripërtërishme dhe të zhvillojë resurset në vijim: Diellore 8 MW, Era 130 MW, Hidro 180 MW dhe Biomasa 10 MW. Në të njëjtën kohë do të punohet për arritjen e caqeve të parapara prej 9% deri në 2018 bazuar në Planin e Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2010-2018, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017, si dhe obligimet që dalin nga Sekretariati i Komitetit të Energjisë.

1.8.3. Dekomisionimi i kapaciteteve gjeneruese të vjetruara

Konform zotimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së Vjenës dhe Bashkimit Evropian, duhet bërë dekomisionimin e termocentralit më të vjetër në Kosovë, i cili përdor teknologji shumë të vjetër në gjenerim të energjisë. Dekomisionimi i TC Kosova A, ose pjesëve të saj, do të fillojë nga Qeveria pas studimit të alternativave të reja të gjenerimit plotësues dhe pasi të sigurohet furnizimi i qëndrueshëm me ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re.

1.8.4. Avancimi i projekteve të ngrohjes qendrore

Organizimi urban i qyteteve të Kosovës mundëson zbutjen e kërkesës për energji elektrike gjatë dimrit, duke funksionalizuar ngrohje qendrore në zonat urbane. Pas projektit të kogjenerimit për Prishtinën, do të vazhdohet me mbështetjen e ndërmarrjeve ekzistuese të ngrohjes në Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan. Qeveria do të shqyrtojë mundësinë e Partneritetit Publiko-Privat në ndërtimin e një ngrohtore për Drenas nga Ferronikeli. Qeveria bazuar në interesin e shprehur nga nivelet komunale do të kërkojë financim nga donatorët për studimin e mundësive për ndërtimin e ngrohtoreve qendrore për qytete tjera. Po ashtu, do të hartohet projekti dhe do të realizohet lidhja e Kastriotit në sistemin e ngrohjes së Termokosit.

1.8.5. Liberalizimi i tregut energjetik dhe minerar

Ristrukturimi i sektorit të energjisë elektrike duhet të mundësojë liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurohet një treg konkurrues, transparent, jo-diskriminues dhe i orientuar drejt konsumatorit.

1.8.6. Përfshirja e Kosovës në rrjetin e gazsjellësit

Qeveria do të vazhdojë të angazhohet nëpërmjet mekanizmave të BE-së dhe ato rajonale, për të siguruar studime për sigurimin e gazsjellësit në Kosovë. Këtij studimi duhet t'i paraprijë një masterplan për rrjete potenciale distribuimi në qytetet në të cilat do të ketë kërkesë të madhe për përdorim të gazit. Pas ndërtimit të Trans Adriatic Pipeline, do të fillojë ndërtimi i Ionian-Adriatic Pipeline, i cili do të mundësonte kyçje të Republikës së Kosovës nëpërmjet Shqipërisë në gazsjellës me furnizim të qëndrueshëm.

1.8.7. Mbrojtja e Mjedisit

Mbrojtja e mjedisit është një obligim dhe zotim për mirëqenien e brezave të ardhshëm. Prandaj, do të zhvillohet legjisllacioni që i përcakton vlerat kufitare për lirimin e gazrave, kriteret për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës nga ndotja dhe përdorimi i teknologjisë që mbron klimën, në përputhje me standardet evropiane si dhe hartimi i ligjit të ri për kadastrë me të cilin edhe do të bëhet organizimi vertikal i zyrave kadastrale komunale me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe vetëfinancimi.

1.8.8. Masat për përkrahjen e mbrojtjes së mjedisit

Duke e marrë parasysh se zgjidhja e problemeve mjedisore është shumë e kushtueshme do të bëhet rritja e Fondit për subvencion dhe grante përmes shfrytëzimit të mjeteve të grumbulluara nga taksa ekologjike.

1.9. Zhvillimi i bujqësisë

Bujqësia ka pësuar një rritje të ndjeshme nga viti në vit, duke arritur të jetë pjesë e rëndësishme në Bruto Produktit Vendor të Kosovës. Bujqësia tradicionalisht ka qenë një nga aktivitetet kryesore ekonomike në Kosovë, por i nënvlerësuar për potencialet e saj. Qeveria do të angazhohet fuqishëm për promovimin e zinxhirit prodhues, nga prodhimi primar bujqësor, të përpunimi, ruajtja dhe tregtimi me produkte bujqësore, si dhe masa nxitëse kreditore dhe subvencionuese dhe përmirësimin e infrastrukturës publike. Mbulimi i tregut vendës me produkte bujqësore nga vendi, është hapi i parë i mbështetjes në prodhimtarinë vendëse.

1.9.1. Masat për përkrahjen e bujqësisë

Me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sektorit të bujqësisë, masat të cilat do të ndërmerren nga Qeveria gjatë këtij mandati përfshijnë:

- Rritjen e buxhetit për mbështetjen/subvencionimin e bujqësisë, me prioritet në sektorët me përparësi krahasuese konkurruese: pemët, perimet, prodhimi e përpunimi i qumështit dhe mishit (blegtoaria);
- Përfaqësimin e mundshme, rishikimi i mënyrës së mbështetjes duke e orientuar mbështetjen kah prodhimi, e jo kah inputet bujqësore;

- Subvencionimin e kamatave për kreditë bujqësore - Bujqit që marrin kredi nga bankat do të marrin përsipër riskun e kthimit të kredisë, ndërsa qeveria do ta paguajë interesin për ato kredi. Me këtë rast, do të përcaktohen sektorët e bujqësisë, ku do të aplikohet kjo lloj politike;
- Do të hiqet taksa doganore për të gjitha inputet bujqësore;
- Investimin në sigurinë e ushqimit në përputhje me standardet evropiane. Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit do të kalojë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë;
- Për rajonet malore, promovimin e shfrytëzimit racional të pyjeve duke mundësuar pyllëzimin e vazhdueshëm krahas shfrytëzimit të pyjeve;
- Ofrimin e shërbimeve këshilluese pa pagesë për fermerë dhe bujq, siç është veterina mobile apo agronomi mobil. Në këtë aspekt, shteti do të kontraktojë veterinarë dhe agronomë, të cilët do të kenë përgjegjësi për të mbikëqyrur dhe këshilluar bujqit dhe blegtorët në rajone të caktuara;
- Ndërtimin e kapaciteteve teknike në lokacione të caktuara për mbrojtje nga breshëri;
- Pyllëzimin e sipërfaqeve të pjerrëta për t'i ruajtur kundër erozionit;
- Me qëllim të mbrojtjes nga insektet, pyjet dhe fushat e caktuara do të spërkaten në mënyrë të vazhdueshme;
- Në tokat kodrinore-malore, sidomos në tokat e pashfrytëzuara bujqësore, do të mbështetet në veçanti ngritja e pemishteve, vreshtave, lajthive, arrave etj.;
- Ruajtjen e lumenjve nga shfrytëzimi i pakontrolluar i rërës dhe nga ndotja e tyre prej ujërave të zeza dhe industriale.

1.9.2. Rritja e fondit për subvencione dhe grante

Për të përmirësuar bujqësinë, Qeveria do tërheqë investime të tjera përveç nga Fondi i Punësimit, duke ndihmuar me financime, subvencionime dhe kreditime me kushte të volitshme, sidomos për blerjen e makinerive bujqësore, plehrave kimikë, insekticideve apo pesticideve, farërave dhe fidanëve. Këtu një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nxitjes së përdorimit të serave, teknikave dhe teknologjive të reja të bujqësisë. Me prioritet gjithashtu do të shihet stimulimi i sektorëve me potencial të madh zhvillimi si pemëtaria, vitikultura dhe hortikultura. Gjithashtu, do të ndryshojë plotësisht mënyra e mbështetjes duke e orientuar mbështetjen kah prodhimi, e jo kah inputet bujqësore, pasi orientimi kah inputet ka bërë që subvencionet bujqësore të mos arrijnë të bujku që e punon tokën, por tek pronari i tokës.

1.9.3. Reformat ligjore për mbrojtje të bujqësisë

Qeveria do të zhvillojë politika për të siguruar që tokat bujqësore të përdoren për qëllime produktive. Do të krijohen stimuj që të nxitet punimi i tokave të pashfrytëzuara, sidomos atyre që janë privatizuar. Do të ofrohen lehtësira doganore dhe tatimore për sektorin e prodhimit primar dhe masa lehtësuese tatimore, të cilat do të ulnin edhe koston e prodhimit. Kjo do të prodhonte efekte pozitive në rritjen e këtij sektori dhe nivelin e punësimit të popullatës. Do të ndërmerren politika për ruajtje të destinacionit të tokës pas privatizimit. Do të vazhdojë definimi i pronësisë së tokës, si asaj private e ashtu edhe asaj publike, ngase në shumë raste toka punuese është e pa definuar ose jo mirë e definuar. Duke shfrytëzuar rezultatet e regjistrimit të bujqësisë, do të bëhet Inventarizimi i menjëhershëm i

stokut të bagëtive, vreshtave, serrave, pemishteve, pikave grumbulluese të qumështit, tregjeve të gjelbra etj., për të vendosur bashkëpunimin me ta dhe për t'u ofruar atyre mbështetjen e nevojshme. Do të rritet dhe më shumë mbrojtja e tregut nga importet dumping dhe format e tjera që shkaktojnë deformim të konkurrencës në treg është njëra nga masat të cilat po ashtu mund të prodhojnë efekte pozitive në rritjen e sektorit të bujqësisë.

1.9.4. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore

Për të rigjeneruar e konsoliduar bujqësinë, Qeveria do të ndërmarrë investime infrastrukturore, që kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit. Si rezultat i kësaj, këto vite është bërë regjistrimi i tokave bujqësore i cili do të ofrojë të dhëna të sakta për sektorin e bujqësisë dhe do të lehtësojë ndërmarrjen e politikave të reja në këtë sektor. Do të investohet në sistemin e ujitjes të Ibër-Lepencit për mbulimin me sistem të ujitjes të fushave në Rrafshin e Kosovës, dhe Radoniqit për mbulimin me sistem të ujitjes të fushave në Rrafshin e Dukagjinit.

Gjithashtu, Qeveria do të angazhohet në ndërtimin, nëpërmjet partneritetit privato-publik, e qendrave të grumbullimit dhe distribuimit të produkteve bujqësore, të bimëve mjekësore, fryteve të egra si dhe të frigoriferëve të specializuar për mirëmbajtje, si dhe ndërtimin e infrastrukturës së grumbullimit, konservimit e paketimit. Qeveria do të vazhdojë të mbështesë investimet për ndërtimin e pikave grumbulluese të produkteve bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet subvencionimit të kamatave dhe mbulimit të pjesshëm të investimeve me anë të subvencioneve nga shteti, në mënyrë që të inventarizohet menjëherë stoku i bagëtive, vreshtave, serrave, pemishteve, pikave grumbulluese të qumështit, tregjeve të gjelbra etj. Kjo do të paraqiste edhe njëherë angazhimin tonë, për të vendosur bashkëpunimin me sektorin privat dhe për t'u ofruar atyre mbështetjen e nevojshme për zhvillim.

1.9.5. Mbështetja për sektorin e blegtorisë

Blegtoria është një ndër trashëgimitë më të pasura të Kosovës dhe besohet se mund të jetë konkurrencte në treg. Qeveria do të mbështesë dhe nxisë zhvillimin e blegtorisë në Kosovë në mënyrë që të rritet prodhimi i qumështit, mishit, leshit, lëkurave dhe të nxitet industria e lidhur me këto nënprodukte. Për të mundësuar zhvillimin e blegtorisë Qeveria e ardhshme do të nxisë edhe kultivimin e tokave me bimë që i shërbejnë blegtorisë, si jonxhë, lakër, foragjere si dhe do të nxisë mirëmbajtjen e kullotave.

1.9.6. Promovimi i kulturave të reja bujqësore dhe i bujqësisë organike

Qeveria do të mbështesë kërkime shkencore dhe analiza të tregut që do të hulumtojnë potencialin e kultivimit në Kosovë të kulturave të reja që nuk janë tradicionale, si: lulet apo bimët industriale që shërbejnë për farmaceutikë apo kozmetikë; fruta apo perime që nuk janë kultivuar më parë, por që janë të përshtatshme për klimën dhe tokën si për shembull kivi, shpargulla etj.; fermat të kulturave të reja që po arrijnë suksese në vende fqinje si për shembull bletaria, prodhimi i kërmijve për eksport, strucët, drerët etj. Gjithashtu, ka një ndjeshmëri të theksuar ndaj ambientit dhe e sheh zhvillimin e Kosovës të lidhur ngushtë me konservimin e natyrës që do t'i sigurojë jetëgjatësi edhe turizmit. Në tregjet ndërkombëtare është vënë re një rritje e kërkesës për produkte bujqësore organike. Përpos kësaj do të ofrohen

mundësi grantesh dhe kreditime me kushte të volitshme nga shtete dhe institucione ndërkombëtare për të aplikuar bujqësinë organike. Qeveria do të angazhohet që në bashkëpunim të ngushtë me fermerët të aplikojë për të shtënë në dorë sa më shumë fonde për të nxitur zhvillimin e bujqësisë organike.

1.9.7. Mbrojtja e resurseve pyjore

Ruajtja e mjedisit është një obligim dhe zotim për mirëqenien e brezave të ardhshëm. Prandaj, do të zhvillohet legjislacioni që i përcakton vlerat kufitare për lirim e gazrave, kriteret për mbrojtjen e ujërave, ajrit dhe të tokës nga ndotja dhe përdorimi i teknologjisë që mbron klimën, në përputhje me standardet evropiane. Prioritet i veçantë do të jetë ruajtja e pasurive pyjore dhe investimet për gjelbërimin, si dhe do të promovohet shfrytëzimi racional i pyjeve, duke mundësuar pyllëzimin e vazhdueshëm krahas shfrytëzimit të pyjeve.

1.10. Infrastruktura

Duke synuar zhvillimin dhe përmirësimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës, Qeveria do të ndërmarr masa për të krijuar infrastrukturën e nevojshme, e cila do të financohet kryesisht nëpërmjet kredive të buta ose nëpërmjet partneriteteve publiko-private. Kjo formë e investimit të infrastrukturës nuk do ta ngarkojë buxhetin e shtetit.

1.10.1. Infrastruktura rrugore

Infrastruktura ka pasur një shkallë të lartë të investimeve, posaçërisht në ndërtimin e korridoreve evropiane. Qeveria do të vazhdojë zbatimin e kontratës ekzistuese për ndërtimin e Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit - R6, e cila do të përfundojë në periudhën afatmesme. Me këtë autostradë, dhe autostradën R7, do të mbulohen afër dy të tretat e rutave evropiane, që do të mundësojnë qasje më të mirë të investitorëve të huaj në Kosovë dhe ndërlidhje më të mirë të qyteteve të Kosovës. Me përfundimin e Autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, Kosova përmbush kërkesat për ndërtim të korridoreve Evropiane të përcaktuara me Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe do t'i mundësojë Kosovës të ketë rol qendror në Ballkan.

Qeveria do të vazhdojë ndërtimin-zgjerimin e rrugës që lidhë Prishtinën me Vushtrinë dhe Mitrovicën, duke përdorur fondet nga marrëveshjet që Qeveria ka nënshkruar me Bankën Islamike për Zhvillim (BIZH), OPEC Fondin për Zhvillim (OFID) dhe Fondin Saudit për Zhvillim (FSZH). Zgjerimi i magjistrales Prishtinë-Pejë do të arrihet nëpërmjet financimit nga bankat zhvillimore të cilat ofrojnë kredi afatgjate me norma të interesit më të lira. Qeveria veçse ka shprehur edhe formalisht kërkesën tek Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Investive Evropiane (BIE), prej të cilave pret të ftohet për të negociuar marrëveshjet financiare për të përfunduar projekti. Do të punohet në projektin e magjistrales nga Qafa e Duhlës në drejtim të Ferizajt dhe pastaj në drejtim të Gjilanit, që mundëson lidhjen me korridorin Lindje-Perëndim dhe me magjistralen Prishtinë-Shkup. Do të fillojë projekti i rrugës që lidh Prishtinën me Podujevën, si dhe projekti i rrugës Prishtinë-Gjilan-pikë kufitare për Bujanovc.

Për të gjitha këto projekte infrastrukturore, përfshirë projektin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, do të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve jashtë buxhetit, nëpërmjet linjave kreditore të favorshme në mënyrë që mjetet e projektit të shkojnë në projekte më prioritare që nxisin punësim në sektorin privat dhe rritje të të ardhurave.

Qeveria do të vazhdojë mbështetjen për komunat në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe rurale. Qeveria do të vendosë se cilat projekte do të përzgjidhen para fillimit të vitit buxhetor. Kriteret për përcaktimin e projekteve do të përcaktohen me udhëzim administrativ. Një studim gjithëpërfshirës do të kërkohet për të përcaktuar rehabilitimin dhe ndërtimin e rrugëve rajonale.

1.10.2. Infrastruktura hekurudhore

Qeveria synon që nëpërmjet Bankave zhvillimore të financojë rehabilitimin e Linjës 10 të hekurudhës, e cila mundëson transport më të lirë për qytetarët dhe mallrat. Gjatë katër viteve Qeveria do të financoj rehabilitimin e linjës Lindje-Perëndim, e cila mundëson lidhje hekurudhore me Shqipërinë dhe Malin e Zi, respektivisht do të krijohej lidhja me portet detare në Adriatik. Studimi për lidhje me këto shtete duhet të bëhet sipas strategjisë multimodale të transportit, me prioritizim pranë sekretariatit të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe në bashkëpunim me shtetet fqinje. Pas rehabilitimit të bazamentit të linjave ekzistuese dhe me elektrifikimin e linjave nga shtetet fqinje, do të pasoj investimi në elektrifikim të hekurudhave.

1.11. Telekomunikacioni dhe teknologjia e informacionit

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të telekomunikacionit që nga paslufta është penguar jashtëzakonisht shumë, si pasojë e problemeve me statusin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, e sidomos ato të profilizuara në fushën e telekomunikacionit. Menaxhimi i kufizuar i numeracionit dhe resurseve frekuencore vazhdon të ketë efekte negative në të hyrat e përgjithshme të sektorit të telekomunikacionit. Sektori i telekomunikacionit ka vazhduar të liberalizohet dhe Kosova tani ka një rrjet edhe më të zgjeruar të shërbimeve të telekomunikacionit, çmime të përballueshme me pakicë të thirrjeve me zë dhe të të dhënave. Liberalizimi dhe lansimi ka prekur edhe teknologjinë 3G dhe 4G/LTE, e cila ka hapur horizont të gjerë për të ardhmen e komunikimeve në Kosovë.

Për zhvillimin e mëtutjeshëm të telekomunikimeve **Qeveria e Kosovës** do të fokusohet në 3 prioritet kryesore:

1. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK me fokus zhvillimin e infrastrukturës brezgjërë dhe sigurinë e rrjetave dhe komunikimeve elektronike;
2. Zhvillimin e shërbimeve dhe përmbajtjeve elektronike dhe promovimin e shfrytëzimit të tyre;
3. Avancimin e aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK.

1.11.1. Marrja e kodit telefonik shtetëror

Aktualisht Kosova vazhdon të ketë vetëm tre kode për shërbime telefonike (+377, +386 për shërbime të telefonisë mobile dhe +381 për shërbime të telefonisë fikse), gjë që zvogëlon

atraktivitetin për investime në sektorin e telekomunikacionit, humbje financiare dhe vështirësitë e mëdha për të menaxhuar sistemin e numeracionit nga ana e rregullatorit dhe operatorëve që ofrojnë shërbime telekomunikuese në Kosovë. Kjo është adresuar në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja ku edhe është arritur marrëveshja ndërmjet palëve që Kosovës t'i ndahet kodi 3 –shifror thirrës telefonik nga ITU (International Telecommunication Union). Ky kod ofron një mundësi reale për zgjidhjen e problemeve madhore të telekomit. Për momentin operatori 'Vala' e shfrytëzon kodin e Monakos (+377), ndërsa Ipko kodin sllloven (+386) me notifikimet përkatëse pas sigurimit të kodit shtetëror dhe pas vendimeve përkatëse të ART-së këto kontrata edhe do pushojnë të qenit valide. Pas marrjes së kodit, të gjithë operatorët e telefonisë mobile dhe fikse në Kosovë do të jenë të obliguar që të përdorin kodin e ri unik pas një periudhe të përcaktuar nga ART.

1.11.2. Privatizimi i VALA-s pas ristrukturimit të nevojshëm

Procesi i privatizimit të 75% të aksioneve të operatorit publik të telekomunikacionit, PTK, u përmyll me mos privatizim të këtyre aksioneve për shkak të mos aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Si rezultat i kësaj, do rishikohet strategjia dhe do të punohet intensivisht në përmirësimin e performancës të kësaj kompanie dhe po ashtu do të bëhen investime kapitale për ta rritur aftësinë konkurruese dhe vlerën e saj të tregut.

1.11.3. Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të telefonisë mobile

Fluksi i shërbimeve me vlerë të shtuar të komunikimeve elektronike po rritet eksponencialisht. Në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, është arritur marrëveshja mbi telekomunikacionin, në shtatorin e vitit 2013. E arritura kryesore ishte marrëveshja në mes të palëve që Kosovës t'i ndahet kodi 3-shifror thirrës telefonik nga Unioni Ndërkombëtarë i Telekomunikacionit (UNT) duke filluar nga viti 2015. Një ndër tri politikat kryesore, të dala nga dokumenti i politikave të sektorit të komunikimeve elektronike – agjenda digjitale për Kosovën 2013-2020, është zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Ky prioritet ka filluar të jetësohet në drejtim të liberalizimit të mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra përmes lejimit të përdorimit të teknologjive të reja që mundësojnë shërbimet e avancuara mobile brezgjëra (3G dhe 4G/LTE).

1.11.4. Teknologjia e Informacionit

Në tërë globin, teknologjia informative (TI) ka ndikim të madh në transformim ekonomik, në reformat e sektorit publik si dhe në tërë shoqërinë përgjithësisht. Ky trend kah transformimi digjital, sektori i TI-së është vendosur si prioritet kryesor në agjendat e shumë qeverive. Përveç kësaj, duke marrë parasysh vlerën e përgjithshme të kësaj teknologjie në tregun botëror 1,133,330 milion EUR (viti 2013¹), sektori i TI-së nuk është vetëm njëri prej sektorëve më të mëdhenj, por është edhe sektori më dinamik, duke e shndërruar këtë sektor si kyç për rritje ekonomike dhe inovacion.

Qeveria e Kosovës duke marrë parasysh rëndësinë strategjike të sektorit të TI-së, këtë teknologji e konsideron si një ndër prioritetet më të rëndësishme për zhvillim ekonomik dhe

¹
EITO 2014/2015

transformim struktural kah një ekonomi të bazuar në dije. Shtyllat kryesore në të cilat do të bazohet zhvillimi i TI-së në Kosovë do të jenë:

- Politikat promovuese, eksportuese dhe të investimeve për TI;
- Zhvillimi i tregut të brendshëm si dhe bashkëpunimi në mes të ndërmarrjeve të TI-së;
- Ngritja e niveli të ndërmarrësisë, si dhe kualitetit të punës në ndërmarrjet e TI-së;
- Edukimi, Inovacioni dhe zhvillimi i kapaciteteve për Hulumtim dhe Zhvillim në TI.

Për zhvillim sa më të qëndrueshëm dhe duke synuar krijimin e një shoqërie dhe ekonomie të bazuar në dije, Qeveria e Kosovës do të krijoj fond të veçantë për zhvillim të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese.

1.12. Zhvillimi i turizmit

Turizmi ka qenë dhe mbetet fushë e rëndësishme për shoqërinë e Kosovës dhe për zhvillimin ekonomik të sektorit privat dhe ekonomisë në përgjithësi. Kosova ofron mundësi të mirë për turizëm dimëror dhe malor, atij rekreativ-sportiv, turizmit kulturor të bazuar në trashëgiminë tonë historiko-kulturore. Me krijimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj ajrore, lidhjen më të shpejtë me Shqipërinë, Maqedoninë që pritet të përfundoj shpejt, si dhe vendet e tjera, ka ndikuar dhe do të ndikojë edhe më shumë pozitivisht në rritjen e fluksit të turistëve në Kosovë. Kjo ka mundësuar dhe do të rrisë më tutje mundësinë që edhe Kosova të jetë pjesë e hartës ballkanike të grupeve të ndryshme vizitorësh, duke filluar nga qëndrimi një ditë dhe më gjatë. Gjithashtu infrastruktura rrugore e përfunduar për në destinacionet kryesore siç është Gryka e Rugovës apo edhe Brezovica, kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e turizmit në ato pjesë.

Në këtë drejtim, Qeveria do të promovojë turizmin si sektor që ka efekte të shumta në ekonomi dhe mbrojtje të ambientit. Zhvillimi i turizmit do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në disa fusha si: në prodhim, në rritjen e të ardhurave, në zhvillimin e veprimtarive ekonomike, hoteleri, transport, tregti, institucionet kulturore etj., në rritjen e punësimit, ngritjen e nivelit të standardit jetësor, në rritjen e investimeve, në përmirësimin e bilancit të pagesave, në zhvillimin e viseve të pazhvilluara etj. Ndërsa ndikim indirekt do të ketë në veprimtaritë ekonomike, siç janë: bujqësia, ndërtimtaria, industria, artizanatet, etj. Rëndësia ekonomike e turizmit, si një nga përcaktuesit e zhvillimit, përbën vetëm një pjesë të vogël të sistemit të përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Qeveria me theks të veçantë do të fokusohet në:

- Përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që mundëson zhvillimin e turizmit;
- Përgatitjen e hartave turistike për secilën komunë;
- Rivlerësimin e potencialeve turistike të Kosovës bazuar në standardet ndërkombëtare;
- Investime për avancimin e gastronomisë lokale dhe shfrytëzimin e saj si prodhim turistik;
- Promovimin dhe mbështetjen e turizmit balnear (shëndetësor);

- Promovimin e turizmit malor në destinacione turistike të nivelit të lartë, posaçërisht në Bjeshkët e Nemuna dhe në Malet e Sharrit;
- Bashkëpunimin me komunitetet lokale për t'i ruajtur monumentet natyrore;
- Hapjen e faqeve turistike për tërë territorin e Kosovës dhe vendet turistike veç veç;
- Do të punohet në hartimin e një oferte të përbashkët turistike me Republikën e Shqipërisë për vizitorët dhe investitorët e huaj si dhe për diasporën shqiptare.

1.12.1. Zhvillimi i resorit turistik multifunksional "Brezovica"

Tani Kosova ofron mundësi për zhvillimin e turizmit në disa pjesë të saj, siç është Qendra e Skijimit në Brezovicë, në malet e Sharrit. Ky resurs gjendet mes 1.700 dhe 2.500 m lartësi mbidetare. Ai ofron kushte të shkëlqyeshme gjatë sezonit të skijimit nga nëntori deri në maj. Pasuria e Brezovicës përfshin tri hotele me 680 dhoma, dy restorante dhe nëntë ski teleferiku me kapacitet transporti të 10.000 skiatorë në orë. Nëpërmjet afërsisë me Aeroportin e Prishtinës (60 km) dhe Shkupit (70 km), ky resurs paraqet një destinacion potencial për turistët e huaj dhe ka mundësi të bëhet destinacioni më i favorizuar turistik dimëror në Ballkan.

Gjatë mandatit qeverisës, do të jetësohet Projekti për Zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës, i cili tashmë ka filluar, i klasifikuar si projekt me rëndësi kombëtare. Me fillimin e projektit të Brezovicës, në Kosovë do të hapen mbi 3000 vende të reja të punës, e në realizimin e këtij projekti, parashihen të investohen mbi 400 milionë euro. Ne do të vazhdojmë të punojmë me prioritet të lartë për t'i modernizuar, avancuar si dhe krijuar kushteve për marrje me turizëm të sa më shumë qytetarëve, sidomos të pjesëve turistike të Kosovës. Do të ofrojmë ndihmë, këshilla, lehtësime si dhe mundësi promovimi turizmit të Kosovës.

1.12.2. Zhvillimi i turizmit rural dhe malor

Turizmi rural apo agroturizmi përbën një tjetër sektor me potencial të madh zhvillimi në Kosovë. Numri i turistëve që preferojnë këtë lloj turizmi në nivel ndërkombëtar, por edhe në nivelin vendas, sa vjen e rritet. Po ashtu po vihet re një tendencë e qytetarëve të zonave urbane të Kosovës për të kaluar kohë në zonën rurale në kontakt të drejtpërdrejtë me natyrën dhe me veprimtaritë tradicionale të bujqësisë dhe blegtorisë. Prandaj, besojmë se zhvillimi i agroturizmit duke huazuar nga përvojat më të mira ndërkombëtare, në zonat piktoreske të shumta të Kosovës ka për ta bërë sa më të larmishme dhe të gjatë ofertën turistike të vendit tonë dhe ka për të shtuar ndjeshëm punësimin dhe të ardhurat në sektorin e turizmit. Përveç aspektit të bukurisë së natyrës, agroturizmi kosovar mund të stimulohet edhe prej pranisë së kulinarisë karakteristike, traditës së pasur folklorike si dhe bujarisë tipike kosovare. Në mandatin e ardhshëm, Qeveria do të hartojë një strategji gjithëpërfshirëse për këtë sektor, si dhe do të kanalizojë një pjesë të fondeve për ta stimuluar këtë sektor.

1.12.3. Mbrojtja e resurseve natyrore

Qeveria, me gjithë përqendrimin në shtetndërtim dhe zhvillim, një ndër prioritetet do ta ketë edhe mbrojtjen e resurseve natyrore të Kosovës. Në funksion të kësaj janë dhe vepojnë

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) si pjesë e saj. Po ashtu, organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare janë aktive në mbrojtjen e resurseve natyrore. Mbrojtja e resurseve natyrore realizohet nëpërmjet institucioneve qeveritare të parapara me aktet ligjore dhe të cilat angazhohen të ruajnë kualitetin e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishtme të energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore me qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm për brezat e tashëm dhe të ardhshëm, në harmoni me progresin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë në mandatin e ardhshëm 4-vjeçar do të jetë mbrojtja e resurseve natyrore të Kosovës, me politika të qarta dhe të veçanta për resurset natyrore. Misioni ynë do të jetë mbrojtja e resurseve në bashkëpunim me vendasit e atyre pjesëve, duke i stimuluar për ruajtjen e ambientit si dhe krijimin e kushteve për jetesë të banorëve të atyre pjesëve.

1.13. Përmirësimi i performancës së ndërmarrjeve publike

Qeveria do të forcojë qeverisjen koorporative të përgjegjshme dhe profesionale, që siguron qëndrueshmëri të ndërmarrjeve publike, cilësi të lartë të shërbimeve për qytetarët dhe ekonomi të shkallës që ofron shërbime me kosto më të ulët sesa sektori privat. Me qëllim të përmirësimit të performancës së ndërmarrjeve publike Qeveria do të rishikoj bazën ligjore dhe arsyeshmërinë që i ndan ndërmarrjet publike në qendrore dhe lokale, për të siguruar se në vendimmarrje të këtyre janë të përfshirë aktorët që janë të prekur nga veprimtaria e këtyre ndërmarrjeve.

Duke synuar një kontroll dhe menaxhim sa më efikas, do të shqyrtohet mundësia që disa nga ndërmarrjet publike të transferohen për monitorim nga ministritë përkatëse. Pavarësimi nga buxheti i shtetit do të shqyrtohet për një numër ndërmarrjesh publike, me theks të veçantë ndërmarrjet me karakter komercial, por asnjëherë duke dëmtuar shërbimet për qytetarët, do të mbështetet mbulimi i një pjesë të shërbimeve publike të familjeve në asistencë sociale nga shërbimet e energjisë elektrike, ujit të pijes, ngrohjes dhe mbeturinave. Duke marrë parasysh se procedurat e prokurimit publik janë evidentuar si pengesë për investime të reja dhe disa aktivitete komerciale të disa ndërmarrjeve publike, do të shikohen mundësitë që ato ndërmarrje publike që ballafaqohen me konkurrencë të drejtpërdrejtë nga sektori privat, të marrin trajtim të veçantë ligjorë nga procedurat e prokurimit publik. Do të shikohet mundësia e prioritizimit të shqyrtimit të lëndëve nga gjykatat si ankesa mbi pagesë nga Ndërmarrjet publike nga konsumatorët borxhlinj.

Privatizimi i ndërmarrjeve publike duhet të ndodhë, por vetëm atëherë kur privatizimi si proces do ta maksimizonte vlerën e ndërmarrjes dhe përfitimeve të tjera që ndërliken me privatizimin. Sa i përket privatizimit të PTK-Vala900, Qeveria do ta rishikojë strategjinë ekzistuese për privatizimin e saj. Para se të privatizohet duhet të përmirësohet performanca e kësaj kompanie, nëpërmjet një menaxhmenti efikas dhe investimeve kapitale për ta rritur aftësinë konkurruese të kësaj kompanie dhe vlerën e saj të tregut. Për secilën ndërmarrje do të

vendosen indikatorët kryesorë të performancës, në mënyrë që menaxhmenti dhe bordet e këtyre ndërmarrjeve të mbahen përgjegjës për punën e tyre.

1.14. Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe ndërmarrjet shoqërore

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ka kaluar në fazën e përfundimit, dhe për këtë Qeveria do të fokusohet në rishikimin e legjislacionit që rregullon funksionimin e AKP-së, për të siguruar llogaridhënie të rregullt dhe efikase. Gjithashtu, në kuadër të kësaj do të vendoset një afat kohor për përmbylljen e procesit të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe për përfundimin e punës së kësaj agjencie. Siç eshë theksuar më lartë, Qeveria do të hartoj një strategji kombëtare, për tu aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për përdorimin e fondeve të grumbulluara nga privatizimi dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore. Këto fonde do të përdoren për subvencionimin e kamatave për kredi bujqësore dhe për investime në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me qëllim të nxitjes së punësimit. Një pjesë e këtyre fondeve do të orientohet për ngritjen profesionale dhe aftësimin e mëtutjeshëm profesional të punëtorëve që mbesin të papunë nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të trajtimit të kërkesave të kreditorëve potencialë nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nga ana e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, Qeveria do të rishikoj bazën ligjore që rregullon këtë fushë. Do të auditohen rastet e privatizimeve me spin-off special lidhur me përmbushjen e kushteve të kontratës.

1.15. Ujërat

Në Kosovë brenda vitit mesatarisht rrjedhin rreth 120 m³/sec. Nga kjo sasi akumulohet vetëm 15%, ndërsa në total shfrytëzimi i ujit për të gjitha veprimtaritë socio-ekonomike nuk e kalon 20-përqindëshin e ujit që rrjedh. Kjo dëshmon se Kosova ka ujë, por planifikimi dhe shfrytëzimi i ujit si resurs ekonomik dhe social është në shkallë shumë të ulët. Brenda afatit gjashtëmujor do ta përfundojmë strategjinë për ujërat dhe do të përcaktohen qartë burimet ujore për pije, për industri, për bujqësi dhe për ekonomi.

Sot rreth 20% e popullsisë së Kosovës nuk ka qasje në furnizim publik me ujë. Prandaj, uji i pijshëm do të jetë prioritet. Në këtë kuadër, do të punohet që në partneritet me donatorët dhe institucionet financiare, të finalizohet me kohë projekti për Prishtinën, ndërsa në periudhën e ardhshme katërvjeçare fshatrat dhe zonat e tjera, që nuk kanë ujë në tetë komunat që furnizohen nga ky sistem, të lidhen me rrjetin e ujësjellësit dhe të furnizohen me ujë nëpërmjet qasjes publike.

1.15.1. Plani për menaxhimin e ujërave

Qeveria e Kosovës do të sigurojë nga donatorët financim të një studimi gjithëpërfshirës për menaxhimin e ujërave për një periudhë afatgjatë. Zonat urbane janë duke pësuar rritje të konsiderueshme të popullsisë, e cila po shkakton mbingarkesë të ndërmarrjeve rajonale të ujësjellësve. Prandaj, krijimi i kapaciteteve të reja është i domosdoshëm. Plani do të studionte mundësitë më të volitshme të krijimit liqeneve të nevojshme për t'u ballafaquar me kërkesat e qytetarëve dhe për të ofruar ujë të pijshëm 24 orë. Kompanitë rajonale dhe lokale të do të stimulohen për të përmirësuar menaxhimin, në mënyrë që të lehtësohet financimi i

drejtpërdrejtë nga bankat zhvillimore të cilat operojnë në Republikën e Kosovës. Qeveria ka programin me donatorë për shtrirje të mëtutjeshme të rrjetit në zona rurale si dhe rehabilitimin e rrjetit ekzistues.

1.15.2. Trajtimi i ujërave të zeza

Në qendrat e mëdha urbane, që paraqiten si ndotës të mëdhenj të ujërave dhe lumenjve, do të fillojë implementimi i impianteve. Do të investohet edhe në liqenin e Batllavës dhe të Badovcit, me qëllim të evitimit të ujërave të zeza dhe ujërave të tjera ndotës. Fondet do të sigurohen nga buxheti, duke bërë riorientimin e investimeve, si dhe nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Qeveria, me ndihmën e donatorëve, ka funksionalizuar Fabrikën e trajtimit të Ujërave në Skenderaj, ndërsa në Prizren dhe Gjakovë ka nënshkruar marrëveshje të financimit me donatorë për të mbuluar gjysmën e qyteteve me këtë shërbim, që është i domosdoshëm për mbrojtjen e mjedisit. Së shpejti do të sigurohet financimi për fabrikën e trajtimit të ujërave në Pejë, e cila do të mbulonte në masë të madhe pellgun e Drinit të Bardhë. Gjatë katër viteve të ardhshme, Qeveria do të siguroj marrëveshje financimi edhe për Prishtinën, Ferizajin, Gjilanin dhe Mitrovicën.

1.15.3. Investimet në sistemin e ujitjes

Do të bëhet zgjerimi i dy sistemeve kryesore, Ibër-Lepencit dhe Radoniqit, si dhe projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujitjes, duke shfrytëzuar edhe një pjesë të madhe të lumenjve të Kosovës, siç janë: Drini, Lepenci, Ereniku, Lumbardhi, Sitnica, Drenica, Llapi e Morava. Do t'i dyfishojmë sipërfaqet që do të ujitën, ndërsa do të fillojmë investimet madhore duke ndërtuar akumulime, të cilat do të kenë destinim ujitjen e tokave bujqësore, por edhe destinime të tjera. Do të fillojë rregullimi i lumenjve kryesorë, si dhe ndërtimi i akumulimeve mbi këta lumenj. Kjo do të mundësojë shfrytëzimin më të madh të tyre dhe do t'i parandalojë vërshimet. Gjithashtu, do të identifikohen të gjitha lokacionet e mundshme, në mënyrë që potenciali ujqor të shfrytëzohet edhe për prodhimin e energjisë elektrike, duke i plotësuar kriteret mjedisore dhe ato të BE-së. Interesimi i investitorëve në këtë fushë është i madh. Ne do t'i përkrahim të gjitha projektet, të cilat do të sigurojnë energji shtesë nga burimet ujore.

1.16. Politikat sociale, mirëqenia sociale dhe solidariteti ndërshoqëror

1.16.1. Parimet e politikave të mirëqenies sociale

Qeveria angazhohet për forcimin e ekonomisë së tregut dhe zhvillimin ekonomik, si mjet kryesor për zbutjen e varfërisë dhe të papunësisë, gjithashtu duke siguruar një solidaritet ndërshoqëror, nëpërmjet politikave ekonomike rishpërndarëse të të ardhurave. Politikat sociale do të sigurojnë stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e skemës së kontributeve të obligueshme pensionale si dhe do të promovohen skemat e kursimeve vullnetare.

Zvogëlimi i problemeve sociale dhe mirëqenia sociale janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik dhe rritjen e shkallës së punësimit. Hapja e vendeve të reja të punës është e vetmja mundësi për zvogëlimin e problemeve sociale në Kosovë. Qeveria beson që duhet ndërtuar një sistem i mirëqenies, i cili objektiv primar e ka riaftësimin e personave që

varen nga asistenca sociale. Duke qenë se numri më i madh i përfituesve të asistencës sociale u takojnë zonave rurale, përkrahja e sektorëve të caktuar, të cilët kanë shtrirje në këto zona si bujqësia, blegtoria dhe të ngjashme është mundësi për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të këtyre familjeve.

Qeveria do të trajtojë mirëqenien sociale si tërësi për krijimin e kushteve për punësim, arsimim cilësor si dhe shërbime efikase për kategoritë sociale. Qeveria do të mbështet përmirësimin e gjendjes së përfituesve të asistencës sociale dhe pensioneve bazë. Zvogëlimi i numrit të personave në asistencë sociale dhe integrimi i tyre në shoqëri do të bëhet duke promovuar punësimin e tyre. Asistenca sociale do të dizajnohet në atë mënyrë që të nxisë personat e varur nga asistenca të kërkojnë punë dhe të rrisin atësitë e tyre për tregun e punës.

1.16.2. Trajtim i kategorive të veçanta

Kategoritë e Luftës duke përfshirë këtu Familjet e Dëshmorëve, Invalidët, Veteranët dhe Pjesëtarët e UÇK-së si të Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, përbëjnë një pjesë të ndjeshme të shoqërisë së Kosovës, e cila përballet me vështirësi të shumta. Përballja me këtë kategori të veçantë, ka edhe ndjeshmëri politike përveç anës sociale të problemit. Qeveria do të fillojë zbatimin e ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, i cili gjithashtu do të ndryshohet në përputhje me kërkesat përkatëse. Do të vazhdojë të rritet ndihma për invalidë, familje të dëshmorëve, veteranëve dhe kategorive të tjera të luftës. Përveç pensioneve, përfituesit e skemës do të vazhdojnë të kenë beneficione në: lirim nga shpenzimet e energjisë elektrike dhe lirim nga shpenzimet e doganimit të veturave për invalidë të luftës. Qeveria e Kosovës do të vazhdojë bashkëpunimin me shoqatat, të cilat përfaqësojnë kategoritë e dala nga lufta.

1.16.3. Ruajtja e standardit të jetës së atyre që varen nga shteti

Qeveria do të angazhohet që asistenca sociale që ofron shteti për më të varfrit të sigurojë që familja, me mjetet që merr, të plotësojë nevojat elementare. Për aq sa është e mundshme, asistenca sociale do të kushtëzohet me punë aktive të përfituesve dhe me pjesëmarrje në riaftësim, si masë për zbutjen e varfërinë dhe varësisë nga asistenca sociale. Do të eliminohen në maksimum pengesat që dekurajojnë kompanitë t'i marrin femrat në punë, si dhe do të nxitet punësimi i personave të moshuar që ende nuk kanë arritur kohën e pensionimit.

Sistemi pensional do të avancojë më tutje për përfituesit nga: pensionet bazike, kontributdhënëse, për personat me aftësi të kufizuar, pensionistët e "Trepçës", ata të ish-pjesëtarëve të TMK-së dhe të FSK-së. Gjatë periudhës 4-vjeçare në mënyrë të vazhdueshme do të ketë rritje të pagesës për këto kategori:

- Do të vazhdojmë nënshkrimin e marrëveshjeve në sferën e pensioneve me vendet ku kanë punuar shtetasit e Kosovës. Këto marrëveshje do të sigurojnë për realizimin e të drejtës në pension për të gjithë ata që kanë punuar në shtetet tjera;
- Do të vazhdojë ofrimi i shërbimeve për strehim familjar për fëmijë që nuk kanë lidhje farefisnore dhe realizimi i strehimit familjar të fëmijëve pa përkujdesje prindërore;

- Gjithashtu, do të vazhdojë zbatimi i skemës për mbështetje të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme prej 1-18 vjet, me dyfishim të shumës aktuale prej 100 euro në muaj;
- Po ashtu, do të vazhdojë ndihma në strehimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Do të vazhdojë dhe rritet përkujdesja institucionale 24 orësh për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara mendore, për rezidentë që ndodhen në Institutin Special në Shtime dhe në shtatë shtëpi me bazë në komunitet. Do të vazhdojë përkujdesja e shtuar ndaj të moshuarve pa përkujdesje familjare në Shtëpinë për Persona të Moshuar në Prishtinë dhe në dy shtëpi me bazë në komunitet;
- Do të rritet ndihma sociale për familjet me nevojë të përfshirjes në Skemën e Ndhmës Sociale;
- Do të vazhdojë subvencionimi në bashkëpunim me KEK-un i energjisë elektrike për familje në Skemën SNS dhe në Skemën e FDIL-ës. Vazhdimi i përkrahjes për veteranët e luftës, invalidët dhe familjet e dëshmorëve.

1.16.4. Promovimi i ndërmarrësisë për të zvogëluar varësinë nga asistenca sociale

Qeveria do të zhvillojë politika aktive sociale që promovojnë ndërmarrësinë, për ta zvogëluar varësinë nga skemat sociale, nëpërmjet ndërmarrësisë tek të rinjve dhe femrat. Në zonat rurale në veçanti, do të ofrohen mundësi për zhvillim intensiv në bujqësi dhe stimuj të tjerë në fushën e kreditimit bujqësor. Kujdes i veçantë do t'u kushtohet punëtorëve që ndikohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, në mënyrë që ata të mos bëhen barrë e asistencës sociale. Financimi i shtesës për pensionistët kontribut dhënës në ish-Jugosllavi do të rishikohet, nëpërmjet aplikimit të parimit të solidaritetit për këtë kategori, sikurse në vendet e tjera.

2. SUNDIMI I LIGJIT DHE SHTETI LIGJOR

Parimi themelor mbi të cilin do të punojë Qeveria e Republikës së Kosovës është sundimi i ligjit. Qëllimi kryesor i yni do të jetë forcimi dhe shërbimi i Republikës së Kosovës për të gjithë qytetarët e saj, mbështetja në përpjekjet e tyre për të siguruar të ardhura, jetë të qetë dhe të sigurt. Forcimi i shtetit ligjor dhe sigurimi i kohezionit të brendshëm socio-ekonomik, do ta ndihmojë në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Sundimi i ligjit është përcaktues për cilësinë dhe qeverisjen e mirë. Qeveria do të jetë e pa kompromis në luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar, terrorizmit dhe aktiviteteve të lidhura me dukurinë e terrorizmit, krimit ekonomik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe llojeve të tjera të kriminalitetit. Kjo mund të realizohet vetëm me njerëz që kanë duar të pastra dhe që janë të përgjegjshëm.

Qeveria synon që sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë në Kosovë të jetë funksional, profesional, i depolitizuar, i integruar dhe i shtrirë në tërë territorin e vendit, në përputhje me standardet evropiane në fushën e ligjit dhe të sigurisë. Sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë duhet të jete në shërbim të të gjithë qytetarëve. Qeveria e Kosovës e vlerëson si shumë të rëndësishme punën e organeve që merren me sundimin e ligjit, sigurisë së brendshme dhe të jashtme dhe angazhohet për fuqizimin e tyre në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve.

Qeveria do të angazhohet për reformimin e vazhdueshëm të organit të akuzës dhe fuqizimin e saj, si parakusht për luftimin efikas dhe efektiv të kriminalitetit. Qeveria është e përkushtuar për një prokurori të pavarur dhe të paanshme, me qëllim që, pa kompromis, t'i luftojë të gjitha format e kriminalitetit, duke mbrojtur vlerat me vitale të qytetarit dhe të shoqërisë. Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për mbështetjen e profesionit të pavarur të avokatit.

Krahas sukseseve në sektorin e drejtësisë, ekzistojnë edhe sfida të shumta të cilat do të trajtohen me përkushtim të madh nga Qeveria. Me kornizën e re institucionale, sistemi i drejtësisë do të konsolidohet dhe të koncentrohet në përmirësimin e cilësisë, efikasitetit dhe performancës. Sfidë tjetër është edhe marrja e përgjegjësisive ekzekutive nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit – EULEX, si dhe zbatimi i marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, përkatësisht vendosja e një sistemi uniform në tërë territorin e Kosovës. Qeveria e Kosovës do të angazhohet që të mbështes institucionet e pavarura gjyqësore në trajtimin e numrit të madh të rasteve të grumbulluara dhe përmirësimin dhe përpunimin e të dhënave dhe menaxhimit të rasteve.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, Qeveria do të angazhohet të zbatojë reformat e nevojshme për zhvillimin e një sistemi gjyqësor që do të jetë transparent, duke siguruar funksionalizim të plotë të reformës gjyqësore në pajtim me ligjet e aplikueshme, krijimin dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike të gjykatave me qëllim të plotësisimit të nevojave që dalin nga reforma. Qeveria e Kosovës do të mbështes ndërtimin e objekteve të gjykatave themelore në Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë, si dhe do të ofrojë mbështetje për zhvillimin e sistemeve elektronike për menaxhimin e lëndëve, komunikimin

dhe aftësimin e përdoruesve të sistemeve elektronike, rishikimin e strategjisë për menaxhimin e lëndëve të vjetra, funksionalizimin e njësisë për hulumtim dhe analizë, ngritjen e kapaciteteve me bashkëpunëtorë profesional dhe praktikantë gjyqësorë.

Qeveria e Kosovës do të angazhohet për sigurimin e parakushteve dhe administrimin më efikas të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale. Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të reja infrastrukturore në Shërbimin Korrektues dhe sprovues të Kosovës dhe rindërtimi i atyre ekzistuese, me ngritjen profesionale të stafit korrektues dhe sprovues dhe ndërmarrja e masave në risocializimin e të dënuarve, me krijimin e institucioneve të veçanta për ekzekutimin e masave edukuese korrektuese për të mitur në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Do të rritet funksionalizimi i Burgut të Sigurisë së Lartë dhe i dy qendrave të reja të paraburgimit (në Prishtinë dhe Gjilan) dhe aplikimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike për të dënuarit si dhe funksionalizimi i objektit për të mitur me masë edukative. Ndërsa në mjekësi ligjore, përveç ngritjes së kapaciteteve, do të angazhohemi edhe për krijimin e laboratorit të ADN-së, i cili do të merret me trajtimin e lëndëve civile.

Mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore është shtylla kryesore në funksionimin normal të një shteti demokratik. Në fakt, nga kjo varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti. Në Kosovë të drejtat e njeriut dhe liritë garantohen me ligj. Qeveria do t'i vendosë të drejtat e njeriut lart në agjendën e saj politike, si dhe do të rrisë alokimin e buxheteve. Qeveria do të jetë e përkushtuar në respektimin e të drejtave civile, politike, ekonomike dhe sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre nacionale, etnike, fetare, raciale apo gjinore, ashtu siç janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Në këtë kuptim Qeveria e Kosovës do të zbatojë ligjet aktuale dhe do të vazhdojë të përditësojë strategjitë për të drejtat e njeriut, duke siguruar qasje afatgjatë në këtë drejtim. Qeveria do të miratojë ligje të reja me synimin të plotësojnë legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këtu do të përfshihen ligjet antidiskriminim, Avokatin e Popullit dhe barazinë gjinore.

Barazia e qytetarëve para ligjit, gjykimi i drejtë, mos-diskriminimi, e drejta pronësore, liria e siguria, dinjiteti i njeriut dhe të drejtat e tjera qytetare janë themelet e rendit kushtetues e ligjor në Kosovë, prandaj Qeveria angazhohet fuqishëm për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe të drejtave. Qeveria do të fokusohet në fuqizimin e rolit dhe pozitës së grave dhe vajzave në shoqëri, hartimin dhe zbatimin e politikave adekuate për fuqizim ekonomik të tyre, me qasje ndër sektoriale të përcjella me resurse adekuate për zbatim. Qeveria do të vazhdojë me fuqizimin e mekanizmave institucional për barazi gjinore. Qeveria e Kosovës do të respektojë dhe zbatojë të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë, duke treguar përkushtim për integrimin e plotë të tyre në shoqërinë kosovare. Një përkushtim i veçantë do t'i kushtohet të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Qeveria, gjithashtu do të fokusohet në zbatimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve, atyre ekonomike, sociale e kulturore, të personave me aftësi të kufizuara, të komunitetit LGBT, të organizimit sindikal, të pronës, të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda në Kosovë. Qeveria do të angazhohet në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qeniet njerëzore, si dhe të ofrojë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme viktimave të krimeve të dhunës (trafikimit më qenie njerëzore, dhunës në familje, krimet të organizuar, etj.).

Më tej, Qeveria do të mbrojtë të dhënat personale, si dhe do të luftojë krimin kibernetik. Në mënyrë specifike, Qeveria do të sigurojë që rekomandimet e Avokatit të Popullit të adresohen në mënyrë adekuate dhe do të krijojë kushte që ky institucion i pavarur të kryej përgjegjësitë e veta kushtetuese.

2.1. Avancimi i legjislacionit në fushën e drejtësisë

Legjislacioni në fushën e drejtësisë është një segment i rëndësishëm, i cili do të trajtohet me prioritet. Përpos ndryshimeve dhe miratimit të ligjeve të reja, që mundësojnë luftimin e korrupsionit, por edhe krimin të organizuar, ligjet që do të plotësohen në mënyrë prioritare janë:

- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ka pasur vërejtje që kanë ardhur nga Komisioni i Venecias rreth përbërjes së KGJK-së dhe mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së. Këto rekomandime shkojnë në atë drejtim që anëtarët e KGJK-së të zgjedhën nga ana e anëtarëve të Gjyqësorit);
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Standard i Komisionit të Venecias, njëherësh edhe rekomandim është ndryshimi i përbërjes së KPK-së, në mënyrë që të pamundësohet përfaqësimi i kryeprokurorëve në këtë organ, për të mbajtur aktive llogaridhënien efektive. Në frymën e rekomandimeve për funksionimin e llogaridhënies, Komisioni i Venecias ka rekomanduar po ashtu që kryeprokurori të mos e udhëheq KPK-në);
- Ligji për Gjykatat;
- Ligji për Prokurorin e Shtetit;
- Ligji për Financimin e Partive Politike;
- Ligji për Ndarjen e Administratës Gjyqësore dhe Prokuroriale.

Qeveria do të vazhdojë me avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i integritetit evropian. Do të vazhdohet me plotësimin e kornizës ligjore, lehtësimin e punës së gjyqësorit nëpërmjet funksionimit të sistemit të noterisë, jurisprudencës, ndërmjetësimit, administratorëve falimentues dhe përmbauesve privat, luftimin dhe parandalimin e krimin, e keqpërdorimeve të mundshme nga të ardhurat kriminale nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar ose konfiskimit të cilat gjenerojnë fitime të mëdha, përmirësimin në përafrimin e legjislacionit dhe eliminimin e kolizionit të ligjeve, vazhdimin e mbështetjes për çështje pronësore dhe funksionalizimin e Avokaturës Shtetërore.

Pas pranimit të Kosovës në Këshillin e Evropës duhet të bëhet pranimi i të gjitha konventave në fushën e drejtësisë, që vijnë nga ky mekanizëm.

Gjithashtu, prioritet i Qeverisë duhet të jetë edhe rregullimi dhe më tutje bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale, nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta. Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sistemit të ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, Qeveria do të angazhohet për krijimin e kushteve me të sigurta për personelin dhe sigurimin e pajisjeve adekuate për ruajtjen e dosjeve, lëndëve të ndjeshme dhe të besueshme, ngritjen e

kapaciteteve profesionale të stafit, të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kompletimin e kornizës ligjore sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

2.2. Luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar

Lufta kundër korrupsionit ka vazhduar të mbetet një prej sfidave kryesore të shoqërisë sonë dhe prioritet i vazhdueshëm i institucioneve të Kosovës. Sfida kryesore në luftën kundër korrupsionit është mungesa e rezultateve të shumta në hetimet e korrupsionit, mungesa e transparencës dhe llogaridhënia në procesin e prokurimit dhe zbatimi i dobët i legjislacionit. Me gjithë krijimin e kornizës të përgjithshme për luftimin e korrupsionit, kjo dukuri mbetet një nga sfidat kryesore të institucioneve të Kosovës në përgjithësi, në veçanti konsiderojmë se Kosova duhet të intensifikoj përpjekjet në hetimin, përndjekjen dhe dënimin e rasteve që ndërliken me korrupsion.

Qeveria do të tregojë qasje me zero tolerancë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Qeveria do të jetë e përkushtuar fuqishëm të përmirësojë dhe forcojë kornizën legjislative dhe institucionale për luftimin e korrupsionit. Kjo do të arrihet duke bërë efektive politikat kundër korrupsionit nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për zbatimin e kornizës legjislative dhe strategjike lidhur me këtë qëllim.

Qeveria do të zbatojë legjislacionin antikorrupsion, si dhe do të miratojë ligje të reja për të plotësuar më tej legjislacionin përkatës. Qeveria do të angazhohet në parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, edukimit të administratës publike për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të nevojshme.

Qeveria është e vetëdijshme që luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është esencial në luftimin e depërtimit të krimit në sistemet politike, legale dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, Qeveria ka vullnetin e qartë të luftojë në mënyrë efektive korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke zbatuar strategjitë ekzistuese dhe planet, si dhe duke pranuar rezultatet e proceseve të pavarura gjyqësore.

Strategjia e re kundër korrupsionit dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, paraqet një bazë të fuqishme dhe të avancuar që synon të adresoj korrupsionin nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse që do të mbulojë gjithë shoqërinë, duke filluar nga legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori deri tek sektori privat, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile. Megjithatë sfida kryesore mbetet mungesa e buxhetit dhe mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e strategjisë nga institucione të ndryshme.

Për luftimin e korrupsionit në rastet që kanë të bëjnë me fushën e Prokurimit Publik nevojitet të ketë me shumë trajnime të përbashkëta, sidomos në sferën e ngritjes profesionale për njohuritë nga fusha e Prokurimit Publik, pasi që në këtë fushë njohuritë e shumë prokurorëve ende janë shumë bazike.

2.3. Rregullimi dhe unifikimi i drejtësisë civile

Qeveria do të ketë prioritet unifikimin e legjislacionit civil, në drejtim të krijimit të një kodi të përbashkët civil, ku do të përfshiheshin të gjitha ligjet e fushës civile. Qeveria e Kosovës do t'i kushtojë vëmendje të veçantë konsolidimit të sistemit të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit. Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi garanton shmangien e burokracive dhe procedurave të zgjata të gjyqësorit shtetëror duke u dhënë zgjidhje më të shpejtë e efikase problemeve. Duke ia lënë hapësirën nismës private dhe angazhimit vullnetar të palëve të interesuara në këto forma alternative të drejtësisë, do të synojmë që të uljet ngarkesa në gjykata, respektivisht uljen e numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura në gjykata, duke bërë që sistemi të bëhet më efikas e të fokusohet në probleme më të rënda apo në ato lëndë që nuk mund të jenë të zgjidhshme përveçse prej sistemit konvencional të drejtësisë.

Do të merren masa që të rritet numri i punonjësve të institucioneve të drejtësisë, në mënyrë që këto institucione të jenë më efikase dhe të shpejta në veprimtarinë e tyre. Po ashtu, do shtohet mbështetja logjistike, si dhe stafi administrativ i gjyqtarëve apo i prokurorëve, në mënyrë që ata ta bëjnë punën e tyre sa më lehtë e më shpejtë.

2.4. Integrimi i plotë i komunave veriore në sistemin e drejtësisë

Qeveria do të ketë prioritet të rëndësishëm integrimin e komunave veriore në sistemin e drejtësisë dhe funksionalizimin e institucioneve të drejtësisë në pjesën veriore. Një gjë e tillë do të rriste në masë të madhe besueshmërinë e qeverisjes tek qytetarët, por edhe do të forconte vetë sundimin e ligjit. Është e qartë se një gjë e tillë nuk mund të bëhet menjëherë, nëpërmjet veprimeve të shpejta, por kësaj çështje duhet paraprirë me një proces politik i konkretizuar me veprime konkrete, që do të mundësonin një integrim të komunave veriore në sistemin e drejtësisë.

2.5. Vazhdimi i Reformës së Administratës Publike

Administrata Publike, e ndërtuar mbi parimet evropiane, si një faktor kyç për ofrimin e shërbimeve për qytetarin dhe që të jetë sa më afër tij, është synimi kryesor i Qeverisë. Qeveria e Kosovës beson thellë se administrata publike duhet të jetë në shërbim të qytetarëve dhe e bazuar në vlera e jo në interesa të ngushta.

Ministria e Administratës Publike, si bartëse e procesit të koordinimit dhe menaxhimit të reformës së administratës publike, deri më tani ka ndërmarrë një sërë veprimesh për përmirësimin e shërbimeve të administratës publike, ku një numër i konsiderueshëm i shërbimeve tanimë janë digjitalizuar dhe ato ofrohen në formë elektronike. Po ashtu, është kompletuar thuajse e tërë infrastruktura e nevojshme ligjore për avancimin e proceseve në shërbimin civil të Kosovës. Tashmë është ndërtuar një bazë e mirë për ngritjen e profesionalizmit në shërbimin civil.

Në përgjithësi, viteve të fundit është punuar në plotësimin e kornizës strategjike dhe legjislative për funksionimin e një administrate funksionale dhe tanimë është krijuar një bazë e qëndrueshme. Nevojitet një përqendrim më i thelluar në krijimin e një kornize strategjike për Reformën e Administratës Publike, zhvillimin dhe koordinimin e politikave, avancimin

dhe ofrimin e shërbimeve publike, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e financave publike. Qeveria do të sigurojë një sistem të integruar të planifikimit strategjik, me qëllim të ngritjes së cilësisë së politikave, do të zhvillojë një sistem ligjor koherent e të qëndrueshëm në administratën publike që ofron mekanizma efektivë të monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe të legjislacionit.

Nga analizat e dala nga monitorimi i zbatimit të reformës së administratës publike është konkluduar se strategjia e radhës për Reformën e Administratës Publike duhet të jetë më e fokusuar, planifikimet të jenë të zbatueshme dhe të përcjella edhe me burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe të tjera. Prandaj për strategjinë e ardhshme të reformës, si prioritete për fushën e administratës publike janë:

- Korniza Strategjike për Reformën e Administratës Publike (RAP): Krijimi i kohezionit të mirëfilltë të SRAP-it me dokumentet e tjera strategjike e sidomos me KASH-in dhe planin vjetor të buxhetit. Po ashtu, edhe rritja e përkushtimit të të gjithë mekanizmave përgjegjës për zbatimin e RAP-it;
- Zhvillimi dhe koordinimi i politikave: një koordinim sa më adekuat ndërinstitucional, në qendër të qeverisë, ndërministror, zhvillim të politikave dhe analiza sa më të thukëta financiare;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore në Administratën Publike: një shërbim publik i strukturuar bazuar në standarde, një shërbim jopolitik, i bazuar në rekrutim të drejtë dhe transparent, promovim në bazë të meritës dhe ngritje profesionale. Po ashtu, synohet ndërtimi i një sistemi unik i pagave në Administratën Publike, si dhe digjitalizimi i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Llogaridhënia: përmirësimi i shërbimeve nëpërmjet rritjes së transparencës dhe fuqizimit të mekanizmit të ankesës dhe qasjes në dokumentet publike, që rezultojnë edhe në mundësinë e korrigjimit administrativ dhe ligjor;
- Avancimi i qeverisjes: avancimin e shërbimeve për ofrimin e shërbimeve më të mira nëpërmjet qeverisjes elektronike (e-qeverisjes), si një mundësi më e shpejtë, më e lirë dhe më efiçiente. Aplikimi më i thellë dhe i gjerë i qeverisjes elektronike ka për qëllim përmbushjen më të mirë të politikave, sigurimi i shërbimeve më cilësore për publikun, përdorimin më efikas dhe ekonomik të fondeve publike, procese më efikase dhe të shpejta të administratës dhe qeverisjes, përfshirje më të madhe të qytetarëve dhe bizneseve dhe ajo që është më e rëndësishme, një nivel më të lartë transparence për publikun;
- Menaxhimi i Financave Publike: ngritja e cilësisë së planifikimit të dokumenteve strategjike financiare, monitorimi i shpenzimeve dhe raportimi. Po ashtu, synohet edhe rritja e qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet vendimeve financiare të mbështetura në politika qeveritare dhe me vlerësime kualitative të ndikimit financiar të politikave dhe dokumenteve strategjike dhe ligjore.

Për të siguruar që shërbyesit tanë civilë i respektojnë parimet e etikës dhe disiplinës, Qeveria e Kosovës do të zhvillojë një Kod gjithëpërfshirës të Etikës për Shërbimin Civil, i cili do të përfshijë të dhëna të detajuara për çështjet që kanë të bëjnë më sjelljen e shërbyesve civilë.

Për më tepër, do të zhvillohet funksioni i inspektimit të Administratës Publike, i cili do të sigurojë respektimin e Kodit të Etikës dhe përdorimin adekuat të masave disiplinore.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi të veçantë plotësimit të kornizës ligjore dhe zbatimit të programit të statistikave zyrtare në përputhje me standardet ndërkombëtare, të rëndësishme për analizimin e gjendjes, si dhe orientimin dhe planifikimin të mirëfilltë të politikave qeveritare.

2.6. Rritja e transparencës dhe e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje

Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i praktikave të Qeverisë mbështetet në masë të madhe në aftësinë e publikut për të pasur qasje në informacionet me interes. Qeveria do të punojë për të siguruar dhe krijuar një sistem të transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në politikë bërje. Duke qenë e vetëdijshme se pjesëmarrja e qytetarëve ndikon direkt në efektivitetin e punës së saj, Qeveria do të promovojë transparencën, për të ofruar informacionet për qytetarët lidhur atë çfarë po bën Qeveria.

Legjislacioni i deritanishëm ka mundësuar transparencë më të madhe në raport me qytetarët dhe duhet theksuar se qasja në dokumente zyrtare të Qeverisë është përmirësuar dukshëm. Në kuadër të procesit të reformimit dhe zhvillimit të pushtetit lokal është mundësuar që, në përputhje me vlerat më të përparuara të demokracisë perëndimore, shërbimet e administratës së pushtetit lokal, të jenë të drejtpërdrejta dhe sa më cilësore ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës. Duke synuar arritjen e standardeve më të larta në këtë drejtim, Qeveria do të bëjë përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e kornizës legjislative dhe institucionale, por edhe në zbatimin e dispozitave ligjore, që sanksionohen nëpërmjet Kushtetutës, konventave ndërkombëtare dhe akteve të tjera juridike.

Një qeverisje demokratike kërkon të forcohet marrëdhënia ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë së tyre, prandaj Qeveria e Kosovës do të ofrojë mekanizma për të ofruar informacionet për qytetarët që ata të sigurohen që interesat e tyre janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate. Përdorimi i teknologjisë së informacionit do të zë një vend të rëndësishëm në tërë këtë proces.

2.7. Vazhdimi i reformës zgjedhore

Një ndër çështjet e rëndësishme që do të ketë parasysh Qeveria është reforma zgjedhore dhe krijimi i mekanizmave efikase që do të garantonin zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Institucionet e Kosovës kanë arritur të kompletojnë legjislacionin bazik të nevojshëm për të garantuar të drejta dhe liri fundamentale për zgjedhje demokratike bazuar në standarde ndërkombëtare. Në thelb ligjet që ndërlidhen me zgjedhjet janë Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji mbi Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës do të angazhohet për ndryshime zgjedhore, të cilat të adresojë në mënyrë të plotë problemet e mprehta që janë ballafaquar në Kosovë. Reforma duhet të kryhet në mënyrë transparente e në frymë konsensuale, duke marrë parasysh më të mirën për Kosovën, pas një debati të gjerë publik me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve politikë si dhe përfaqësues

të shoqërisë civile dhe botës akademike. Qeveria e Kosovës do të mbështesë adoptimin e një sistemi zgjedhor që ka nivelin më të ulët të mundshëm të shtrembërimit të votës dhe që do të ketë në të ardhmen përdorimin e teknologjisë më të avancuar dhe adoptimin e praktikave më të suksesshme. Në këtë kuadër, Qeveria e Kosovës do të mbështes procesin e pastrimit të listave zgjedhore, motivimin e daljes të sa më shumë votuesve në zgjedhje, si dhe rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë votimit të diasporës, nëpërmjet krijimit të mundësive edhe më të lehta, me sa më pak procedura burokratike për votim, nëpërmjet postës si dhe përfaqësive tona diplomatike.

2.8. Zbatimi i Strategjisë për Partneritet me Shoqërinë Civile

E vetëdijshme që një shoqëri civile e fuqishme është komponentë esenciale për një sistem qeverisjeje demokratike, Qeveria e Republikës së Kosovës do ta trajtojë si të tillë shoqërinë civile dhe bashkëpunimin më të thellë me të në secilin dimension të punës qeveritare. Qeveria e Kosovës, duke besuar thellë se roli i shoqërisë civile është me rëndësi për demokracinë aktive dhe se pa shoqëri civile të fortë, nuk ka zhvillim të qeverisjes dhe demokracisë, do të vazhdojë angazhimin për konsolidimin më tutje të raporteve me shoqërinë civile, në kuptimin e gjerë të fjalës, si element bazik i demokracisë dhe si nevojë për një qeverisje të mirë dhe gjithëpërfshirëse.

Qeveria do të ketë vullnetin dhe gatishmërinë për të forcuar edhe më tutje pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e hartimit dhe të zbatimit të politikave dhe të ligjeve. Në këtë mënyrë synohet që në vitet në vijim do të avancohet edhe më tutje bashkëpunimi me shoqërinë civile nëpërmjet bartjes së disa përgjegjësive publike, për t'u kryer nga shoqëria civile për qytetarët. Tashmë modele të tilla realizohen me sukses në demokracitë e zhvilluara, si: shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, për personat e trafikuar etj. Në mënyrë specifike, Qeveria do të vazhdojë të zbatojë Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, si dhe do të krijojë mekanizma të tjerë të nevojshëm që lidhen me këtë. Qeveria e Kosovës është e bindur që roli i shoqërisë civile është me rëndësi për demokracinë aktive. Pa shoqëri civile të fortë, nuk ka zhvillim të qeverisjes dhe të demokracisë.

2.9. Garantimi i lirisë së shprehjes dhe i lirisë së mediave

Qeveria e Kosovës beson fuqishëm se liria e shprehjes, përfshirë lirinë e mediave, është esenciale për një shoqëri demokratike. E ndërjegjeshme se pa lirinë e shprehjes, qytetarët nuk mund të realizojnë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, Qeveria e Kosovës do të punojë për të garantuar lirinë e shprehjes sipas standardeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe të standardeve profesionale, si dhe të mos ndërhyjë në asnjë formë. Edhe përkundër përparimeve që janë bërë në këtë drejtim, Qeveria do të angazhohet që kjo të avancojë edhe më tutje, duke siguruar respektimin e të drejtës për lirinë e shprehjes. Qeveria do të përkushtohet që çështje si autonomia e gazetarëve dhe botuesve, mbrojtja e standardeve profesionale të gazetarisë, e drejta për përgjigje dhe korrigjim për publikun të rregullohen me legjislacione përkatëse sipas standardeve demokratike ndërkombëtare.

Në prioritetet e veta Qeveria do ta ketë edhe miratimin e Ligjit për Bashkësitë Fetare, meqenëse ky ligj do të mundësoj trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të komuniteteve fetare në mënyrë unike.

2.10. Aprovimi i Ligjit për Parandalimin e Pjesëmarrjes në Konfliktet e Jashtme

Qeveria do të sigurojë që Republika e Kosovës të jetë faktor stabiliteti e bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Qeveria do të punojë në ngritjen e kapaciteteve të saj që të parandalojë radikalizmin, përfshirë zhvillimin e masave adekuate për të adresuar fenomenin e luftëtarëve të huaj. Në një afat kohor shumë të shpejtë, Qeveria do të miratojë legjislacionin përkatës që sanksionon pjesëmarrjen e qytetarëve të saj në konfliktet e armatosura në vendet e huaja, si dhe në aktivitetet terroriste.

2.11. Lufta kundër terrorizmit

Qytetarët dhe Qeveria e Republikës së Kosovës janë të përkushtuar për të jetuar në një shtet paqësor, prosperues dhe shumetnik, që garanton liritë dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa asnjë dallim, sikurse është mishëruar me Kushtetutë. Qeveria do të jetë e përkushtuar që Kosova të jetë pjesë e koalicionit global në luftën kundër terrorizmit. Në një afat kohor shumë të shpejtë, Qeveria do të miratojë legjislacionin përkatës si dhe do të hartojë politika të qëndrueshme për të parandaluar dhe për të luftuar terrorizmin. Për më tej, Republika e Kosovës aspiron të bëhet pjesë përbërëse e strukturave rajonale dhe globale të sigurisë, në veçanti e NATO-së, BE-së, OSBE-së dhe OKB-së, si dhe do të përkushtohet që të ngritët bashkëpunimi me të gjitha vendet për të luftuar terrorizmin.

2.12. Aprovimi i Ligjit për Gjykatën e Posaçme

Ligji për themelimin e Gjykatës së Posaçme, sipas vendimit të Kuvendit, do të jetë një ndër sfidat kryesore të Qeverisë dhe të Legjislaturës së re. Qeveria do të trajtojë me prioritet hartimin dhe miratimin e Ligjit për themelimin e kësaj Gjykate. Qeveria me prioritet do të hartojë dhe do t'i propozojë Kuvendit për aprovim, Ligjin për themelimin e kësaj Gjykate, që tanimë është marrë si obligim ndërkombëtar nga ana e Republikës së Kosovës në proceset integruese.

3. AGJENDA EVROPIANE DHE POLITIKA E JASHTME

3.1. Parimet

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, politika e jashtme e Kosovës do të jetë vazhdimësi dhe reflektim i politikës së brendshme dhe në funksion të ruajtjes së sovranitetit, integritetit territorial, rendit kushtetues, lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit dhe garantimit të sigurisë së saj shtetërore. Forcimi i shtetit të Kosovës në dimensionin e brendshëm do të ndikojë pozitivisht edhe në atë të jashtëm. Politika e jashtme e konsoliduar dhe efikase do të reflektohet pozitivisht edhe në zhvillimet e brendshme, sidomos në rrafshin e investimeve dhe aspekte tjera.

3.2. Njohjet

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës do të mbetet prioritet i Qeverisë së Kosovës. Procesi i njohjes së Kosovës ka treguar se shteti i Kosovës është një realitet i pakthyeshëm dhe një faktor i domosdoshëm paqes dhe i stabilitetit në rajon. Më së miri kjo demonstron nga fakti i njohjes formale të Kosovës nga të gjitha vendet fqinje (me përjashtim të Serbisë), shumica e shteteve nga rajoni dhe komunitetit Euro-Atlantik. Arritjet e deritanishme janë një meritë e diplomacisë pro-aktive dhe dinamike të Kosovës, por edhe një meritë e partnerëve tanë ndërkombëtarë që kanë mbështetur procesin e njohjes përmes lobimit në emër të Kosovës.

Qeveria e Kosovës do të mbetet fuqimisht e angazhuar për të lobuar për njohje ndërkombëtare nga ana e shteteve anëtare të OKB-së, me qëllim të forcimit të pozicionit ndërkombëtar të Kosovës dhe për të vendosur marrëdhënie diplomatike me shumicën e shteteve anëtare të OKB-së. Kosova ka arritur 108 njohje, në këtë mënyrë ka arritur qëllimin për të pasur më shumë se 100 vende që njohin Kosovën. Ministria e Punëve të Jashtme do të synojë gjatë mandatit të ardhshëm të arrijë njohjen e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran nga 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së. Arritja e këtij synimi do të fuqizojë Kosovën si një anëtar i plotë dhe i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare dhe do të jetë një kontribut i rëndësishëm për paqen, stabilitetin dhe sigurinë e rajonit. Gjithashtu, një shtysë e fuqishme drejt pranimit të saj formal si shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara.

Përkushtimi i Qeverisë së Kosovës për të përfunduar njohjen ndërkombëtare duhet të përqendrohet në një komunikim diplomatik me shtetet e mëdha që nuk e kanë njohur ende Kosovën, brenda Evropës dhe më gjerë. Kosova do të vazhdojë më përpjekjet saj proaktive për të bindur pesë vendet anëtare të BE se njohja e Kosovës është një vendim i drejtë dhe në interes të stabilitetit dhe unitetit evropian.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të mbetet fuqishëm e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vazhdimin e dialogut, që do të synohet të finalizohet më njohjen e ndërsjellë e që do të mundësonte ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes të dyja vendeve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike e të mira fqinjësore, në frymën evropiane.

Qeveria e Kosovës do të angazhohet në mënyrë aktive me vendet në Afrikë, Azi dhe Amerikën Jugore për t'i bindur ato për nevojën e njohjes së Kosovës dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Kosova do të shfrytëzojë organizatat rajonale që të nxisë grupimet e vendeve për ta marrë vendimin për njohjen e Kosovës dhe do të përdorë organizatat multilaterale, si Frankofonia, për të mbështetur Kosovën si shtet i pavarur dhe sovran.

E rëndësishme mbetet njohja e Kosovës nga Rusia, Kina, Brazili, India dhe Afrika e Jugut, si vende më ndikim në arenën ndërkombëtare dhe në rajonet e tyre përkatëse. Qeveria vlerëson se pozicioni i tyre i pafavorshëm ka pësuar ndryshim të theksuar. Për më tepër, do të vazhdohet të punohet me fuqitë e tjera rajonale, si: Indonezia, Nigeria, Meksika, Kenia, Kili, Paraguai, Bangladeshi dhe shtete të tjera me ndikim në rajone të ndryshme.

Fuqizimi i mëtejshëm i pozitës ndërkombëtare të Kosovës është prioriteti kryesor i politikës së jashtme. Një nga synimet kryesore të qasjes së Kosovës në politikën e jashtme është rëndësia që i jep forcimit të marrëdhënieve dypalëshe. Pjesa më e madhe e përpjekjeve ndërkombëtare të Kosovës është dypalëshe dhe Kosova mbetet e angazhuar për të zhvilluar tutje marrëdhëniet dypalëshe.

Me rritjen e numrit të njohjeve, një prioritet vazhdon të mbetet vendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet që e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Marrëdhëniet diplomatike fuqizojnë njohjen e Kosovës nga një shtet dhe forcojnë pozitën si një anëtar i plotë i bashkësisë ndërkombëtare. Gjithashtu, këto marrëdhënie kanë potencial për të sjellë përfitime të tjera të rëndësishme, siç janë investimet e huaja, shkëmbimet tregtare etj.

Përveç vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me vendet kyçe në kontinente të ndryshme, Qeveria e Kosovës synon të zhvillojë marrëdhënie përtej atyre tradicionale diplomatike, sikurse inicimin e konsultimeve të rregullta politike, nënshkrimin e marrëveshjeve për heqjen e regjimit të vizave, mbrojtjen e investimeve si një prioritet për të krijuar një bashkëpunim të mirë dhe bazë ligjore të konsoliduar.

3.3. Integrimi Evropian

Integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian do të vazhdojë të jetë prioritet shtetëror në funksion të zhvillimit dhe transformimit shoqëror, ekonomik dhe politik të Kosovës. Arritja e këtij objekti në mënyrë të plotë do të mundësojë që vendi të forcojë subjektivitetin ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin në këtë pjesë të Evropës, duke u bazuar në parimet dhe vlerat demokratike. Qeveria e Kosovës është e bindur se mënyra më efikase e avancimit politik, ekonomik dhe social të vendit është zbatimi me përgjegjësi i obligimeve dhe kushteve që rrjedhin nga procesi i integritimeve evropiane. Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet dhe është e përkushtuar për zbatimin e vazhdueshëm të reformave të nevojshme në fusha të ndryshme, si: sundimi i ligjit, reformat në Administratën Publike, zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e të drejtave të njeriut etj.

Zbatimi koherent i këtyre politikave do të ndikojë pozitivisht në evropianizimin e vendit dhe po ashtu do t'i mundësojë Republikës së Kosovës, brenda një kohe të arsyeshme, anëtarësimin si shtet i barabartë në Bashkimin Evropian. Zbatimi i Programit qeverisës në fushën e politikës së Jashtme dhe Integritimit Euroatlantik do t'i mundësojë Qeverisë së Republikës së Kosovës të vazhdojë të mbetet partner i besueshëm dhe i mirëpritur i komunitetit ndërkombëtar.

Harmonizimi i politikës së jashtme të Kosovës me atë të BE-së (MSA) dhe nisja e dialogut politik të përbashkët në kuadër të implementimit të MSA-së paraqesin objektiv strategjik të Kosovës. Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë e BE-së në shumë aspekte ka përputhje natyrale me politikën e jashtme të Kosovës dhe me vizionin dhe identitetin shtetëror të saj. Dialogu politik do të ndërmerret për të integruar, përafruar dhe harmonizuar qëndrimet në mes të Kosovës dhe të BE-së për çështje ndërkombëtare, bashkëpunim rajonal dhe fqinjësinë e mirë.

Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocimin shërben për evropianizimin e politikave shtetërore. Fokusi i Qeverisë së Kosovës ka qenë fillimi sa më i shpejtë i këtij procesi, si dhe përmbajtja e tekstit të MSA-së të jetë e plotë, duke lobuar rregullisht tek institucionet vendimmarrëse të BE-së dhe kryeqytetet e vendeve anëtare që integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian të jetë prioritet.

Gjatë këtij mandati, Qeveria do të jetë e përkushtuar që të arrijë nënshkrimin e MSA-së, duke punuar në dy drejtime, atë me shtetet anëtare të BE-së, ku Qeveria do të përpiqet të sigurojë vendimin unanim nga Këshilli për nënshkrim të MSA-së me Kosovën, si dhe atë me Parlamentin Evropian, ku Qeveria do të shfrytëzojë të gjitha resurset në dispozicion për të lobuar tek deputetët e Parlamentit Evropian dhe grupet parlamentare për finalizimin e MSA-së. Nënshkrimi dhe formalizmi i MSA-së do të jetë prioritet afatshkurtër i Qeverisë së Kosovës dhe do të finalizohet gjatë vitit 2015.

Hyrja në fuqi e MSA-së në fillim të vitit 2016 do të paraqesë një vazhdim të integritit të mëtutjeshëm të Kosovës në BE, si dhe do të hapë një fazë të re në procesin e integritit që ndërlidhet me intensifikimin e zbatimit të MSA-së dhe kryerjes të obligimeve të ndërsjella që dalin nga kjo marrëveshje. Zbatimi i mirëfilltë i MSA-së do të jetë prioritet në vazhdimësi gjatë mandatit të kësaj Qeverie. Hyrja në fuqi e MSA-së obligon Kosovën që të shtyjë përpara zbatimin e marrëveshjes që rezulton në transformimin shoqëror, ekonomik dhe politik të vendit.

Qëllimi strategjik i Qeverisë së Kosovës në katër vitet e ardhshme është aplikimi për statusin e shtetit kandidat të BE-së. Në këtë drejtim, avancimi në zbatimin e MSA-së do t'i mundësojë Kosovës aplikimin për statusin e shtetit kandidat. Qeveria do të jetë e përkushtuar në nënshkrimin, formalizimin dhe zbatimin sa më të shpejtë të MSA-së, në mënyrë që Komisioni të vlerësojë pozitivisht zbatimin dhe Kosova përfundimisht të marrë statusin e vendit kandidat. Sfidë mbeten pesë vendet që nuk kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, krahas lobimit për njohje, do të vazhdojë të zhvillojë politika që rruga e Kosovës drejt BE-së të mos pengohet nga këto vende.

Përmbyllja e procesit të liberalizimit të vizave, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të kenë mundësi të lëvizin lirshëm në gjithë zonën Schengen, do të jetë prioritet afatshkurtër i Qeverisë. Qeveria do të adresojë të gjitha rekomandimet e dala nga raporti vlerësues i Komisionit Evropian dhe, nëpërmjet zbatimit me përpikëri të Planit të Veprimit për Liberalizim të Vizave, do të sigurojë që këtë proces të rëndësishëm për vendin ta përmbyllë sa më shpejtë, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të lëvizin lirshëm në Evropë. Në këtë aspekt, prioritet kyç mbetet zbatimi i Planit të Veprimit që adreson të gjitha sfidat e riatdhesimit, ri-integrimit, sigurisë së dokumenteve, menaxhimit të kufirit dhe migrimit dhe sigurimit të përgjithshëm të rendit publik. Qeveria e Kosovës do t'i shfrytëzojë të gjitha resurset në dispozicion për të lobuar te shtetet e zonës Schengen, për të siguruar përkrahjen e tyre që ky proces të përfundojë me sukses.

Qeveria e Kosovës do të jetë e përkushtuar brenda 6-mujorit të parë të vitit 2015 të nënshkruajë marrëveshjen-kornizë me Bashkimin Evropian, që do t'i mundësojë Kosovës qasjen në programet e BE-së. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje Kosova fiton të drejtën për të marrë pjesë dhe të përfitojë nga programet në sektorë të ndryshëm, si:

- Kulturës dhe rinisë (Kulturë, Rinia në Aksion, Hulumtime dhe Inovacion);
- Çështjeve ekonomike (Programin për Ndërmarrësi dhe Inovacionit);
- Programi i Komunitetit për Punësim dhe Solidaritetit Social;
- Programin për Veprimet e Komunitetit në fushën e mbrojtjes së Konsumatorit dhe
- Programet e çështjeve të tjera sektoriale, si: Programi GALILEO, Programi mbështetës për politikën e TIK-ut , Shëndetit publik etj.

3.4. NATO-ja dhe siguria

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të ruajë sigurinë e saj të brendshme dhe të jashtme. Përafrimi drejt anëtarësimit në NATO do të ndihmojë në këtë drejtim. Aleanca Veri-atlantike do të vazhdojë të jetë instrumenti kryesor multilateral i politikës së mbrojtjes dhe sigurisë së Kosovës në aspektin diplomatik dhe ushtarak. Nëpërmjet përafrimit kontraktual në NATO, Kosova do jetë pjesë e kornizës së mbrojtjes kolektive për parandalimin e kërcënimeve të mundshme, sfidave dhe rreziqeve për stabilitetin e vendit dhe të rajonit.

Kosova do të vazhdojë të angazhohet për të arritur anëtarësimin në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP) të NATO-s dhe mekanizmat e tjerë Euro-Atlantike, për të avancuar marrëdhëniet me NATO-n dhe për të forcuar stabilitetin, sigurinë dhe paqen në Kosovë dhe në rajon. Kosova do të rrisë angazhimin në mekanizma dhe struktura rajonale të sigurisë, për të qenë partner i përgjegjshëm i NATO-s në rajon. Rëndësia e anëtarësimit në programin e PfP-së konsiston në dy aspekte: në atë politik dhe ushtarak.

Në aspektin politik, nëpërmjet PfP-së Kosova synon të fillojë një kapitull të ri bashkëpunimi dhe partneriteti me NATO-në, e që përbën gjysmën e rrugës për integrim të plotë në strukturën Euro-Atlantike; synon të hapet mundësia për nënshkrim të marrëveshjeve

bilaterale me anëtarët e PFP-së. Në këtë kuptim, Kosova do të përfitojë nga mundësia e hapjes së përfaqësisë diplomatike në selinë politike dhe ushtarake të NATO-s, me qëllim të pjesëmarrjes së barabartë në forumet politike dhe diplomatike të NATO-s, si dhe synohet qasja në fondet dhe thirrjet për financim të NATO-s në rajon, dedikuar institucioneve dhe shoqërisë civile.

Në aspektin ushtarak, Kosova synon të jetë pjesëmarrëse në stërvitjet e përbashkëta ushtarake me anëtarët e NATO-s dhe anëtarët e PFP-së, me qëllim që gradualisht të përfshihet në grupet gjeografike të fushëbetëve “battlegroups”, duke përfituar edhe qasje të drejtpërdrejta në shtatë qendrat e ndryshme të trajnimit. Po ashtu, do të hapte mundësinë e dërgimit të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Kosovës në akademitë ushtarake në vendet partnere, duke dinamizuar dhe intensifikuar përvojat.

Gjatë këtij mandati qeverisës, Kosova do të vazhdojë të zhvillojë kapacitete e saj në funksion të sigurisë, si dhe për të kontribuar në misionet ndërkombëtare të paqes, dialogut dhe zgjidhjes së krizave dhe asistencës humanitare e zhvillimore. Përkushtim të veçantë do të vazhdohet t'i jepet procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, bazuar në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (2014-2024), duke vazhduar profesionalizimin e saj në bashkëpunim të ngushtë me NATO-në, si dhe në rrafshin bilateral me partnerët Euro-atlantikë.

Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK) do të jenë forcë profesionale e udhëhequr sipas parimeve të kontrollit demokratik dhe civil, integruar gradualisht në strukturat euro-atlantike dhe e gatshme të kontribuojë në sigurinë dhe paqen rajonale dhe globale, krahas ushtrive simotra të saj nga NATO-ja.

Specifikisht, një proces tranzicioni do të ndodhë me kalimin në Ministrinë e Mbrojtjes nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës në kuadër të parimit të mbikëqyrjes civile të sigurisë. Kjo infrastrukturë e re e mbrojtjes bazohet në vizionin e Republikës së Kosovës si shtet që promovon stabilitet dhe siguri, jo vetëm për nevojat e brendshme të saj, por edhe për rajonin dhe Evropën e më gjerë, duke besuar se siguria shtetërore është e lidhur ngushtë me sigurinë rajonale dhe sigurinë më të gjerë Euro-Atlantike.

FAK-u do të ketë për mision Interesat dhe Objektivat e sigurisë shtetërore të Republikës së Kosovës, siç janë: pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial; rendi kushtetues; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve; stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare; integrimi dhe bashkëpunimi me strukturat e Bashkimit Evropian dhe Euro-Atlantik.

Në bashkëpunim të ngushtë mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, do të vazhdojë të rritet prania e Atasheve të Mbrojtjes dhe atyre të Sigurisë nëpër misionet diplomatike të Republikës së Kosovës, me qëllim të avancimit dhe promovimit të interesave në kuadër të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë. Po ashtu, përveç se me SHBA-të dhe Republikën e Shqipërisë, do të vazhdohet nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale mbi statusin

e forcave SOFA me shtetet partnere të Republikës së Kosovës, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh për promovimin e sigurisë, paqes dhe të stabilitetit.

Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të rendit dhe të sigurisë në Kosovë, për të ofruar një ambient të sigurt dhe të qetë në vend. Fokus i veçantë do t'i kushtohet modernizimit të Policisë së Kosovës dhe forcimit të kapaciteteve të saj, në veçanti në fushat që kanë të bëjnë me hetimin dhe zbulimin e krimit të organizuar, korrupsionit, luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit radikal. Synim do të jetë anëtarësimi në INTERPOL dhe avancimi i bashkëpunimit me EUROPOL-in, në shërbim të forcimit të sigurisë së brendshme dhe asaj rajonale. Kosova, si një partner i përkushtuar i komunitetit Euro-Atlantik, do të vazhdojë të mbetet e angazhuar për të mbështetur aleatët e saj në ballafaqimin me sfidat të ndryshme të sigurisë globale, siç janë: terrorizmi dhe ekstremizmi fetar. Do të vazhdojë të ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e kërcënimeve ndaj rendit kushtetues të saj dhe karakterit laik të shtetit.

3.5. Marrëdhëniet shumëpalëshe (multilaterale)

Kosova do të vazhdojë përpjekjet për t'u bërë anëtare e plotë e OKB-së, agjencive të saj të specializuara dhe të rrisë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e saj në mekanizmat multilaterale. Diplomacia multilaterale e Kosovës do të vazhdojë të jetë në shërbim të avancimit të interesave shtetërore të Kosovës, zhvillimit demokratik dhe ekonomik të vendit, si dhe marrjes së përgjegjësi ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare do të mbetet një ndër prioritetet parësore të Qeverisë së Kosovës. Roli i Kosovës në marrëdhëniet shumëpalëshe po forcohet vazhdimisht nëpërmjet gjithëpërfshirjes në nismat e shumta rajonale dhe ndërkombëtare. Çdo progres i deritashëm në këtë fushë ngrit imazhin e vendit tonë në botë dhe i mundëson Kosovës përfshirjen në projekte shumëpalëshe, që kanë për qëllim stabilitetin, paqen, sigurinë dhe mirëqenien e përbashkët në botë.

Sot, Kosova ka arritur pjekurinë politike për të qenë pjesë e sistemit multilateral. Kosova ka ndërtuar institucione demokratike dhe të qëndrueshme, ekonomi funksionale, si dhe shoqëri shumë etnike. Përfshirja e Kosovës në sistemin multilateral ndërkombëtar i shërben disa qëllimeve, siç janë: vënia e kontakteve të reja me shtetet që ende nuk e kanë njohur Kosovën; legjitimimi ndërkombëtar i pavarësisë së Kosovës; reduktimi i shpenzimeve që dalin nga diplomacia bilaterale; përfitimi nga donacionet dhe përfitimet që dalin nga anëtarësimi; si dhe hapja e mundësive për të vendosur marrëdhënie diplomatike me vendet që kanë njohur Kosovën.

Anëtarësimi i plotë i Republikës së Kosovës në OKB është me interes strategjik dhe si i tillë mbetet objektivi suprem i agjendës tonë multilaterale. Edhe përkundër faktit që Kosova nuk është anëtare e plotë e OKB-së, anëtarësimi i saj në dy nga 16-të agjencitë e saj të specializuara (FMN dhe Bankën Botërore), ka lehtësuar në një mënyrë rolin e Kosovës karshi agjencive të tjera të OKB-së. Prandaj prioritet i Qeverisë së Kosovës mbeten agjencitë e specializuara të kësaj organizate, pasi anëtarësimi në FMN dhe BB shpesh nuk pranohet si

njëri nga parakushtet e përmbushura, duke qenë se këto agjenci simotra trajtohen ekskluzivisht si kategori mekanizmesh financiarë. Në përputhje me probabilitetin, përfitimin dhe mundësitë kohore dhe procedurale, Agjencitë e Specializuara të OKB-së, pjesë e të cilave mund të bëhet vendi ynë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, janë: Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), UNESCO, Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimit (ITU), Unioni Postar Universal (UPU), Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësorë (IFAD) dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).

Prioritet afatshkurtër i Qeverisë së Kosovës mbetet anëtarësimi në dy prej agjencive të specializuara më të rëndësishme të OKB-së: Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNESCO. OBSH luan një rol të jashtëzakonshëm në formulimin dhe implementimin e politikave shëndetësore botërore dhe anëtarësimi i saj do ta dërgonte në tre numrin e agjencive të specializuara të OKB-së, ku Kosova bëhet anëtare. Një tjetër Agjenci e Specializuar e OKB-së e rëndësishme së veçantë është UNESCO-ja, me seli në Paris, e cila promovon arsimin për të gjithë, zhvillimin kulturor, bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë, mbron trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si dhe promovon lirinë e shtypit dhe të komunikimit.

Një tjetër organizatë multilaterale, në të cilën Kosova synon të anëtarësohet dhe që është prioritet i agjendës multilaterale të Kosovës është Këshilli i Evropës (KE). Kosova është shtet evropian dhe ka të gjitha atributet demokratike të jetë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës. Anëtarësimi i Kosovës në KE do të ishte dëshmi e investimit afatgjatë për konsolidimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në gjithë hapësirën e Evropës Juglindore. Kosova, nëpërmjet anëtarësimit në Komisionin e Venedikut dhe në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës, ka krijuar parakushtet për aplikim edhe në Këshillin e Evropës. Qytetarët e Kosovës do të përfitonin më së shumti nga anëtarësimi i Kosovës në KE dhe institucionet e saj, siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Anëtarësimi në (KE) dëshmon një standard të arritur në zhvillimin e demokracisë, të zhvillimit ekonomik dhe të sundimit të ligjit. Ky dimension reflektohet edhe në kontekstin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim (OSCE) është një tjetër organizatë më të cilën Kosova kërkon të vazhdojë marrëdhëniet e saj dhe tutje t'i avancojë ato. Si një forum i gjerë politik dhe i sigurisë, që shkon përtej kufijve të Evropës, OSBE-ja është një organizatë në të cilën Kosova mund, në mënyrë shumë aktive dhe efikase, të promovojë dhe mbrojë politikën e saj të jashtme dhe interesat e përgjithshme. Duke vazhduar bashkëpunimin më të gjitha tre dimensionet e kësaj organizate (politiko-siguri, ekonomike dhe mjedisore), Kosova do të mund të përdorte programet e ndihmës dhe mbështetjen e OSBE-së në reformën policore, reformën e gjyqësorit dhe forcimin e institucioneve demokratike.

Përveç përpjekjeve për anëtarësim në organizata me ndikim të gjerë politik dhe ekonomik, Kosova do të shtojë përpjekjet për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare sportive, kulturore dhe arsimore. Kjo do të ishte në interes të fuqizimit të këtyre sektorëve socialë në

Kosovë, që do të ofronin mundësinë për të promovuar identitetin dhe talentin vendor në instancat ndërkombëtare.

3.6. Partneritetet strategjike

Koncepti bazë mbi të cilin mbështeten qëllimet strategjike të Republikës së Kosovës, në marrëdhëniet e saj me shtete të tjera, është dhe duhet të jetë gjithmonë interesi shtetëror, si dhe ai reciprok. Interesi shtetëror i Kosovës është i përcaktuar dhe përkufizohet nga vlerat demokratike dhe kushtetuese, të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mbi këto premisa, Qeveria e Kosovës do të angazhohet që politika e jashtme e Kosovës të mbetet një politikë parimore, që udhëhiqet nga po ato vlera dhe parime demokratike dhe nga normat ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës do të angazhohet të avancojë më tutje marrëdhëniet e veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në nivel të partneritetit të thelluar strategjik. Marrëdhëniet mes dy vendeve duhet të arrijnë në nivel të bashkëpunimit strategjik, me përfitime të ndërsjella në ekonomi, siguri dhe fushat me interes të përbashkët për të shtyrë përpara integrimin në strukturat Euro-Atlantike.

Për Qeverinë e Kosovës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbetet partneri strategjik më i rëndësishëm. Ky partneritet strategjik synon që të thellojë bashkëpunimin e deritanishëm, dhe përfitimin e ndërsjellë të të dyja vendeve, në një spektër të gjerë të interesave të përbashkët, sikurse forcimin e demokracisë dhe ekonomisë së lirë, ruajtjen e integritetit territorial, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe respektit për të drejtat e njeriut, promovimin e të drejtave të komuniteteve, mbështetjes për projektet strategjike në fushat e sigurisë, energjisë dhe koordinimit në mekanizmat multilaterale. Republika e Kosovës angazhohet për një rol të shtuar të strukturave Euro-Atlantike në Evropën Juglindore.

Me transformimin e FSK-së në FAK, brenda këtij partneriteti, do të angazhohemi për të dhënë kontributin në misione ndërkombëtare paqeruajtëse apo ndërtimin e paqes, shoqëruar me kontribut civil e diplomatik. Ky partneritet do të mbulojë të gjitha fushat e interesit të ndërsjellë, të cilat do të identifikohen në kuadër të konsultave të drejtpërdrejta që do të iniciohen.

Kosova do të vazhdojë të forcojë bashkëpunimin strategjik me Gjermaninë, Francën, Britaninë e Madhe, Italinë dhe vendet e tjera evropiane. Duke vlerësuar rolin historik dhe aktual që kanë këto vende për Republikën e Kosovës, është i domosdoshëm thëllimi i bashkëpunimit dhe kultivimi i marrëdhënieve të veçanta me to. Marrëdhëniet bilaterale me këto vende janë një faktor kyç për përmbushjen e objektivave të politikës së jashtme të Kosovës, për zhvillimin e saj demokratik, ekonomik dhe do të shtynjë përpara përpjekjet integruese në strukturat Euro-Atlantike. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me secilin nga këto vende, Kosova do angazhohet për promovimin e vazhduar të vlerave Euro-Atlantike në rajon.

Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës do të angazhohet në forcimin e partneritetit me Republikën Federale të Gjermanisë, Britaninë e Madhe, Francën, Italinë dhe vendet e tjera evropiane. Duke vlerësuar përkrahjen e këtyre vendeve dhënë Kosovës në konsolidimin e

brendshëm të shtetësisë, ato janë përkrahësit kryesorë në rrugën drejt integritit në BE. Qasja proaktive ndaj Kosovës dhe rajonit i bënë këto vende partnerë kryesorë brenda Bashkimit Evropian.

Angazhimet kryesore në kuadër të këtij bashkëpunimi mbeten integrimi në Bashkimin Evropian, ku veçmas Gjermania dhe vendet e tjera janë mbështetësit kryesorë në këtë proces. Mbështetja e Gjermanisë në këtë proces do të kishte një ndikim shumë të madh edhe në aktorët e tjerë evropianë; politika ndaj rajonit (Procesi i Berlinit), rritja e investimeve gjermane në Kosovë dhe bashkëpunimi i përgjithshëm bilateral. Qeveria e Kosovës do të angazhohet në zgjerimin e bashkëpunimit më të thellë e të gjithanshëm, si dhe inkurajimin e rritjes së shkëmbimeve dypalëshe me të gjitha vendet evropiane.

3.7. Politika ndaj rajonit

Qeveria e Kosovës do të vazhdoj të promovojë fqinjësi të mirë dhe konstruktive me të gjitha shtetet e rajonit. Në përmbushje të kësaj politike rajonale, Kosova do të mbetet e angazhuar në mënyrë konstruktive dhe pragmatike për të rritur bashkëpunimin rajonal efektiv nëpërmjet fuqizimit dhe vazhimit të pjesëmarrjes së saj në organizata dhe forume rajonale. Në objektivat e Qeverisë së Kosovës ndaj rajonit, parashihet bashkëpunimi me të gjitha vendet, të cilët janë ose synojnë të jenë pjesë e strukturave Euro-atlantike, si BE-ja dhe NATO-ja, integrimi në këto struktura dhe orientimi i qartë drejt tyre, është hap dhe parakusht për një rajon stabil, paqësor dhe të qëndrueshëm, prandaj është thellësisht e përkushtuar që të nxitë dhe të promovojë këtë frymë në gjithë bashkëpunimin rajonal.

Politika rajonale e Qeverisë së Kosovës do të vazhdojë të mbështesë dialogun e të gjitha niveleve, sigurinë rajonale, bashkëpunimin ekonomik, thellimin e shkëmbimeve tregtare, mbrojtjes dhe promovimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Qasja e Qeverisë së Kosovës në raport me vendet e rajonit do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirëse, promovon dhe nxit hapësirat e interesit të përbashkët, përkrah perspektivën euro-atlantike të rajonit.

Një nga objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës është forcimi i bashkëpunimit rajonal nëpërmjet angazhimit bilateral me shtetet e rajonit dhe multilateral në forumet dhe mekanizmat rajonalë. Duke marrë shkas nga pozita gjeopolitike e Republikës së Kosovës në rajon, Kosova do të vazhdojë të promovojë fqinjësi të mirë dhe konstruktive me të gjitha shtetet e rajonit. Në përmbushje të kësaj politike rajonale, Kosova do të mbetet e angazhuar në mënyrë konstruktive dhe pragmatike për të rritur bashkëpunimin rajonal efektiv nëpërmjet fuqizimit dhe vazhimit të pjesëmarrjes së saj në SEECP, Këshillin Rajonal për Bashkëpunim (RCC), RACVIAC, MARRI, A5 dhe organizatat dhe iniciativat të tjera të rëndësishme rajonale, në të cilat Kosova është anëtare dhe pjesëmarrëse. Kosova do të promovojë lehtësimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve, mallrave dhe shërbimeve në rajon duke u bazuar në standardet evropiane dhe mekanizmat ekzistues.

Qëllimi primar i Qeverisë së Kosovës për bashkëpunimin rajonal është forcimi i marrëdhënieve me fqinjët e parë, ngritja e nivelit aktual të shkëmbimeve të gjithanshme, avancimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Kështu Kosova synon

të thellojë bashkëpunimin, me qëllim që të gjitha këto vende të krijojnë mekanizma të përbashkëta që mundësojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve në fushat me interes reciprok, si:

- Sundimi i Ligjit, luftimi i krimit të organizuar, bashkëpunimi në fushat e sigurisë dhe të drejtësisë;
- Ekonomia: Rritja e vëllimit të bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe sektorit të energjisë, lidhja më e mirë infrastrukturore;
- Integrimet Euro-Atlantike: Avancimin e bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave në integrimet evropiane dhe NATO;
- Lëvizja e lirë: Krijimin e mundësive për lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit;
- Bashkëpunimi në fushën akademike, kulturore dhe sportive, bashkëpunimit në fushat e shëndetësisë dhe punësimit.

Për Qeverinë e Kosovës është i domosdoshëm angazhimi i mëtutjeshëm i BE-së në mbështetjen dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal e sidomos në forcim të qeverisjes ekonomike. Kosova është e përkushtuar që të bashkëpunojë me shtetet e rajonit dhe të BE-në, në funksion të standardizimit të politikave fiskale dhe ekonomike. Në këtë drejtim duhet të realizohen objektivat e dala nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020. Nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me të gjitha shtetet e rajonit, sidomos në sferën ekonomike dhe infrastrukturore, synohet që Kosova të shndërrohet një treg atraktiv për investime të huaja.

Zbatimi i partneritetit strategjik me Shqipërinë, duke nxitur zhvillimin e ngushtë politik, ekonomik dhe kulturor do të mbetet një prioritet i qeverisë për të nxitur integrimin tregtar në mes të dyja vendeve dhe përshpejtimin e integritit në BE dhe NATO të Kosovës. Marrëdhëniet mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë duhet çuar e zhvilluar më tej në të gjitha drejtimet, duke synuar heqjen e të gjitha barrierave që pengojnë shkëmbimet dhe integrimin ekonomik, arsimor e kulturor mes dy shteteve.

Qeveria e Kosovës angazhohet që partneriteti strategjik mes Kosovës dhe Shqipërisë të forcohet edhe më shumë e të bëhet efektivisht më i rëndësishëm për të dyja palët. Në kuadër të intensifikimit dhe sofistikimit të mëtejshëm të këtij partneriteti natyral mes dy vendeve, do të ketë angazhim të shtuar në drejtim të krijimit të rrethanave për zhvillimin e hapësirave të përbashkëta ekonomike, energjetike, kulturore e arsimore.

Mbetet prioritet realizimi i projekteve të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit në Procesin e Konferencës së Berlinit, ku përfshihen edhe vende tjera nga rajoni, si: Mali Zi, Serbia, Maqedonia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina.

Kosova do të vazhdojë të mbetet fuqishëm e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vazhdimin e dialogut, që do të synohet të finalizohet me njohjen e ndërsjellë që do të mundësonte ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes të dyja vendeve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe të mira fqinjësore në frymën evropiane. Deri në arritjen e kësaj aspirate, Kosova mbetet e përkushtuar, nëpërmjet

dialogut, si vlerë evropiane dhe si rruga e vetme, për zbatimin e Marrëveshjes së 19 prillit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dy shtete të pavarura dhe sovrane, për të zgjidhur mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes dy vendeve tona, nëpërmjet dialogut të nivelit të lartë dhe teknik, me lehtësimin dhe garantimin e Bashkimit Evropian.

Kjo ndërmarrje e fuqishme e dialogut ndërshtetëror është bazuar në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe standardet më të mira evropiane për fqinjësi të mirë, me synim të përmirësimit të jetës së qytetarëve, vendosjes së relacioneve të mira fqinjësore mes dy shteteve, sigurimin e agjendës evropiane për dy vendet, si dhe forcimi i paqes e stabilitetit rajonal. Kosova fton dhe inkurajon edhe më tutje angazhimin e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lehtësimin e këtij procesi historik mes dy vendeve.

Mungesa e marrëdhënieve normale ndërshtetërore mes Kosovës dhe Serbisë paraqet pengesë serioze për stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin në të gjithë Evropën Juglindore. Si pasojë, asnjëri vend nuk mund të anëtarësohet në Bashkimin Evropian pa zgjidhjen e çështjeve të hapura bilaterale dhe pa normalizimin e plotë të marrëdhënieve fqinjësore, prandaj ky proces normalizimi mes dy vendeve i shërben interesave të qytetarëve të të dyja vendeve dhe interesave të rajonit, po ashtu.

Procesi i normalizimit ndërshtetëror do të vazhdojë të përdoret edhe në funksion të fuqizimit të sovranitetit në gjithë vendin, si dhe në avancimin e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës. Marrëveshja e 19 prillit 2013 paraqet vetëm fillimin e një kapitulli të normalizimit dhe duhet të pasurohet me arritjen e marrëveshjeve të reja. Kurse rezultatet e deritanishme të arritura nga zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të Brukselit ka vendosur bazamentet stabile për normalizimin e marrëdhënieve ndër-shtetërore, mirëpo mbeten edhe shumë sfida në drejtim të zbatimit të plotë dhe efektiv të marrëveshjes.

Qeveria e Kosovës gjatë këtij mandati qeverisës angazhohet që procesi i Normalizimit Ndërshtetëror të ketë parametra të qartë, pa ambiguitet, të matshëm dhe me afate kohore të përcaktuara, me qëllim të evitimit të negociimit të pafundësishëm brenda trekëndëshit Prishtinë-Bruksel-Beograd dhe anasjelltas. Po ashtu, procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore synon të ketë zbatim të plotë të të gjitha marrëveshjeve të arritura nga Serbia, pa tendencën e rinegociimit apo ndryshimit të tyre; zhbërjen e plotë të të gjitha strukturave paralele të Serbisë në Veri të Kosovës; integrimin e plotë të serbëve të Kosovës në institucione, nëpërmjet angazhimit konstruktiv; që Serbia ta respektojë sovranitetin, integritetin territorial dhe të mos bllokojë apo pengojë direkt ose indirekt anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, siç është Këshilli i Evropës, OSBE-ja, si dhe OKB-ja, si dhe dialogu ndërshtetërorë mes Kosovës dhe Serbisë të përmbillet me njohjen reciproke.

Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës do të insistojë të mbajë lart në agjendën e procesit të normalizimit çështje të reja me rëndësi, përfshirë:

- Demarkacionin apo vendosjen e kufirit ndërkombëtar mes dy vendeve, për faktin se më shumë se 50% e vijës kufitare apo nga 743.556 km prej tyre, 380.068 km ndahet me Serbinë;
- Ndërprejja e ndërhyrjeve të Serbisë në Kosovë në fushat e tjera që nuk janë trajtuar në Marrëveshjet e Brukselit;
- Vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fusha me interes sipas standardeve evropiane, përfshirë aviacionin ajror/ transportin ajror;
- Njohjen reciproke e certifikatave të vlerësimit të konformitetit;
- Reparacionet e luftës - përfshirë kompensimin e dëmeve të luftës; dëmshpërblimi për dezinvestimet - në periudhën e okupimit; dëmshpërblimi për humbjet e pagave të personave të përjashtuar nga puna për shkak të përkatësisë kombëtare; dëmshpërblimi për shkatërrimin e sistemit pensional; dëmshpërblimi për shkatërrimin e sistemit bankarë dhe plaçkitjen e kursimeve devizore të kosovarëve, përfshirë rikthimin e kursimeve bankare; dëmshpërblimi për dëmet e luftës në pronën private dhe publike dhe objektet e trashëgimisë kulturore; dëmshpërblimi i familjarëve të atyre që janë vrarë dhe zhdukur nga Serbia; dëmshpërblimi i personave apo familjarëve të atyre që janë mbajtur politikisht nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë; dëmshpërblimi i grave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë;
- Çështja e personave të zhdukur – përfshirë kthimin e të zhvendosurve, kthimin e eksponateve dhe dokumenteve të trashëgimisë kulturore të marra nga Serbia; kthimi i filmave të Kosovafilmit; kthimi i fondit pensional dhe invalidor të qytetarëve të Kosovës; kthimi i depozitave bankare;
- Satisfaksioni – pranimi i përgjegjësisë për luftën dhe dëmet; drejtësia dhe dënimi i aktorëve të luftës për gjenocidin/krimet ndaj popullatës së Kosovës, përfshirë dhunimin e grave, si mjet i luftës; kërkim falja publike për krimet e bëra në Kosovë;
- Suksesioni - Ndarja e pasurisë së ish-Jugosllavisë dhe borxhi ndërkombëtar i Kosovës; asetet financiare të ish-Jugosllavisë; pronat e misioneve diplomatike e konsullore të ish-Jugosllavisë; pronat ushtarake të ish-Jugosllavisë; pronat e luajtshme të ish- Jugosllavisë; arkivat e ish-Jugosllavisë; kthimi i dokumenteve të ish-Jugosllavisë që e implikojnë Kosovën; kthimi i listës me të dhënat e plota për të gjitha objektet dhe pajisjet radioaktive.

Ashtu siç Kosova do të mbetet e angazhuar për të respektuar të drejtat e të gjithë qytetarëve të saj dhe të komuniteteve që jetojnë në të, ajo do të angazhohet për të promovuar dhe mbrojtur interesat dhe të drejtat e komunitetit shqiptar në rajon me anë të zhvillimit të marrëdhënieve fqinjësisë së mirë me shtetet përreth si dhe përmes mekanizmave ekzistues të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe të OSBE-së.

3.8. Diplomacia ekonomike

Diplomacia ekonomike dhe rritja e investimeve të huaja do të jetë boshti kryesor i Qeverisë së Kosovës, si dhe një ndër prioritetet kryesore të Kosovës sa i përket zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ky prioritet bazohet në nevojat imediate të ekonomisë së vendit, si dhe është në përputhje të plotë me prioritetet e BE-së, të përcaktuara në Strategjinë e Zgjerimit 2014-2015. Andaj, zhvillimi ekonomik do të jetë një ndër

prioritetet kryesore edhe për Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila do të vazhdojë të kontribuojë në këtë fushë nëpërmjet diplomacisë ekonomike. Ekonomia kosovare e ka tejkaluar fazën e parë të rindërtimit dhe me hapa të fuqishëm ka arritur reformimin dhe transformimin në ekonomi të lirë të tregut. Reformat e ndërmarra në këto vite, të karakterizuara nga një proces i gjerë i privatizimit dhe përmirësimeve të vazhdueshme në raport me ambientin e të bërit biznes, kanë ndikuar në ndryshimin e strukturës ekonomike të Kosovës dhe janë vlerësuar lartë edhe nga raporte prestigjioze ndërkombëtare.

Fokusi i Qeverisë së Kosovës do të jetë në rrafshin ekonomik, në mënyrë që të krijohet një ambient i përshtatshëm për zhvillim të hovshëm ekonomik. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të lehtësirave të nevojshme për investimet e huaja dhe vazhdimin të realizimit të reformave të nevojshme për të hequr barrën burokratike. Në këtë drejtim, Shërbimi diplomatik i MPJ-së do të vazhdojë të jetë në funksion të arritjes së realizimit të objektivave ekonomike të Republikës së Kosovës.

Kosova do të synojë të shndërrohet në një ndër top-destinacionet për tërheqjen e investimeve të huaja në rajon. Detyra më e madhe i takon MPJ-së dhe Shërbimit të jashtëm që ta bëjnë të qartë se Kosova është e hapur për investime dhe nuk ka pengesa për t'i bërë ato. Gjithashtu, është tejet i rëndësishëm promovimi i mëtutjeshëm i të gjitha përparësive ligjore, ekonomike, strukturore dhe humane që ka Kosova nëpërmjet rrjetit tonë diplomatik, nëpërmjet organizimit të forumeve ekonomike, të biznesit, pjesëmarrjes në panairë dhe organizime të tjera multilaterale me karakter ekonomik, financiar etj. Pra, shtimi i bashkëpunimit bilateral dhe multilateral për tërheqjen e investimeve të huaja, nxitja e eksportit të produkteve të Kosovës dhe promovimi i Kosovës si një destinacion tërheqës turistik do të jenë prioritet të diplomacisë ekonomike.

Roli i diplomacisë në zhvillimin ekonomik të Kosovës do të jetë thelbësor. Ministria e Punëve të Jashtme në fushën e ekonomisë do të ketë rol në katër aspekte:

- a) Aspekti i parë do të jetë diplomacia ekonomike. Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të shfrytëzojë rrjetin diplomatik për të tërhequr investime dhe për të promovuar bizneset kosovare nëpër botë, kjo me synimin për rritjen e aktivitetit ekonomik ndërkombëtar për Kosovën. Po ashtu, fokus i rëndësishëm në këtë drejtim do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me diasporën, me qëllim të tërheqjes së investimeve dhe promovimit të bizneseve kosovare në vendet ku ata jetojnë. Është më se e qartë që në kohën në të cilën jetojmë tani një shtet nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik pa bashkëpunim ndërkombëtar në këtë fushë. Në këtë aspekt, Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet e linjës do të promovojë fushat kryesore për investime në Kosovë, fusha ku Kosova ka avantazh krahasues me vendet tjera të rajonit dhe botës. Gjithashtu, do të punohet ngushtë edhe me institucionet përkatëse ndërkombëtare, siç janë: Fondet Zhvillimore, Odat Ekonomike dhe organizata të tjera me karakter ekonomik;
- b) Aspekti i dytë do të jetë në fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale. Në këtë fushë Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të ketë prioritet nënshkrimin e marrëveshjeve me karakter ekonomik/tregtar me të gjitha shtetet që janë partnerë të

Kosovës. Përpos aspektit bilateral, do të vazhdohet tutje me angazhimin për anëtarësimin e Kosovës në mekanizma të ndryshëm multilateral me karakter ekonomik dhe financiar që do të ndihmojnë zhvillimin e Kosovës. Rëndësi e veçantë do të vazhdojë t'i kushtohet bashkëpunimit rajonal, në përputhje të plotë me obligimet që dalin nga Procesi i Berlinit dhe Strategjia për Evropën Juglindore 2020. Perspektiva e qartë e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian përbën në vete një përparësi për Kosovën, që shihet si një aspekt shumë atraktiv nga shumë investitorë nga vendet jashtë Evropës. Të gjitha këto do të nxisin rritjen e shkëmbimeve tregtare, rritjen e investimeve të huaja në Kosovë e rrjedhimisht edhe rritjen e eksporteve. Gjithashtu, nëpërmjet këtyre marrëveshjeve dhe këtij bashkëpunimi, Kosova do të sigurojë qasje në kredi të buta dhe mjete të tjera financiare ndërkombëtare, në mënyrë që të zhvillohen fusha të caktuara ekonomike dhe të përkrahen bizneset vendore. I gjithë ky aktivitet përmirëson dukshëm imazhin e Kosovës dhe rrit kredibilitetin në sy të investitorëve potencial;

- c) Aspekti i tretë ka të bëjë me rolin e ri të MPJ-së si lehtësues dhe ndërmjetësues mes investitorëve të huaj dhe organeve të tjera qeveritare e administrative. MPJ-ja do të intensifikojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e linjës në interes të zhvillimit sa më të madh të bashkëpunimit ekonomik me shtetet partnere. Në këtë aspekt, MPJ-ja do të jetë një ndërmjetësuese në mes të investitorëve potencialë të huaj dhe institucioneve përkatëse vendore, në funksion të zhvillimit të mëtutjeshëm ekonomik të vendit. Komunikimi i mirëfilltë dhe koordinimi i ngushtë në mes të institucioneve vendore do të lehtësojë tërheqjen e investitorëve të huaj, si dhe promovimin e produkteve të Kosovës jashtë vendit;
- d) Aspekti i katërt është realizimi i objektivave të politikës së jashtme të Qeverisë së Kosovës së në raport me vendet tjera të botës, nëpërmjet diplomacisë ekonomike. Në këtë drejtim Ministria e Punëve të Jashtme do të vazhdojë të ketë një rol qendror për të identifikuar partnerët strategjik të Kosovës, gjë që ndihmon edhe orientimin e bashkëpunimit ekonomik të Kosovës. Një rëndësi të veçantë në këtë fushë ka diversifikimi i importeve, në mënyrë që Kosova të mos jetë e varur për produkte të caktuara vetëm nga importet që vijnë nga një vend.

Diplomacia e Kosovës do të fokusohet për të mbështetur përpjekjet për të lidhur Kosovën me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP). Ky projekt është në interes të Kosovës për të fituar qasje në tubacionit TAP, në funksion të sigurimit të zhvillimit, diversifikimit të burimeve të energjisë dhe sistemit të pavarur energjetik, që është një nga projektet më të rëndësishme energjetike që mbështet nga Bashkimi Evropian dhe komuniteti Euro-Atlantik. Duke arritur këtë synim, gazsjellësi do t'ia mundësojë Kosovës të ketë qasje në Korridorin Jugor të Gazit, një projekt i BE-së në thelb të strategjisë së saj energjetike për pavarësimin e burimeve të gazit në Evropë. TAP-i ofron një garanci për Kosovën dhe rajonin për të ruajtur pavarësinë energjetike dhe do të vendosë rregullat e BE-së në tregun e energjisë së rajonit.

Rrjeti diplomatik në shërbim të zhvillimit do jetë fokus i qeverisë së Kosovës, për ta maksimizuar përfitimin shumësektorësh nga Shërbimi i jashtëm i Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me rrjetin e saj ndërkombëtar të ambasadave dhe

konsullatave, do të vazhdojë të kontribuojë në përpjekje më të gjerë, për të sjellë investimet e huaja në Kosovë, të rrisë eksportin e mallrave dhe shërbimeve të Kosovës, për të nxitur turizmin, shërbimet financiare dhe tregtarë në përgjithësi, duke u koordinuar ngushtë me agjencitë qeveritare përkatëse, për të siguruar një fokus përbashkët mbi qëllimet imediate dhe afatgjata të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme gjithashtu do të shfrytëzojë në mënyrë më efikase konsullatat e saj në Evropë për promovimin e tregtisë dhe investimeve dhe për t'i vënë ato në shërbim të ndërmarrësve të Kosovës në procesin e kërkimit të tregjeve të reja për prodhimet e Kosovës.

3.9. Diaspora

Promovimi i diasporës së Kosovës dhe realizimi i objektivave që dalin nga Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, e të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor të pjesëtarëve të diasporës, krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e diasporës në jetën politike dhe sociale dhe përfaqësimin e tyre në institucionet vendimmarrëse të vendit, integrimin e tyre në vendet ku jetojnë, si dhe përfshirjen e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë finalizimin dhe konsolidimin e infrastrukturës ligjore dhe administrative për Diasporën, në mënyrë që të bëjë të mundur zbatimin e plotë të Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën në të gjitha dimensionet e jetës në Kosovë dhe në vendet ku jetojnë. Deri më tani janë miratuar: Ligji i Diasporës dhe i Mërgatës, Ligji i Shtetësisë, Ligji për Shërbimet Diplomatieke dhe Konsullore dhe të tjera dokumente që mund të plotësohen me përcaktimin e objektivave, të cilat shpjegohen më poshtë në këtë Program qeverisës.

Duke qenë se ende kemi një organizim të fragmentuar të diasporës, Ministria e Diasporës do të punojë në krijimin e kushteve për një organizim sa më të mirë dhe unik të diasporës në mënyrë që të shfrytëzojë maksimalisht mundësitë që ofrojnë shtetet ku bashkatdhetarët tanë jetojnë, por edhe që ky organizim të jetë i dobishëm për vendin tonë. Do të vazhdojë angazhimi për avancimin e të drejtave politike e sociale të diasporës në Kosovë, por edhe në vendet ku jetojnë përmes përfshirjes në jetën politike të vendit. Do të punohet në ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës, duke u organizuar nëpër mekanizma të ndihmuar nga Ministria e Diasporës si rrjetet e shoqatave kulturore, shoqatave të mësuesve, shoqatave të krijuesve të fushave të artit dhe shkencës, federatave dhe konfederatave të sportit, rrjetet e të rinjve e studentëve e të juristëve, etj. Në këtë drejtim do të punohet në shmangien e asimilimit nëpërmjet programit për përfshirje në mësimin plotësues dhe bursave për studentët shqiptarë që të studiojnë në Kosovë dhe lehtësi për investime në Kosovë që remitencat gradualisht të shndërrohen në investime.

Do të punohet që të realizohet në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë “Programi i Përbashkët për Zhvillimin e Mësimin Plotësues në Diasporë dhe Mërgatë”, proces i cili ka filluar që në vitin 2012 dhe i cili duhet të fillojë realizimin pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes të dy shteteve. Si rezultat i këtij projekti të një rëndësie të posaçme, do të krijohen kushtet që gjatë katër viteve të ardhshme të rritet ndjeshëm numri i nxënësve që janë të

përfshirë në programin për mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Si pjesë e kësaj marrëveshjeje do të harmonizohet rregullativa ligjore, do të hartohet kurrikula e përbashkët për mësimin e gjuhës shqipe, do të bëhet licencimi i përbashkët i mësimdhënësve, do të krijohen standardet e mësimdhënies dhe të rekrutimit të mësuesve dhe arsimtarëve, do të bëhet financimi i procesit, do të krijohej një portal didaktik, do të bëhet furnizimi me tekste shkollore, lektura dhe libra të ndryshëm, si dhe do të organizohej fushata vetëdijësuese për arsimin plotësues.

Për realizimin e projektit të mësimin plotësues shqip në diasporë Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë duhet të lidhin marrëveshje individuale me shtetet të cilat nuk e kanë të institucionalizuar mësimin në gjuhën shqipe. Modele pozitive të institucionalizimit të mësimin shqip janë Finlanda dhe Suedia.

Në varësi të rrethanave të vazhdohet me hapjen qendrave kulturore për diasporë dhe mërgatë. Hapja e këtyre qendrave në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë do të zvogëlonte ngarkesat buxhetore dhe do të mundësonte trajtim më adekuat të diasporës shqiptare në fushën e kulturës.

Në një periudhë 3-4vjeçare duhet të realizohet projekti i Regjistrimit të Diasporës si dhe të hapet Seksioni i Muzeut të Diasporës dhe Mërgatës në Kosovë, në kuadër të Muzeut Kombëtar dhe Seksionit të Arkivit të Diasporës në kuadër të Arkivit të Kosovës.

Në kuadër të angazhimeve për të afruar diasporën me vendin tonë do të hartohen politika për të stimuluar studentët shqiptarë nga diaspora të studiojnë në Kosovë, e posaçërisht përmes një skeme të veçantë të kredive në bashkëpunim edhe me Unionin e Bizneseve nga Diaspora, do të stimulohen përmes kredive studentët shqiptarë në diasporë që të studiojnë në drejtimet deficitare për Kosovën. Njëkohësisht do të hartohen politika që profesorët dhe shkencëtarët e tjerë shqiptarë nga diaspora të përfshihen edhe në procesin mësimor në universitetet e Kosovës. Do të punohet që edhe mjekët shqiptarë nga diaspora të jenë pjesë e ngritjes së sistemit shëndetësor në Kosovë dhe kështu të gjitha këto kategori të mërgimtarëve me shkollim universitar të mbajnë lidhjet me vendin e origjinës dhe të rinisin kontaktet dhe të ruajnë gjuhën dhe kulturën shqipe.

Megjithëse sfidë, Qeveria e Kosovës do të punojë për të rritur përfaqësimin politik të Diasporës në vendimmarrjen e vendit, përmes krijimit të mekanizmave të ndryshëm përfaqësues. Do të krijohet një komision i posaçëm për diasporën, përgjegjësia e diasporës do t'i shtohet Komisionit për Punë të Jashtme. Kështu ky komision në mënyrë që së bashku me Ministrinë e Diasporës dhe atë të Jashtme të bashkërendojë aktivitetet për përfshirje sa më të madhe të Diasporës në punën e Kuvendit të Kosovës.

Qeveria do të angazhohet që RTK të realizojë obligimet ligjore që ka për të transmetuar 6-9% të programit të vet për diasporën, përfshirë emërimin e një anëtari të bordit të RTK-së nga diaspora.

Njëkohësisht do të punohet ngushtë me mediat elektronike dhe të shtypura në gjuhën shqipe që drejtohen nga pjesëtarë të Diasporës dhe që kanë për qëllim avancimin dhe promovimin e

të drejtave të qytetarëve tanë në vendet ku jetojnë. Ministria e Diasporës në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve nga Kosova dhe diaspora do të themelojë çmimin vjetor të gazetarisë për shkrimet, kronikat, emisionet dhe zhanre të tjera që promovojnë vlerat dhe iniciativat nga diaspora.

3.10. Diplomacia publike

Kosova do të vazhdojë të promovojë një imazhi real dhe modern, kulturën dhe identitetin e saj nëpërmjet diplomacisë publike, kulturore dhe digjitale, dhe do të synojë të rrisë ndikimin kulturor dhe njerëzor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet për të vazhduar me iniciativat e nisura për diplomacinë publike, të ndara në lobimin të vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, promovimin e turizmit dhe brendeve kosovare jashtë dhe rritjen e investimeve të huaja në Kosovë. Duke konsideruar se janë përmbushur objektivat e Strategjisë për Diplomaci Digjitale, Qeveria e Kosovës do të hartojë një dokument strategjik që kanalizon përpjekjen për ta brenduar shtetin e ri nga një vend post-pavarësisë në një shtet me imazh të ri, të gatshëm për turizëm dhe investime të huaja.

Në këtë drejtim, do të kalon që Agjencia për Promovimin e Investimeve, që vepron në kuadër të MTI-së, të kalojë pranë Zyrës së Kryeministrit dhe të jetë udhëheqëse dhe koordinatore e të gjitha institucioneve kosovare për të bartur barrën e promovimit të turizmit dhe investimeve të huaja në Kosovë. Shërbimi i Jashtëm diplomatik i Kosovës duhet ta luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, në kuadër të qëllimeve për ta shtyrë përpara “diplomacinë ekonomike”.

Në hartimin e Strategjisë dhe zbatimin e saj të përfshihen të gjitha palët në shoqëri, përfshirë institucionet shtetërore, të pavarura, bizneset, shoqëria civile dhe mekanizma të tjerë, sikurse ekspertë të huaj apo kompani. T’i ndahet një buxhet i arsyeshëm që mund të përballojë kërkesat për ta bartur barrën e promovimit të imazhit të ri të shtetit, të lansojë fushatat dhe të tërheqë investimet e huaja direkte.

Për t’iu shmangur procesit të politizimit, sikurse ka ngjarë në shumë shtete të tjera në rajon, Qeveria e Kosovës në krye të Agjencisë apo Ekipit Ndërministror, që duhet ta udhëheqë fushatën e promovimit të turizmit të Kosovës dhe të investimeve të huaja, të emërojë përfaqësues shtetërorë, të pavarur, nga jashtë politikës dhe ekspertë. Pos kompanive të huaja, që mund ta ndihmojnë Qeverinë e Kosovës për të hartuar Strategjinë dhe udhëhequr këtë proces, i cili mund të zgjasë me vite, duhet të angazhohen edhe ish-politikanë, diplomatë apo ekspertë që e këshillojnë Qeverinë për temat e sipërpërmendura.

Personalitetet, artistët dhe sportistët shqiptarë me famë botërore duhet të përfshihen në këtë iniciativë, për ta bartur barrën e fushatës për ta promovuar shtetin e ri, si “ambasadorët” më të mirë për ta bërë të njohur Kosovën për të mirë në sytë e publikut botëror.

Fushata e Diplomacisë digjitale duhet të vazhdojë duke i përfshirë gjithnjë e më shumë qytetarët e Kosovës nëpërmjet iniciativës “Qytetarë diplomatë”, të cilët në çfarëdo udhëtimi në kapacitete private apo zyrtare do të duhej të pajisen me broshura dhe materiale të tjera propagandimi për ta prezantuar Kosovën.

Pozicionimi i Kosovës në një plan më afatgjatë në sytë e investitorëve duhet të identifikohet në sektorin e IT-së, për shkak të numrit të madh të të rinjve që kemi dhe penetrimit të lartë të internetit, duke u listuar Kosova si shteti i parë në rajon.

Sipas studimeve të shumta, Kosova do të mund të promovohet si shtet i ekoturizmit dhe bioprodukteve, për t’u fokusuar më shumë në prodhimin e produkteve bio, për shkak edhe të klimës që disponon apo të banjave shëruese (termale), të cilat janë në Kosovë janë në numër të konsiderueshëm.

Një mundësi tjetër e jashtëzakonshme për ta bërë Kosovën pjesë të agjendës botërore të sportit e të kulturës është anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të sportit, kulturës dhe të arsimit, veçmas FIFA dhe UEFA. Kështu artistët, sportistët dhe talentet e tjerë do të promovonin vlerat e Kosovës në botë.

Përgatitja e një regjistri (databaze) për profilin profesional të potencialeve njerëzore në Kosovë dhe Diasporë, kryesisht i fokusuar në identifikimin e personaliteteve që kanë arritur shumë në profilet e ndryshme, si: biznes, sport, kulturë, shkencë, teknologji, shëndetësi e turizëm, duhet të ndodhë në një afat sa më të shkurtër.

3.11. Diplomacia parlamentare

Partnerët qeveritarë në kuadër të dinamizmit të mëtutjeshëm të të gjitha fushave të diplomacisë dhe politikës së jashtme, synojnë rritjen e përdorimit të diplomacisë parlamentare për të thelluar bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me vendet të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës. Angazhimi i partnerëve do të jetë edhe në funksion të mirëmbajtjes dhe rritjes së bashkëpunimit aktual mes Republikës së Kosovës dhe vendeve tjera, në nivel parlamentar. Duke qenë të vetëdijshëm për rolin që ka Kuvendi i Kosovës dhe sidomos Komisioni i saj për Politikë të Jashtme, partnerët do të rrisin koordinimin mes Legjislativit dhe Ekzekutivit në funksion të diplomacisë parlamentare. Në këtë drejtim, do të punohet një strategji e bashkëpunimit dhe rritjes së efektivitetit të diplomacisë parlamentare si dhe do të intensifikohet bashkëpunimi në funksion të përfaqësimit parlamentar në strukturat multilaterale parlamentare, në të cilat Kosova është pjesë ose mëton të bëhet brenda një afati të shkurtër.

3.12. Shërbimi i Jashtëm

Një prioritet tjetër do të jetë zhvillimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, si dhe profesionalizimi dhe rritja e performancës së trupit diplomatik të Kosovës për t’u përballur me efikasitet kundrejt sfidave aktuale dhe ato të së ardhmes. Do të vazhdohet me zgjerimin e rrjetit diplomatik në botë.

Struktura organizative e Ministrisë së Punëve të Jashtme reflekton realitetet e reja të marrëdhënieve ndërkombëtare sot, si dhe nevojat dhe interesat e Kosovës në të ardhmen. Reforma organizative, e ndërmarrë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe nevoja për ta forcuar aftësinë e Kosovës për të vepruar në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të ofrojë shërbime më të mira konsullore për qytetarët jashtë vendit. Qëllim i këtij procesi të riorganizimit vazhdon të jetë përmirësimi i mënyrës në të cilën Ministria merret me çështjet e politikës së jashtme në forume bilaterale dhe multilaterale dhe për të siguruar një zbatim më efektiv të objektivave të politikës së jashtme të Kosovës.

Si rrjedhojë, domosdoshmëria e ndryshimit të ligjit aktual mbetet prioritet, me qëllim të rregullimit të veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm dhe statusit të diplomatit në veçanti, si pjesë e veçantë e Shërbimit Civil, që administrohet me këtë ligj, si organizimin, bashkërendimin dhe funksionimin e organeve me Institucionet përgjegjëse për politike të jashtme të Republikës së Kosovës, sipas parimit “Një Shërbim, një Ministri”.

Struktura e re do të vazhdojë të mundësojë një përgatitje, koordinim më të mirë dhe prioritizim të politikës së jashtme të Kosovës në të gjitha nivelet ndërkombëtare, duke paraqitur pozicione të qarta, të vazhdueshme dhe koherente. Struktura e re do të përpiqet më tutje për të integruar hartimin e politikave dhe të sigurojë një qasje të integruar ndaj çështjeve tematike në përpjekje për të adresuar sfidat e sotme dhe të së ardhmes.

Ministria e Punëve të Jashtme do të vazhdojë të forcojë Shërbimin Diplomatik të Kosovës dhe të sigurojë stafin e vet me mundësi për zhvillim në karrierë. Procesi i riorganizimit ka mundësuar krijimin e Akademisë Diplomatike, e cila do të vazhdojë të jetë një institucion i rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve njerëzore të Shërbimit të Jashtëm të Kosovës. Akademia Diplomatike do të vazhdojë të fuqizojë kapacitetet e saj për të ofruar ekspertizë dhe asistencë për Ministrinë e Punëve të Jashtme në çështje të ndryshme regjionale, planifikimit të politikave dhe çështje të tjera të politikës së jashtme.

Qëllimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme është që të vazhdojë të zgjerojë praninë diplomatike të Kosovës në botë, me një staf të vogël dhe profesional, por që do të mundësojë që Kosova të ketë një prani globale, për të përfaqësuar më mirë dhe në mënyrë më efektive interesat e saj në rajone të ndryshme të botës. Kosova ka krijuar një prani të suksesshme diplomatike në Evropë, Amerikën Veriore, qendrore dhe në Azi. Fokusi në vitet e ardhshme, për të adresuar sfidat ndërkombëtare të Kosovës, do të jetë për të qenë e pranishme me misione diplomatike në Evropën Lindore dhe Jugore, Azinë Juglindore dhe Afrikë që do të shtyjë përpara objektivat e politikës së jashtme të Kosovës, për t'u integruar plotësisht në bashkësinë ndërkombëtare.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit, politika e jashtme është duke identifikuar/zhvilluar metoda të reja pune. Fuqizimi i koordinimit në mes sektorëve të ndryshëm ngrit prestigjin ndërkombëtarë të RKS-së dhe kontribuon në ngritjen e efikasitetit të përfaqësimit të interesit shtetëror. Elementi kyç mbetet përfaqësimi i unifikuar i politikës së jashtme të të gjithë dikastereve qeveritarë. Sistemi i unifikuar i përfaqësimit është një garancë për qytetarët që

shteti i Kosovës ofron shërbime në të gjitha segmentet/marrëdhëniet, duke ndjekur standardet e njëjta profesionale. Nëpërmjet sistemit të unifikuar, Kosova do të vazhdojë të ketë një prani diplomatike për të adresuar me stafin e saj në çështjet politike, ekonomike, konsullore, kulturore dhe të mbrojtjes, të cilat do të forcojnë interesin e Kosovës në nivel bilateral dhe multilateral.

Duke u përpjekur të shfrytëzojmë avantazhet buxhetore, do të vazhdohet me modernizimin e shërbimeve konsullore. Suksesi i këtij shërbimi do të përforcojë lidhjen në mes shtetit dhe qytetarit e që në masë të madhe do të sigurojë imazhin e mirë publik të Kosovës edhe jashtë vendit.

Kosova do të vazhdojë të zgjerojë rrjetin e saj konsullor në Azi, Evropë dhe Amerikën e Veriut, për të ofruar shërbime publike civile të qytetarëve të saj që jetojnë jashtë vendit. Kosova do të vazhdojë bashkëpunimin me Shqipërinë për të ofruar shërbime të përbashkëta konsullore, bazuar në marrëveshjet e përfaqësimit të përbashkët konsullor mes dy vendeve, në veçanti shembulli i përfaqësimit të përbashkët Konsullata e Përgjithshme në Milano.

Zgjerimi i pakos së shërbimeve konsullore dhe ngritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve është një nga synimet në vazhdimësi. Në kuadër të kësaj, parimi “efikasitet në shërbim dhe jo tarifa” mbeten ndër synimet kryesore të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Duke filluar të aplikohet në të gjitha misionet konsullore, shërbimi i marrjes së dokumenteve personale të identifikimit me procedurë të përshpejtuar, me qëllim të shkurtimeve të afatit kohor për lëshimin e dokumenteve personale të identifikimit me kosto më të ulët.

Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet uljes së taksave konsullore për disa shërbime që nuk kanë implikime postare dhe që realizohen në mision “aty për aty”, do të shtojë eficiencën e shërbimit dhe promovojmë zgjerimin e pakos së shërbimeve që nuk janë ofruar më herët. Si ministri përparësi do t’i jepet avancimit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale, assesi gjenerimit të mjeteve.

Po ashtu, vazhdimi i ofrimit të të gjitha shërbimeve të gjendjes civile në misione konsullore/diplomatike, në mënyrën “one-stop-shop”, do të decentralizojë shërbimin dhe do të shtojë përgjegjësinë profesionale të personelit diplomatik. Si rezultat, do të lehtësohen procedurat burokratike dhe adresohen direkt kërkesat e shtetasve kosovarë për shërbime të caktuara civile. Shërbime të cilat ofrohen në nivel komunal në Kosovë, pa pasur nevojë që të adresojnë gjatë pushimeve në vendlindje.

Ndër prioritetet në fushën e shërbimeve konsullore, që duhet të adresohen, në fokus do të jetë edhe shpërndarja e mëtutjeshme e sistemit të vizave, me një shtrirje globale, nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi në misione të tjera, dhe ndërmjetësuesve komercialë e organeve të autorizuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

4. ARSIMI, SHKENCA, KULTURA, RINIA DHE SPORTI

4.1. Arsimi dhe shkenca

Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të ndërtojë një shoqëri të dijes, të integruar në rrjedhat evropiane dhe me mundësi të barabarta për zhvillim personal. Në përputhje me këtë vizion, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet të ndërtojë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe shoqërisë. Në këtë kuadër, Qeveria do të angazhohet në përmirësimin e kuadrit strategjik në sektorin e arsimit përmes hartimit të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021. Gjithashtu, do të bëhet rishikimi i dokumenteve dhe politikave arsimore që kanë të bëjnë me Kornizën e Kurrikulës të Kosovës, Kurrikulat Bërthamë, përkatësisht me strukturën e arsimit, si dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore në nivel të MASHT-it, komunës dhe shkollës për zbatimin e Kurrikulës së Re të Kosovës. Duke e konsideruar arsimin si një ndër përcaktuesit kryesorë të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate ekonomike dhe sociale të vendit, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet ta trajtojë sektorin e arsimit si një prioritet themelor për zhvillimin e vendit, angazhim ky që do të reflektohet edhe në peshën që do t'i jepet arsimit dhe shkencës në ndarjen e buxhetit vjetor. Programi qeverisës për fushën e arsimit dhe të shkencës është i strukturuar në këto shtylla:

- Reformat strukturore në arsim;
- Rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim;
- Sigurimi, garantimi dhe rritja e cilësisë së arsimit;
- Menaxhimi i institucioneve të arsimit;
- Integrimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Promovimi i shkencës dhe i hulumtimeve;
- Financimi i arsimit dhe i shkencës.

4.1.1. Reformat strukturore në arsim

Ndërtimi dhe funksionalizimi i Programit Kombëtar për Zhvillim gjatë Fëmijërisë së Hershme, i cili do të ofrojë shërbime dhe vizita të rregullta të mjekëve në familjet e fëmijëve të moshës 0-3 vjet, sigurimi i hapësirave të mjaftueshme, si adaptimi i shtëpive ekzistuese nëpër fshatra apo lagje, për arsimin parashkollor për fëmijët e moshës 3-6, si dhe trajnimi dhe punësimi i një numri të konsiderueshëm të edukatoreve, janë ndër pikat kyçe të Programit të Qeverisë për fushën e Arsimit. Arsimi i mesëm i ulët (klasa 6-9) do të jetë bazë për orientim në arsimimin e mëtejshëm të nxënësve, duke i përshtatur plan-programet dhe duke përgatitur stafin e mësimdhënësve.

Duke pasur parasysh numrin e madh të nxënësve në paralele, sidomos në arsimin e mesëm të lartë, Qeveria do të angazhohet për krijimin e kushteve infrastrukturore për mësim, me qëllim të eliminimit të mbingarkesave dhe turneve në shkolla. Qeveria do të punojë për plotësimin e kushteve të nevojshme që arsimi para-universitar të jetë i obligueshëm, siç e përcaktojnë edhe rrjedhat evropiane të arsimit.

Gjithashtu, Qeveria do të punojë në ofrimin e mundësive të zgjedhjes për të rinjtë tanë që ata të përcaktohen për arsim të përgjithshëm ose profesional, në përputhje me zhvillimet në

tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe në Evropë. Proporcioni në mes arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional do të vendoset në përputhje me projeksionet e kërkesës në tregun e punës në Kosovë dhe në rajon.

Zhvillimi i institucioneve të arsimit të lartë profesional dhe promovimi i gradave profesionale në arsimin e lartë, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve - do të stimulohet hapja e programeve të studimeve me orientim profesional, që do të ndryshojnë në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për sigurimin e kushteve për kryerjen e punës praktike dhe lidhjes me tregun e punës. Do të sigurohen kushtet për kryerjen e punës praktike në shkollat profesionale dhe do të vendosen lidhje institucionale me ekonominë edhe në fushën e plan-programeve, për kryerjen e praktikës profesionale - sistemi dual i arsimit.

Rritja e shkallës së punësimit dhe fuqizimi i trajnimit profesional, duke u bazuar në nevojat e tregut të punës, sidomos zhvillimit të trekëndëshit 'triple helix', bashkëpunimi: universitet-qeveri-treg i punës.

Do të bëhet promovimi i shkathtësive për ndërmarrësi në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, sepse ato konsiderohen kyçe për gjenerimin e ideve të reja dhe në punësimin e të rinjve që mbarojnë shkollimin. Qeveria do të punojë për futjen në sistemin arsimor të lëndëve e temave mësimore që pajisin studentët me shprehje dhe shkathtësi për sipërmarrje.

Promovimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës do të zhvillohet në programe për arsimim, riarsimim dhe rikualifikim të të rriturve, për të mundësuar përtëritjen e njohurive të tyre për të mundësuar integrimin dhe qëndrueshmërinë e tyre në tregun e punës.

Do të themelohet Universiteti i Shkencave Bujqësore, i cili do të vendoset në trekëndëshin Prizren-Rahovec-Suharekë (Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës do të bartet në këtë Universitet). Ky universitet do të merret ekskluzivisht me studime bujqësore, sipas modelit gjerman. Këtij universiteti do t'i jepet një pronë e konsiderueshme nga tokat e ndërmarrjeve shoqërore për qëllime studimore dhe të praktikës së studentëve. Në kuadër të këtij universiteti do të themelohen edhe inkubatorë për biznese bujqësore. Gjithashtu, do të ndahen bursa për studime në këtë universitet për të nxitur krijimin e kuadrove në lëmi të ndryshme bujqësore.

4.1.2. Rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim

Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e ulët të fëmijëve në edukimin parashkollor, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin lokal, do të angazhohet për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor nëpërmjet skemave publiko-private për stimulimin e ndërtimit të objekteve të kopshteve për fëmijë dhe përkrahjen e institucioneve private të edukimit parashkollor. Në këtë kuadër, Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për hapjen e paraleleve para-filllore në të gjitha shkollat e Kosovës

për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa në institucionet parashkollore.

Ngritja e vetëdijes në nivelin lokal për investim në fëmijërinë e hershme dhe fuqizimi i bashkëveprimit ndër-sektorial.

Rritja e pjesëmarrjes në arsimin e lartë, në përputhje me trendet evropiane, nëpërmjet zhvillimit dhe implementimit të politikave që ndihmojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë drejt arritjes së mesatares evropiane. Krijimi i universiteteve të reja, hapja e programeve të reja, si dhe rritja e kërkesës për arsim të lartë e bën të domosdoshëm shtimin e numrit të kuadrove akademike dhe avancimin e përgatitjes së tyre.

Qeveria do të ndajë fonde të veçanta që do të shërbejnë për të stimuluar studentët të orientohen në degë të rëndësishme strategjike për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, me fokus të veçantë në shkencat ekzakte, bujqësi, inxhinieri dhe mjekësi. Për programet deficitare do të ketë trajtim të veçantë, duke mundësuar kosto zero të studimit.

Sigurimi i arsimimit për zhvillimin e shkathtësive bazë në gjuhën shqipe dhe për marrjen e njohurive të nevojshme për kulturën për fëmijët në diasporë. Përkrahja për fëmijët e diasporës dhe të mërgatës, me qëllim të ruajtjes së gjuhës dhe identitetit kombëtar, do të vazhdojë nëpërmjet furnizimit me libra dhe aktivitete të ndryshme edukativo-arsimore.

4.1.3. Sigurimi, garantimi dhe rritja e cilësisë së arsimit

Qeveria do të punojë që sigurimi, garantimi dhe ngritja e cilësisë në arsimin para universitar të bëhet nëpërmjet:

- Përmirësimin të infrastrukturës arsimore, sipas standardeve evropiane. Fokus i rëndësishëm do të jetë pajisja dhe avancimi i institucioneve arsimore publike me teknologji të avancuar, kompjuterë dhe qasje në internet, në funksion të rritjes së cilësisë në arsim. Qeveria do të investojë për informatizimin dhe digjitalizimin e shkollave, si dhe të programeve arsimore me anë të mësimin dhe përmbajtjeve elektronike që nga shkolla fillore, për të siguruar se çdo fëmijë do të ketë mundësi të barabartë për qasje në teknologjinë informative;
- Përsheptimit të procesit të licencimit të mësimdhënësve (realizimi i programit Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve);
- Përmirësimin të vazhdueshëm të plan-programeve dhe teksteve shkollore;
- Prioritet i rëndësishëm do të jetë ndërtimi i kapaciteteve njerëzore për implementimin e kurrikulës së re. Në funksion të rritjes së cilësisë në arsimin para universitar do të vazhdojmë me zbatimin e kurrikulës nëpërmjet shkollave pilot, pastaj në varësi të rezultateve kurrikula do të reformohet. Prioritet i rëndësishëm do të jetë verifikimi i implementimit të kurrikulës së re në arsimin para universitar, trajnimi i mësimdhënësve lidhur me kurrikulat e reja, hartimi i plan-programeve sipas fushave dhe niveleve, furnizimi i shkollave me mjete dhe materiale didaktike, hartimi i teksteve shkollore në bazë të kurrikulave të reja;

- Krijimit të kushteve më të mira për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Në mënyrë që të kemi rezultate reale dhe rritje të cilësisë, do të bëhet vlerësimi i jashtëm i nxënësve përmjet testeve vlerësuese të klasës së 5-të, 9-të dhe testit të maturës sipas standardeve evropiane;
- Funkcionalizimit të shërbimeve profesionale në shkolla (mjekut, psikologut, pedagogut, punonjësit social etj.);
- Krijimit të mekanizmave dhe të standardeve për vlerësimin dhe monitorimin e brendshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Vendosijes së standardeve të arritshmërisë për të tri nivelet e arsimit para universitar (fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë);
- Zhvillimin e politikave për aftësimin dhe riaftësimin profesional të kuadrove për mësimdhënës në arsimin para universitar;
- Promovimit dhe mbështetjes së Agjencisë Shtetërore për Aftësimin e Vazhdueshëm të Mësimdhënësve;
- Promovimit dhe mbështetjes së Agjencisë së Pavarur për Implementimin e Testeve Kombëtare;
- Fuqizimit të Agjencisë për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur.
- Organizimit të skemës së garave të njohurive në nivel të shkollës, të komunës dhe të vendit.

Sigurimi dhe ngritja e cilësisë në arsimin e lartë do të bëhet nëpërmjet politikave dhe masave të mëposhtme:

- Rritja e buxhetit për arsimin e lartë në Kosovë për të siguruar implementimin e reformave të domosdoshme, respektivisht përmirësimit të infrastrukturës arsimore dhe zhvillimit akademik (ritjen e kuadrit akademik) sipas standardeve evropiane;
- Reformimi i strukturave të institucioneve publike të arsimit të lartë;
- Rritja e kërkesës dhe e kontrollit të cilësisë së bartësve jopublikë;
- Forcimi i lidhjes së institucioneve të arsimit të lartë me ekonominë dhe shndërrimi i universiteteve në gjenerator të zhvillimit ekonomik të Kosovës;
- Sigurimi i krahasueshmërisë së plan-programeve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë me ato evropiane;
- Ndërtimi i skemave subvencionuese për studentët brenda dhe jashtë vendit. Rendësi e veçantë do t'i jepet ndërtimit të një skeme stimuluese për kthimin dhe ruajtjen e kuadrove;
- Përfshirje të grupeve të marginalizuara dhe të komuniteteve minoritare në arsimin e lartë;
- Nxitja e mobilitetit të studentëve dhe mësimdhënësve. Qeveria do të themelojë një Fond për Bursa të studimeve të avancuara të nivelit të doktoraturës, postdoktoraturës, si dhe për të rritur shkëmbimet e akademikëve dhe për të mundësuar pjesëmarrjen në konferenca apo forume shkencore dhe ndërkombëtare;
- Krijimi i mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të brendshëm të cilësisë;
- Modernizimi i mjediseve të mësimin nëpërmjet ngritjes së laboratorëve në institucione të arsimit të lartë dhe ngritjen e qendrave moderne kompjuterike;

- Rritja e kapaciteteve hapësinore dhe përmirësimi i mjediseve të banimit të studentëve. Duke marrë parasysh themelimin e universiteteve të reja, do të ndërtohen konvikte për strehim të studentëve dhe profesorëve vizitorë;
- Avancimi i arsimit të lartë dhe i hulumtimeve shkencore nëpërmjet mjeteve teknike dhe teknologjike, bibliotekave (përfshirë edhe ato elektronike) dhe laboratorëve;
- Universitetet duhet të krijojnë një arkiv elektronik të përbashkët të të gjitha doktoraturave dhe një listë të punimeve të publikuara shkencore nga kuadri i tyre akademik;
- Universitetet publike të rishikojnë kriteret për zgjedhjen dhe avancimin e kuadrit akademik.

4.1.4. Menaxhimi i institucioneve të arsimit

Përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të institucioneve arsimore do të realizohet nëpërmjet implementimit të këtyre politikave:

- Decentralizimi i vendimmarrjes në nivelin lokal;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrave të inspektimit dhe bashkëpunimi me Drejtoritë Komunale për Arsim në Kosovë (krijimi i Agjencisë të Inspektoratit Arsimor);
- Fuqizimi i rolit të shkollës në vendimmarrje;
- Do të angazhohemi për qasje të përfshirjes aktive të të gjitha palëve të interesit në menaxhimin e institucioneve arsimore (këshillat e prindërve, organizatat e të drejtave të fëmijëve dhe OJQ-të e tjera, shoqëria civile, organizatat e nxënësve);
- Aftësim i vazhdueshëm i menaxherëve të institucioneve arsimore;
- Qeveria do të përkujdeset që në nivelin qendror dhe në nivelin komunal të funksionalizohen mekanizma që sigurojnë respektimin e kodit të mirësjelljes në shkolla; Kujdes i veçantë do t'i jepet sigurisë në shkolla dhe parandalimit të dhunës;
- Autonomi substanciale e institucioneve të arsimit të lartë dhe e njësive akademike. Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për autonomi substanciale të institucioneve të arsimit të lartë dhe njësive akademike. Ne e shohim rritjen e autonomisë universitare si thelbësore në rritjen e cilësisë së arsimit tonë të lartë. Prandaj, zotohemi që me masa konkrete të mbështesim universitetet për autonomi më të madhe, jo vetëm në programet mësimore, por edhe në administrimin e buxheteve, në mënyrë që universitetet t'i përdorin në mënyrë sa më optimale dhe fleksibile burimet e kufizuara materiale të cilat ato i zotërojnë.

Universitetet duhet të funksionalizojnë Komisionet për Etikë dhe ato duhet të punojnë në mënyrë transparente dhe profesionale. Do të mbështetet fuqizimi i njësive për sigurimin e cilësisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Transparencë në veprim dhe komunikim, si dhe përgjegjshmëri e plotë në funksionimin e institucioneve të administratës së arsimit në procesin e shpenzimit të mjeteve publike për zhvillimin e sistemit të arsimit. Do të angazhohemi për politika koherente, si dhe rregullore dhe masa që sigurojnë funksionim, ndarje të përgjegjësisë dhe komunikim koherent ndërmjet niveleve dhe segmenteve të sistemit të arsimit.

4.1.5. Integrimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Sa i përket integrimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për:

- Integrimin e arsimit të lartë në Hapësirën Evropiane të Arsimit;
- Pjesëmarrje aktive në projekte ndërkombëtare, si: TEMPUS, Erasmus-Mundus, Horizon 2020, etj.;
- Promovimin e bashkëpunimit (binjakëzimit) të institucioneve arsimore të Kosovës me ato të vendeve të BE-së;
- Pjesëmarrje në teste dhe vlerësime ndërkombëtare të cilësisë në arsim, si PIZA etj.

4.1.6. Promovimi i shkencës dhe i hulumtimeve

Do të investohet në ngritjen e kapaciteteve hulumtuese nëpërmjet programeve të ndryshme, motivimin e hulumtuesve, zhvillimin e infrastrukturës së duhur fizike (laboratorëve, bibliotekave e pajisjeve) dhe financimin e mjaftueshëm për të mbështetur hulumtimet shkencore relevante. Ndër masat tjera konkrete përfshihen:

- Funkcionalizimi dhe fuqizimi i Këshillit Kombëtar të Shkencës;
- Mbështetja financiare e projekteve dhe publikimeve të instituteve shkencore. Përkrahja e rezultateve të rëndësishme në fushën e shkencës;
- Krijimi i një sistemi të integruar për shfrytëzimin efikas të krijimtarisë shkencore-hulumtuese të Kosovës;
- Integrimi i Kosovës në Hapësirën Evropiane të Hulumtimeve;
- Mbështetje dhe mobilizim të komunitetit shkencor në Kosovë për aplikim me projekte kërkimore në fondet e BE-së.

Do të rishikohen modalitetet e implementimit të Fondit për Shkencë që menaxhohet nga MASHT-i. Duhet të zhvillohet një fushatë e mirë informuese për mundësitë që ofron Fondi për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese. Do të konsolidohen mekanizmat për shfrytëzimin efektiv të fondit të Programit Kombëtar të Shkencës që sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie. Do të promovojmë decentralizimin e institucioneve të arsimit të lartë, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe stimulimit për nxitjen e projekteve kërkimore-shkencore.

Themelimi dhe funksionalizimi i Agjencisë për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim. Themelimi i Qendrës Nacionale të Kërkimeve të Avancuara - QNKA, si një institucion publik i kërkimeve në fushat e dijeve humane e sociale, që do të ketë për bazë punën e instituteve shkencore ekzistuese dhe themelimin e segmenteve të reja.

4.1.7. Financimi i arsimit dhe i shkencës

Qeveria do të angazhohet për përcaktimin e një formule financimi për menaxhimin e të hyrave vetanake për institucionet publike të arsimit të lartë, e cila ofron fleksibilitet në shfrytëzimin e mjeteve financiare, heqjen e kufizimeve për shfrytëzimin e të hyrave vetanake, si dhe rritjen e llogaridhënies. Do të rishikohet formula për financimin e arsimit të lartë, që

do të ketë për bazë numrin e studentëve, numrin e stafit akademik, programet specifike dhe specifikat e programeve të ndryshme.

Pjesëmarrja e shpenzimeve për arsim në BPV dhe në shpenzimet e përgjithshme qeveritare në përputhje me mesataren evropiane.

Krijimi i skemave të të ardhurave të punonjësve të arsimit bazuar në rezultatet e tyre, duke përfshirë këtu njohjen e përvojës së mësimdhënësve gjatë viteve të sistemit paralel të arsimit. Sigurimi i burimeve alternative financiare nëpërmjet krijimit të mekanizmave për sigurimin dhe realizimin e ndihmave të ndryshme, përfshirë projekte të ndryshme dhe donatorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Sigurimi i skemave stimuluese të financimit të studentëve të të gjitha niveleve me rezultate shumë të larta. Gjithashtu, do të ndahen fonde të mjaftueshme për zbatimin efektiv të Programit Kombëtar të Shkencës.

4.2. Kultura

4.2.1. Përkrahja e krijimtarisë kulturore

Rritja e vazhdueshme e buxhetit të institucioneve publike të kulturës: Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të rrisë buxhetin për institucionet publike të kulturës, Teatrin Kombëtar të Kosovës, Qendrën Kinematografike të Kosovës, Filarmoninë e Kosovës, Baletin e Kosovës, Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” etj., në mënyrë që të rritet krijimtaria artistike dhe që publikut t’i ofrohen programe të pasura dhe me vlera kulturore. Krahas pasurimit të programit të tyre, buxheti do të orientohet edhe në promovimin e krijimtarisë së tyre në vende të ndryshme të botës. Atyre do t’u garantohej funksionimi profesional, autonom dhe apolitik, si dhe shtrirja e vendimmarrjes.

Rritja e mbështetjes financiare për skenën e pavarur kulturore: Në Kosovë çdo vit mbështeten me qindra aktivitete kulturore të fushës së kinematografisë, teatrit, muzikës, arteve pamore dhe arteve të tjera. Qeveria e Kosovës do të rrisë buxhetin për aktivitete tashmë tradicionale që kanë edhe karakter ndërkombëtar, siç janë festivale të ndryshme të filmit dhe të muzikës. Këto aktivitete organizohen nga operatorë privatë të kulturës. Po ashtu, nëpërmjet subvencionimeve të ndryshme do të mbështeten artistët e pavarur për krijime të ndryshme dhe mbështetje për prezantim të tyre në skenën e kulturës ndërkombëtare.

Rritja e buxhetit për kinematografinë: Kinematografia është një fushë e rëndësishme për promovimin e kulturës së vendit tonë, prandaj Qeveria e Kosovës do t’i kushtojë vëmendje të veçantë duke rritur buxhetin për prodhim të filmave dhe për lidhjen e bashkëpunimit me qendra simotra të vendeve të tjera, me të cilat Qendra Kinematografike e Kosovës mund të nënshkruajë marrëveshje për projekte të bashkëpunimit dhe të bashkëprodhimit të filmit.

Rritja e buxhetit për librin dhe veprimtarinë botuese: Qeveria e Republikës së Kosovës do t’i kushtojë një rëndësi të veçantë botimit dhe qarkullimit të librit. Do të rritet buxheti për

librin dhe po ashtu do të mbështeten aktivitete të ndryshme botuese që kanë për synim promovimin dhe prezantimin e krijuesve tanë letrarë. Nëpërmjet Këshillit të Librit, mbështetja për librin do të jetë në disa forma, nëpërmjet financimit të botimit të titujve të rinj, blerjes së librave nga botuesit dhe shpërndarjes së tyre në biblioteka të qyteteve, si dhe në mbështetjen e botimit të revistave letrare. Qeveria e Kosovës do të mbështesë botuesit dhe shoqatat e tjera nga Fondi për Subvencionime të Kulturës, për prezantim në panairë ndërkombëtare të librit, organizimin e panairove të librit në Kosovë dhe takime të ndryshme letrare. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës do të aplikojë lehtësime fiskale për librin në përgjithësi.

Rritja e mbështetjes financiare për teatrot dhe bibliotekat e qyteteve: Qeveria e Kosovës do të ndajë fonde të veçanta për teatrot e qyteteve, në mënyrë që në tërë Kosovën të zhvillohet jeta teatrale dhe për këtë do rris buxhetin e tyre. Gjithashtu, bibliotekat e qyteteve çdo vit do të kenë fonde të veçanta për pasurimin e fondit të librit. Qeveria do të zhvillojë politika për avancimin e bibliotekarisë në Kosovë, digjitalizimit të materialeve dhe të dhënave, si dhe për përmirësimin e kushteve të punës dhe qasjes në informata.

Reformimi i legjislacionit për artin dhe kulturën: Qeveria e Republikës së Kosovës do të plotësojë infrastrukturën ligjore në fushën e kulturës dhe do të punojë në reformimin e saj, duke e përfaruar atë me praktikatat më të mira ndërkombëtare, ato të vendeve të rajonit, si dhe të Bashkimit Evropian. Prioritet do të jenë hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Kulturë, si dhe Ligji për Sponsorizime dhe Donacione, si dy dokumente mjaftë të rëndësishme për zhvillimin e jetës kulturore në vend dhe prezantimin ndërkombëtar të saj. Qeveria do të miratojë Ligjin e ri për Kinematografinë dhe do të rishqyrtojë ligjet ekzistuese për fushat e caktuara, në mënyrë që t'i bëjë ato sa më të zbatueshme dhe më të favorshme për jetën kulturore në vend dhe në pajtim me praktikatat ndërkombëtare. Qeveria do t'i përfshijë shoqatat dhe grupet e ndryshme të artistëve në vendimmarrje, si dhe në grupet punuese për plotësimin e pakos legjislative.

Prezantimi i Kosovës në evenimentet prestigjioze ndërkombëtare të artit dhe të kulturës: Vendi ynë tash e disa vite prezantohet në evenimentet më të rëndësishme të kulturës në botë, siç janë; Bienalja e Venedikut, Festivali i Filmit në Cannes, Festivali i Filmit në Berlin, Panairin e Librit në Frankfurt dhe shumë ngjarje të tjera të rëndësishme. Qeveria e Kosovës do të rrisë buxhetin për prezantimin e Kosovës në këto ngjarje, por edhe në ngjarje të tjera shumë të rëndësishme të kulturës në botë, duke e shikuar këtë angazhim edhe nga prizmi i përafërimit të kulturës sonë me atë evropiane.

Zbatimi i Kalendarit të Përbashkët Kulturor me Republikën e Shqipërisë: Kultivimi i relacioneve të veçanta kulturore me Shqipërinë dhe me vendet e tjera ku jetojnë shqiptarët do të thellohet. Tashmë, Kosova dhe Shqipëria kanë krijuar Kalendarin e Përbashkët Kulturor. Qeveria do të vazhdojë të angazhohet në zbatimin e këtij kalendar, duke e pasuruar atë për çdo vit si dhe me rritjen e buxhetit për aktivitetet e përbashkëta, që organizohen përgjatë vitit në kuadër të tij. Ky kalendar shënon një hap të ri të bashkëpunimit mes Kosovës dhe

Shqipërisë dhe është një urë lidhëse dhe bashkëpunimi shumë e fortë mes dy vendeve tona. Ai do të ofrohet si model bashkëpunimi në kuadër të nismave rajonale.

Qasja në fondet kulturore të Bashkimit Evropian: Qeveria e Kosovës do të angazhohet në gjetjen e donacioneve të jashtme për kulturën, si dhe do të krijojë qasje në fondet vjetore të Bashkimit Evropian për kulturën. Po ashtu do të zgjerohen edhe rrjete të tjera të bashkëpunimit kulturor, nëpërmjet të cilave synohet ndarja e fondeve për skenën tonë kulturore.

Themelimi i Qendrave të Kulturës së Kosovës në shtete të ndryshme: Bazuar edhe në legjislacionin në fuqi, por edhe në prioritetet e Qeverisë në katër vitet e ardhshme, rëndësi të veçantë do t'i kushtohet Diasporës, me theks në fushën e kulturës. Përveç mbështetjes së aktiviteteve të ndryshme kulturore në Diasporë, Qeveria do të themelojë së paku pesë Qendra të Kulturës së Kosovës në vende të ndryshme të botës, me fokus të veçantë në vende ku jetojnë më shumë qytetarë nga Kosova.

Qeveria e Kosovës do të miratoj Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, ligj i cili do të jetë i harmonizuar me legjislacionin evropian dhe ndërkombëtar të fushës. Në këtë aspekt do të miratohet edhe Rregullator për Kompensime të veçanta, me qëllim të kompensimit të mbajtësve të të drejtave për shfrytëzimin e veprave të të njëjtëve për përdorim privat. Gjithashtu, do të miratohen edhe rregulloret të cilat dalin nga dispozitat e reja të ligjit mbi ndryshimin e ligjit në fuqi.

4.2.2. Përmirësimi i infrastrukturës fizike

Ndërtimi i Teatrit të Operas dhe Baletit “Dr. Ibrahim Rugova”: Pas problemeve të theksuara në projektin e mëhershëm të Teatrit të Operës dhe Baletit “Ibrahim Rugova”, Qeveria e Republikës së Kosovës do të shpallë konkurs të ri ndërkombëtar për projektimin dhe më pas ndërtimin e tij. Ky është një projekt kapital për artet skenike dhe i cili do të përfaqësojë vlera të mirëfillta kulturore.

Ndërtimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor: Qeveria e Kosovës e ka të gatshëm projektin për ndërtimin e Muzeut të Arteve Bashkëkohore dhe do të fillojë menjëherë me procedurat për ndërtimin e tij në Prishtinë. Si alternativë e realizimit të këtij projekti mund të shqyrtohet edhe adoptimi i ndonjëres nga ndërtesat publike ekzistuese, që mund të jenë të përshtatshme për krijimin e këtij Muzeu. Ky do të jetë një institucion shumë i rëndësishëm për artistët dhe do të krijojë një imazh edhe më pozitiv për Kosovën.

Renovimi i plotë i Teatrit Kombëtar të Kosovës: Teatri Kombëtar i Kosovës do të rinovohet në tërësi, për të siguruar kushte moderne për punë për artistët. Renovimi do të bëhet edhe për qëllim të modernizimit të hapësirës ekzistuese dhe funksionalizimit më të mirë të saj.

Renovimi i plotë i Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Bogdani”: Biblioteka Kombëtare “Pjetër Bogdani” tash është institucion i veçantë dhe Qeveria e Kosovës do të hartojë politika

për zhvillimin e saj dhe në këtë kontekst do të investohet edhe në renovimin e tërësishëm të saj, për të krijuar kushte sa më të lehta dhe më moderne për punë dhe qasje në të.

Renovimi i plotë i Muzeut të Kosovës: Nga viti i ardhshëm, 2015, do të fillojë edhe renovimi i plotë i Muzeut të Kosovës, si institucion përfaqësues i trashëgimisë kulturore të Kosovës. Projekti përfshinë renovime të plota, me ç'rast do të krijohen kushte adekuate dhe moderne për ruajtjen e artefakteve, si dhe prezantimin e tyre para publikut. Projekti është i gatshëm dhe fillimi i punës do të ndodh menjëherë.

Mbështetje financiare për renovimin e objekteve të artit dhe kulturës nëpër komuna: Qeveria e Kosovës do të ndajë buxhet për renovimin e objekteve të institucioneve kulturore nëpër komuna, siç janë shtëpitë e kulturës, teatrot, bibliotekat. Po ashtu, do të mbështeten komunat me buxhet të nevojshëm për renovime dhe projekte të reja infrastrukturore në fushën e kulturës.

4.2.3. Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Avancimi i legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë: Qeveria e Republikës së Kosovës do të miratojë Ligjin e Ri për Trashëgiminë Kulturore, si dhe Ligjin për Muzetë. Të dy këto ligje do të ofrojnë mundësi më të mira për menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu do të hartohet dhe miratohet Strategjia për Ruajtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore, por edhe dokumente të tjera, rregullore apo udhëzime që dalin si nevojë e një menaxhimi sa më profesional dhe më të mirë të trashëgimisë kulturore.

Rritja e mbështetjes financiare për gërmime arkeologjike: Qeveria e Republikës së Kosovës do të rrisë buxhetin për zhvillimin e gërmimeve arkeologjike, si një aspekt shumë i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore dhe promovimit të një qytetërimi të hershëm në Kosovë. Gërmimet arkeologjike të cilitdo karakter do të vazhdojnë të jenë prioritet i Qeverisë së Kosovës.

Rritja e mbështetjes financiare për konservime dhe restaurime të monumenteve: Do të rriten fondet për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore: historike, kulturore dhe fetare. Qeveria do të vazhdojë me implementimin e programit për intervenime emergjente, si një fazë për ruajtjen e mëtutjeshëm të monumenteve deri në restaurimin e tërësishëm të tyre. Rol qendror do t'i jepet Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, si institucion bartës i proceseve të restaurimeve dhe konservimeve.

Miratimi i Listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme: Mosfunksionimi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka bërë që Kosova të mos ketë Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme. Gjithsesi, tash e tre vite është miratuar Lista e Përkohshme. Pasi t'i emërojë Kuvendi anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, do të fillojë menjëherë puna për hartimin dhe miratimin e Listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme, që është një dokument shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë sonë kulturore. Qeveria e Kosovës, pas krijimit tashmë të Databazës së Trashëgimisë Kulturore, do të vazhdojë punën në

kompletimin e Regjistrit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe në digjitalizimin e plotë të informatave për asetet e trashëgimisë kulturore.

Definimi i statusit të institucioneve publike të trashëgimisë kulturore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre: Qeveria e Kosovës, nëpërmjet infrastrukturës ligjore dhe angazhimeve të tjera, do të definojë statusin e secilit institucion të trashëgimisë kulturore dhe do të punojë në ngritjen e kapaciteteve dhe ndarjen e përgjegjësive konkrete brenda secilit institucion. Do të ndërtohet një sistem i qartë i punës dhe raportimit për një menaxhim më efikas të punës.

Themelimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore: Me Ligjin e ri për Trashëgiminë Kulturore parashihet edhe themelimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore. Inspektorati do të jetë një organ mbikëqyrës për të gjitha restaurimet, për konservime dhe gërmime arkeologjike. Roli dhe përgjegjësia e këtij mekanizmi janë përcaktuar qartë dhe mundësojnë punë efektive. Inspektorati do të mundësojë një ecuri të mirë të punëve dhe do t'i eliminojë paqartësitë dhe dyshimet për manipulime ose për punë joprofesionale.

Themelimi i parqeve të hapura arkeologjike në lokalitetet e Ulpianës dhe të Dresnikut: Në Kosovë, Lokaliteti Arkeologjik "Ulpiana" në Prishtinë dhe Lokaliteti Arkeologjik në Dresnik të Klinës janë dy nga pikat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe të trashëgimisë arkeologjike, në veçanti. Në këto dy pika janë bërë zbulime që datojnë nga epoka e ilirëve. Në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Kosovës, Qeveria do të vazhdojë punën në hartimin e planit për shndërrimin e këtyre dy lokaliteteve në parqe të hapura arkeologjike. Pra, këto dy lokalitete do të jenë pika të rëndësishme turistike dhe potencial i mirë për zhvillimin e turizmit kulturor, por edhe në promovimin e trashëgimisë dhe kulturës sonë në botë. Krahas tyre, Qeveria e Kosovës do të ndihmojë institucionet përkatëse në identifikimin edhe të lokaliteteve të tjera arkeologjike, të cilat mund të kenë potencial për t'u shndërruar po kështu në parqe arkeologjike.

Themelimi i Muzeut Arkeologjik dhe Muzeut Etnologjik: Miratimi i Ligjit për Muzetë do të hapë rrugë për një menaxhim më efikas të muzeve, si dhe do të krijojë bazën legale për themelimin e muzeve të tjerë. Në pajtim me legjislacionin përkatës, do të themelohet Muzeu Arkeologjik dhe Muzeu Etnologjik, por po ashtu do të shqyrtohet mundësia për themelimin e Muzeut të Paqes, nëpërmjet të cilit do të paraqitet rrugëtimi i popullit të Kosovës për liri dhe paqe. Në pajtim me rregullativën ligjore përkatëse, muzetë do të funksionojnë si një rrjet i muzeve të Kosovës, për të mundësuar qasje të lirë të publikut në të gjithë muzetë e Kosovës, si dhe për të lehtësuar prezantimin e trashëgimisë kulturore muzeore të Kosovës brenda dhe jashtë vendit.

4.3. Rinia

4.3.1. Fuqizimi i rinisë dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje

Mbështetje financiare për ndërmarrësit e rinj në moshë: Qeveria e Kosovës, nëpërmjet MKRS-së, do të krijojë fond të veçantë për ndërmarrësi, nëpërmjet të cilit do të mbështesë hapjen e bizneseve të reja nga të rinjtë tanë. Ky fond do të rritet çdo vit dhe do të orientohet

në fusha të ndryshme të biznesit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij fondi, do të zhvillohen trajnime të rregullta në fusha profesionale.

Rritja e mbështetjes financiare për organizatat rinore: Qeveria e Kosovës do të rrisë fondet për subvencionimin e organizatave rinore për aktivitete të ndryshme rinore, në promovimin e edukimit joformal, promovimin e shëndetit, artit, sportit, dialogut, nxitjen e fushatave të vetëdijesimit kundër dukurive negative dhe aspekte të tjera të zhvillimit shoqëror.

Mbështetje për KQVR-në, KLVR-të dhe Qendrat Rinore: MKRS-ja do të mbështesë çdo vit me buxhet Këshillin Qendror për Veprim, Këshillat Lokal të Veprimit Rinor, si dhe Qendrat Rinore si organet më të larta përfaqësuese të rinisë në Kosovë. Mbështetja do të shkojë, përveç në aktivitete të ndryshme, edhe në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale për avokim për çështje të rinisë dhe shoqërisë në përgjithësi. KQVR, KLVR-të dhe Qendrat Rinore do të mbështeten në veçanti që të shërbejnë si qendra inovative, në të cilat të rinjtë do të punojnë bashkë në prezantim të ideve të reja, qoftë në hapjen e bizneseve të reja, qoftë në zhvillimin e shkencës, sportit, kulturës dhe edukimit.

Ndërtimi i objekteve të Qendrave Rinore nëpër komuna: Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me ndërtimin e qendrave rinore, si hapësira ku të rinjtë zhvillojnë aktivitete të lira dhe trajnime të ndryshme profesionale. Pas asaj në Gjilan, pritet që të nis ndërtimi i qendrës rinore në Prishtinë. Në bashkëpunim dhe koordinim edhe me pushtetin lokal do të nisin projekte për ndërtimin e qendrave rinore dhe në komuna të tjera të Kosovës.

Thellim i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare që janë aktive në fushën e rinisë: Bashkëpunimi me organizata të ndryshme ndërkombëtare që janë aktive në fushën e rinisë do të rritet. Fokus i veçantë i bashkëpunimit do të jetë ndërmarrësia, edukimi profesional dhe promovimi i vlerave të mirëfillta shoqërore. Deri tash ka pasur bashkëpunim të frytshëm me Bankën Botërore, UNICEF-in, OSBE-në dhe organizata të tjera. Ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej. Po ashtu, do të ngrihet bashkëpunimi edhe me mekanizma të tjerë aktivë që avokojnë për rininë.

4.4. Sporti

4.4.1. Zhvillimi, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit

Qeveria do të angazhohet për masivizimin e sportit nëpërmjet investimeve në infrastrukturën sportive, mbështetjen e iniciativave dhe talentëve të rinj, promovimit të sportit shkollor dhe universitar dhe masivizimit të sportit, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe Kodit të Etikës në Sport. Do të mbrohet dhe promovohet autonomia e federatave sportive. Do të modernizohet infrastruktura sportive, palestrat, stadiumet e futbollit, pishina olimpike, shtigjet e atletikës, stadiumi nacional me standarde të UEFA/FIFA-së, poligonet sportive në shkolla dhe në lagje.

Përmbyllja e procesit të ndërkombëtarizimit të sportit të Kosovës: Kosova tashmë është anëtarësuar në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe në dhjetëra federata ndërkombëtare sportive. Në këtë drejtim, lobimi të cilin e ka zhvilluar MKRS-ja ka qenë thelbësor. Pas anëtarësimit të Komitetit Olimpik të Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar do të punohet edhe në disa procese komplekse të ndërkombëtarizimit të sportit, siç është anëtarësimi i Federatës së Futbollit të Kosovës në UEFA dhe FIFA, si dhe anëtarësimi i Federatës së Basketbollit të Kosovës në FIBA Evropë dhe FIBA. Me këto dy anëtarësime do të përmbillet procesi i gjatë i ndërkombëtarizimit të sportit. Qeveria, në bashkëpunim edhe me mekanizmat përkatës, do të ndihmojë në anëtarësimin edhe të federatave të tjera sportive të Kosovës në federatat përkatëse ndërkombëtare.

Avancimi i legjislacionit për sportin: Hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për Sportin, Ligjit Kundër Huliganizmit në Sport, Ligjit për Sponsorizime dhe Donacione, Ligjit për Menaxhimin e Objekteve Sportive, si dhe hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sportit do të jenë ndër prioritetet e Qeverisë në sektorin e sportit. Gjithashtu, Qeveria do të punojë edhe në akte të tjera normative, siç është Rregullorja për kategorizimin e sportistëve dhe Rregullorja për kategorizimin e sporteve, si dhe në rregullore të tjera të rëndësishme për zhvillimin dhe mbështetjen e sportit.

Rritja e mbështetjes financiare për KOK, KPK dhe federatat e sportit: Buxheti për Komitetin Olimpik, Komitetin Para-olimpik dhe federatat do të rritet. Nëpërmjet kategorizimit do të mundësohet ndarja e buxhetit vjetor për federatat. Kjo mbështetje, përveç në organizim të aktiviteteve të ndryshme sportive, do të shtrihet më dukshëm në përkrahjen e Përfaqësueses së Kosovës në sporte të ndryshme.

Avancimi i mëtejshëm i sportit shkollor dhe universitar: Qeveria e Kosovës do ta trajtojë me prioritet të veçantë sportin shkollor dhe atë universitar. Tash e tre vjet mbahen gara në nivel nacional në shkolla dhe universitete. Mbështetja për këto gara do të rritet me qëllim të masivizimit të sportit dhe promovimit të talentëve.

Themelimi i Agjencisë Anti-Doping të Kosovës: Një nga kriteret ndërkombëtare është që të themelohet Agjencia Anti-Doping. Qeveria e Kosovës bashkë me të gjithë akterët e tjerë të sportit dhe shkencës do të themelojë këtë agjenci dhe do të garantojë funksionim të plotë të saj, me qëllim të zhvillimit të garave profesionale, sipas standardeve ndërkombëtare.

Funksionalizimi i mjekësisë sportive: Qeveria e Kosovës do të funksionalizojë Mjekësinë Sportive, si një kusht shumë të rëndësishëm për zhvillimin e garave. Qeveria do të ndajë buxhet për kushte moderne në mjekësinë sportive dhe do të mundësojë trajtime për të gjithë sportistët. Nëpërmjet akteve normative do të përcaktohet qartë roli i saj dhe organet përgjegjëse për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e saj.

Promovimi i sportit rekreativ dhe sportit për të gjithë: Qeveria e Kosovës do të promovojë sportin për të gjithë dhe sportin rekreativ nëpërmjet investimeve në infrastrukturë përcjellëse dhe në terrene sportive, promovimit të sportit shkollor dhe universitar, si dhe

nëpërmjet rritjes së fondeve për fushata të ndryshme vetëdijesuese, si elementë të rëndësishëm për shëndetin e shoqërisë.

Mbështetja e sportistëve kulminantë nëpërmjet shpërblimeve shtetërore: MKRS-ja ka miratuar Rregulloret për shpërblimet shtetërore për sportistët kulminantë dhe deri më tash ka ndarë shpërblime për sportistët që kanë fituar medalje në kampionate evropiane dhe botërore. Qeveria e Kosovës do të plotësojë këtë rregullore, duke përfshirë shpërblimet edhe për medaljet e fituara në lojërat mesdhetare.

Ndarja e bursave për shpresat olimpike dhe e pensioneve sportive për sportistët meritore: Qeveria e Kosovës ka miratuar para dy vitesh Rregulloren për ndarjen e bursave për shpresat olimpike. Gjatë vitit 2014 janë dhënë 10 bursa për shpresat olimpike në vlerë prej mbi 18 mijë euro. Numri i bursave do të rritet nga viti në vit, e po ashtu do të aplikohen edhe forma të tjera të mbështetjes për shpresat olimpike, në veçanti në edukim. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës do të zgjerojë mbështetjen për pensione duke përfshirë pensione edhe për sportistët që kanë fituar medalje në lojërat mediterane.

4.4.2. Modernizimi i infrastrukturës sportive

Ndërtimi i Stadiumit Kombëtar të Futbollit: Në vitin 2014, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndërtimin e Stadiumit Kombëtar të Futbollit me kapacitet deri në 30 mijë ulëse. Ky stadium modern do të ndërtohet në Prishtinë. Qeveria e Kosovës, nëpërmjet MKRS-së, ka paraparë buxhetin për vitin 2015 për fillimin e ndërtimit të këtij stadiumi. Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës do të fillojmë procedurat për ndarjen e lokacionit, dhe më pastaj do të vazhdohet me procedura të tjera të shpalljes së konkursit për projektim dhe më pas të atij për ndërtim.

Ndërtimi i Pallatit Olimpik: Pallati Olimpik është objekti në të cilin do të kenë selinë Komiteti Olimpik i Kosovës, Komiteti Para-olimpik dhe mbi 30 federata. Me këtë, organizatat sportive e zgjidhin përfundimisht çështjen e hapësirës administrative. Projekti është përzgjedhur nëpërmjet një konkursi publik dhe nga fillimi i vitit 2015 do të fillojnë procedurat për ndërtimin e tij. Për Pallatin Olimpik, Komuna e Prishtinës ka ndarë lokacionin.

Ndërtimi i palestrave sportive të reja nëpër komuna dhe renovimi i atyre ekzistuese: Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me ndërtimin e Palestrave Sportive nëpër komuna me qëllim të krijimit të kushteve moderne për gara sportive në shumë sporte. Tash janë në proces ndërtimi i palestrave në Kamenicë, Istog, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Klinë dhe Kaçanik. Ndërkaq, do të ndërtohen Palestra Sportive edhe në Viti, Dragash dhe në komuna të tjera. Po ashtu, Qeveria e Kosovës do të ndajë fonde të veçanta për renovimin e palestrave ekzistuese me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillimin e garave.

Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse të futbollit nëpër komuna: Në bashkëpunim me Komisionin Evropian në vitin 2012 ka filluar ndërtimi i gjashtë stadiumeve ndihmëse. Ato janë në përfundim e sipër. Stadiumet janë moderne dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Në

vitin 2015, Qeveria e Kosovës me fonde të veta do të fillojë ndërtimin edhe të tri stadiumeve të tjera ndihmëse në Prizren, Istog dhe në Skenderaj. Stadiume të ngjashme do të ndërtohen edhe në vitet e ardhshme gjatë mandatit qeverisës.

Ndërtimi i poligoneve sportive dhe i terreneve të tenisit nëpër komuna: Promovimi i sportit në tërë Kosovën është një prioritet i Qeverisë së Kosovës. Për ta realizuar këtë është i nevojshëm ndërtimi i poligoneve sportive për futboll, basketboll, hendboll dhe volejboll. Deri më tani janë ndërtuar dhjetëra sosh në fshatra dhe qytete të ndryshme të Kosovës, kryesisht në shkolla ose në afërsi të shkollave. Një politikë e veçantë, duke parë interesimin dhe potencialin e të rinjve është edhe fokusimi në tenis. Do të ndërtohen terrene të sportit të tenisit në disa komuna të Kosovës, e po ashtu do të investohet edhe në renovimin e atyre ekzistuese.

Ndërtimi i Pishinës Olimpikë në Prishtinë: Me pranimin e Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, do të zgjerohen mundësi të shumta për sportistët tanë. Një nga sportet ku ka interesim dhe talentë është noti dhe disiplina të ndryshme të sportit në ujë. Në këtë rrafsh, Qeveria e Kosovës do të ndajë mjete financiare për ndërtimin e Pishinës Olimpikë në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës.

Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Prishtinë dhe i stadiumeve të tjera ekzistuese: Prishtina si kryeqytet i Kosovës ka shumë nevojë të ketë një stadium me kushte moderne për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare në futboll. Qeveria e Kosovës ka investuar në renovimin e Stadiumit Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë dhe për vitin 2014 kishte paraparë renovime të mëdha edhe në stadiumin e qytetit në Prishtinë. Qeveria do të kërkojë që Komuna dhe shfrytëzuesi të finalizojnë projektin në mënyrë që të investohen fillimisht 500 mijë euro dhe ky stadium të ketë kushte moderne ku mund të luhen ndeshje ndërkombëtare në futboll, deri në përfundimin e ndërtimit të Stadiumit Kombëtar të Futbollit, sipas standardeve të UEFA-së dhe FIFA-së. Po ashtu, do të vazhdohet me renovimin e stadiumeve ekzistuese të futbollit edhe në komuna të tjera.

5. SHËNDETËSI MODERNE

Vazhdimi i përmirësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës do të jetë me prioritet të lartë qeveritar gjatë këtij mandati, duke synuar ndërtimin e një sistemi shëndetësor efikas, të mbështetur në resurse të qëndrueshme njerëzore dhe me një financim adekuat të qëndrueshëm, që siguron qasje të barabartë në shërbime cilësore dhe kosto-efektive shëndetësore për të gjithë qytetarët. Që të arrihet kjo, reforma e sistemit shëndetësor do të jetë e qëndrueshme dhe e vazhdueshme duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, si dhe në politikat për përmirësimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve bazuar në nevojat e popullatës dhe në përputhje të plotë me standardet e Bashkësisë Evropiane, për t'u siguruar qytetarëve shërbime shëndetësore të krahasueshme me popujt e rajonit dhe më gjerë. Nën këtë prizëm, reforma e sistemit shëndetësor do të konsistojë në funksionalizimin më të mirë të sistemit shëndetësor me qytetarin në qendër të vëmendjes, ngritjen e efikasitetit të institucioneve shëndetësore në të gjitha nivelet, përmirësimin e infrastrukturës së hapësirave dhe mjeteve të funksionimit, funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, shfrytëzimit optimal të resurseve profesionale në dispozicion nëpërmjet integritit të shërbimeve shëndetësore në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale në kuptim të rritjes së përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies së strukturave menaxheriale.

Baza kryesore mbi të cilën do të mbështeten reformat e sistemit shëndetësor do të jetë fillimi i funksionalizimit të sigurimeve shëndetësore nga viti i ardhshëm. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se funksionalizimi i plotë i këtij sistemi kërkon kohë, Qeveria në 2 vitet e para do të rrisë ndjeshëm financimin e sistemit shëndetësor publik duke synuar ngritjen e shpenzimeve publike për shëndetësi për kokë banori në nivelin e mesatares së vendeve të rajonit.

5.1. Prioritetet

Me prioritet të lartë qeveria do të angazhohet në zbatimin e reformës përmbajtësore dhe gjithëpërfshirëse në sektorin e shëndetësisë, të bazuar në Strategjinë sektoriale të Shëndetësisë 2014 - 2020 dhe moton e Bashkësisë Evropiane në sektorin e shëndetësisë "Politikat shëndetësore në të gjitha politikat". Synim kryesor i kësaj reforme është sigurimi i qasjes universale në shërbime cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit, si dhe promovimi i gjithëpërfshirjes, si bazë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore.

Ndryshimi i sistemit të financimit të sektorit të shëndetësisë, nga modeli i centralizuar buxhetor në modelin e kombinuar të financimit nga buxheti, sistemi publik dhe privat i sigurimeve shëndetësore, që do të arrihet me themelimin dhe funksionalizimin e Fondit Publik të Sigurimeve Shëndetësore, përveç tjerash, do të mundësojë:

- Rritjen e buxhetit për Shërbimin Spitalor e Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) përfshirë: QKUK-në, spitalet e përgjithshme rajonale, dhe institucionet e tjera shëndetësore të nivelit sekondar dhe terciarë;
- Rritjen e Grantit Specifik të Shëndetësisë për komunat;

- Sigurimin dhe furnizimin 100% me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Lista Esenciale e Barnave dhe Materialit Shpenzues, që do të përpilohet në pajtim me standardet përkatëse ndërkombëtare si dhe vlerësimin real të nevojave;
- Funkcionalizimin e plotë të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) në bashkëpunim me partnerët zhvillimorë;
- Përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe resurseve profesionale;
- Fuqizimin e kapaciteteve diagnostikuese, me theks të veçantë në lëminë e radiologjisë dhe të laboratorit (investimi në pajisje mjekësore të reja dhe moderne; mirëmbajtja dhe servisimi i tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare);
- Përmirësimin e kushteve të punës dhe stimulimin financiar të profesionistëve shëndetësorë në bazë të performancës;

Ndër prioritet kryesorë në këtë mandat qeverisës në fushën e shëndetësisë do të jenë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i Fondit Publik të Sigurimeve Shëndetësore nga Agjencia e Financimit Shëndetësor si paraardhës i këtij Fondi;
- Riorganizimi i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe ridefinimi i raporteve me Fakultetin e Mjekësisë, mundësia e themelimit të Spitalit të Prishtinës dhe shndërrimin e QKUK-së në institucion të mirëfilltë që ofron shërbime shëndetësore terciare, edukative, hulumtuese dhe shkencore;
- Funksionalizimi i plotë i Departamentit të Kardiologjisë Invazive dhe Kardiokirurgjisë, dhe furnizimi i rregullt me material të nevojshëm shpenzues mjekësor i këtyre departamenteve;
- Ndërtimi i Qendrës Emergjente të QKUK-së;
- Ndërtimi i Qendrës për Kirurgji të Fëmijëve dhe Trajtim të Sëmundjeve Malinje të Fëmijëve në QKUK;
- Fuqizimin e kapaciteteve diagnostikuese të të gjitha niveleve të institucioneve shëndetësore;
- Parandalimi, zbulimi i hershëm dhe trajtimi i sëmundjeve malinje nëpërmjet themelimit dhe funksionalizimit të Shërbimit Profesional Kombëtar të Onkologjisë, që do të zhvillojë programe ndërlidhëse me institucionet shëndetësore në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor, me theks të veçantë në kancerin e gjirit, kancerin e qafës së mitrës, dhe kancerin kolo-rektal, përfshirë programet e skringut të grup-moshave të caktuara të popullatës;
- Zhvillimin e programeve preventive dhe terapeutike, veçanërisht për zvogëlimin e sëmundjeve dhe vdekshmërisë së foshnjave/fëmijëve dhe nënave, nëpërmjet themelimit dhe funksionalizimit të Shërbimit Profesional Kombëtar për Nëna dhe Fëmijë;;
- Parandalimi i sëmundjeve dhe çrregullimeve, nëpërmjet promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe zbulimit të hershëm të tyre, me përqendrim në grupmoshat e reja dhe kategoritë e rrezikuara nga sëmundjet që mund të parandalohen.
- Vazhdimi i përkrahjes së trajtimit të fëmijëve që vuajnë nga leukemia si dhe sëmundjet tjera malinje jashtë vendit.

5.2. Reformimi i Ministrisë së Shëndetësisë

Sistemi i ri shëndetësor i vendit do të mbështetet në Ministrinë e riorganizuar të Shëndetësisë të fuqizuar në rolin e saj politikbërës, rregullator, vlerësues dhe monitorues, si dhe funksionalizimin e plotë të institucioneve të reja, siç janë: Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe SHSKUK-ja, si formë e integruar e shërbimeve në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

5.3. Financimi i sektorit të shëndetësisë

Duke pasur parasysh faktin se resurset financiare në dispozicion për shërbimet shëndetësore publike nuk plotësojnë nevojat dhe kërkesat e popullatës për shërbime cilësore shëndetësore, Qeveria do të realizojë reformën e financimit të sektorit të shëndetësisë. Qeveria do të themeloj modelin miks të financimit, nga Buxheti i Kosovës dhe nga Fondi Publik i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit, në pajtim me Ligjin për Sigurime Shëndetësore dhe me mbështetjen e programit të veçantë financiar të Bankës Botërore dhe programit donator të Qeverisë zvicerane.

5.4. Individit në qendër të vëmendjes

Bazë e programit do të jetë zhvillimi i të gjitha niveleve të sistemit shëndetësor, si pjesë të një tërësie, të cilat e ndihmojnë njëra-tjetrën dhe e kompletojnë shërbimin shëndetësor. Në orientimet programore të të gjitha niveleve shëndetësore, qytetari do të jetë në qendër. Të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe është e papranueshme që zonat e thella rurale të janë të privuara nga shërbimi mjekësor dhe karakterizohen nga mungesa të theksuara të infrastrukturës shëndetësore. Qeveria zotohet të kanalizojë më shumë fonde për këto zona të lëna pas dore dhe të mundësojë subvencione për personelin mjekësor të mirë kualifikuar, që të shërbejë në zona të thella rurale dhe periferike. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet kategorive vulnerable të shoqërisë, siç janë: fëmijët, të moshuarit, të sëmurët nga kanceri dhe kategoritë në gjendje të rëndë sociale.

5.5. Menaxhimi dhe llogaridhënia

Qeveria do të angazhohet për një menaxhim të integruar të shëndetësisë në të gjitha nivelet, me sisteme të qarta dhe efikase të referimit. Gjithashtu, do të angazhohet për shpërndarje adekuate të infrastrukturës dhe të kuadrit mjekësor në të gjithë territorin e vendit, arritje të standardeve ndërkombëtare sa i përket numrit të personelit mjekësor në raport me popullsinë, decentralizim dhe autonomi menaxheriale të institucioneve shëndetësore. Menaxhimi i përmirësuar me resurset njerëzore do të realizohet nëpërmjet Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, si organe kredibile përfaqësuese të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, infermierëve, dhe fizioterapeutëve.

Ministria e Shëndetësisë do të monitorojë për së afërmi periudhën e bartjes së kompetencave përkatëse në pajtim me Ligjin. Në funksion të eliminimit të dukurive të korrupsionit brenda sektorit të shëndetësisë do të fuqizohet komunikimi i drejtpërdrejtë dhe sistematik i Ministrisë së Shëndetësisë me qytetarët dhe shoqatat e pacientëve nëpërmjet linjave të drejtpërdrejta telefonike, si dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve adekuate që shkojnë në funksion të

ngritjes së përgjegjesisë dhe llogaridhënies. Qeveria do të përpilojë Strategjinë e prokurimit dhe auditimit në sektorin e shëndetësisë si dhe Planin e Zbatimit të sajë, në bashkëpunim me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës veprim i cili shkon në funksion të sigurimit të shfrytëzimit optimal të parasë publike.

5.6. Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse

Qeveria do të angazhohet për institucione kompetente të shëndetësisë publike, të cilat me profesionalizëm dhe qasje multidisiplinare do të angazhohen për ruajtjen e shëndetit publik, parandalimin dhe sanimin e vatrave endemike të sëmundjeve ngjitëse, kontrollin e rregullt të ujit, ajrit, ushqimit dhe parametrave të tjerë të shëndetit publik. Në këtë fushë aktivitete të veçanta dhe sistematike do të zbatohen ndaj problemit të veçantë endemik epidemiologjik të Etheve Hemoragjike Kongo Krime (EHCC) në katër komunat e vendit që paraqesin nivel të lartë të goditjes nga këto sëmundje, në pajtim me Strategjinë përkatëse nacionale; si dhe ndaj kërcënimit nga sëmundja e shkaktuar më virusin Ebola për çka do të mbështeten me prioritet aktivitetet e Këshillit Ndërmnistror të ngritur për këtë qëllim.

5.7. Edukimi dhe shkollimi specialistik dhe sub-specialistik

Qeveria është e ndërgjegjshme që shkenca e mjekësisë është një ndër shkencat që evaluon me një dinamikë të shpejtë, prandaj është domosdoshmëri investimi në kualifikimin dhe përditësimin e burimeve njerëzore me njohuri dhe praktika të reja. Në këtë prizëm, kujdes i veçantë do t'i kushtohet programit shtetëror të shkollimit specialistik dhe sub-specialistik të kuadrove profesionale jashtë vendit, në institucione të mirënjohura shëndetësore të rangut ndërkombëtar, me të cilat Ministria e Shëndetësisë ka Marrëveshje të Bashkëpunimit. Për këtë qëllim do të krijohet edhe një fond i veçantë i bursave për studime në fushën e mjekësisë në universitete perëndimore si dhe mbështetje të projekteve të hulumtimeve shkencore. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale, Qeveria e Republikës së Kosovës angazhohet që të krijojë kushte optimale për profesionistët e shumtë shëndetësorë me origjinë nga Kosova, tanimë të afirmuar në vendet e zhvilluara të Evropës dhe Amerikës, që me ekspertizën dhe projektet e tyre të kontribuojnë për reformimin dhe zhvillimin e shëndetësisë në Kosovë.

5.8. Edukimi publik shëndetësor

Duke pasur parasysh që përgjegjësia kryesore për të qëndruar të shëndetshëm i takon vetë qytetarëve, qeveria më shumë vëmendje, dhe duke venë në dispozicion burime të shumta, do t'i kushtojë parandalimit të sëmundjeve të ndryshme dhe edukimit të publikut. Një qasje e tillë do të ndërmerret në bashkëpunim me organizatat joqeveritare që realizojnë aktivitete në lëmin e shëndetësisë. Për këtë synim, do të hartohen politika që mundësojnë pajisjen e publikut me më shumë informacion për t'i inkurajuar dhe edukuar për një jetë të shëndetshme si masë parandaluese dhe inkurajim i përdorimit të terapive rigjeneruese e konvaleshence, nëse janë të sëmurë kronikë ose persona në risk.

5.9. Sektori farmaceutik

Në sektorin farmaceutik parashihen reforma përmbajtësore me ngritjen e kapaciteteve politikëbërëse, rregullatore, vlerësuese, dhe inspektuese të Agjencisë së Kosovës për

Produkte Medicinale, shqyrtimin e vazhdueshëm të Listës Esenciale të Barnave dhe materialit harxhues, formulimin e politikave të reja për prokurimin e barnave të bazuara në vlerësimin real të nevojave dhe planifikimin adekuat dhe me kohë, decentralizimin e furnizimit me barna nga Ministria e Shëndetësisë në vetë institucionet shëndetësore me një qasje llogaridhënëse nga ana e institucioneve shëndetësore. Po ashtu do të bëhet riorganizimi i menaxhmentit farmaceutik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike për ruajtjen e shëndetit publik, Qeveria do të monitorojë qarkullimin e barnave dhe produkteve medicinale në tregun e Kosovës, në pajtim me standardet më të larta të Bashkësisë Evropiane.

5.10. Licencimi dhe Akreditimi i institucioneve shëndetësore

Në pajtim me Ligjin për Shëndetësi dhe duke pasur parasysh nevojën e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, Qeveria do të punojë në krijimin e ambientit të favorshëm për fillimin e Licencimit dhe Akreditimit për herë të parë në Republikën e Kosovës të shërbimeve shëndetësore sipas standardeve ndërkombëtare.

5.11. Zhvillimi i partneritetit dhe dialogu social

Vëmendje të veçantë Qeveria do ti kushtojë zhvillimit të partneritetit dhe dialogut social me Federatën e Sindikatave Shëndetësore të Kosovës, si nënshkruese e Kontratës sektoriale me Ministrinë e Shëndetësisë, me theks të veçantë në sigurimin e realizimit të plotë të të drejtave të punëtorëve të përcaktuara me Legjislacionin në fuqi, Kontratën Kolektive të Qeverisë së Kosovës, si dhe Kontratën sektoriale me Ministrinë e Shëndetësisë. Qeveria ndërmerr këtë veprim me synimin e arritjes së standardeve më të larta etike dhe profesionale të punëtorëve shëndetësorë në relacion me pacientët dhe qytetarët. Qeveria, po ashtu, do të synojë fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat në sektorin joqeveritar, në vend dhe jashtë tij, veçanërisht me shoqatat të cilat përfaqësojnë interesat e pacientëve, si mënyrë për ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe shërbimeve të veçanta për grupet vulnerable të qytetarëve në mënyrën më kosto-efektive, me theks të veçantë promovimin e mënyrave të shëndosha të jetesës si forma më efektive për parandalimin e sëmundjeve.

Qeveria në mënyrë të vazhdueshme do të angazhohet të përmbushë obligimet që dalin nga Strategjia Kombëtare për persona me nevoja të veçanta; si dhe do të ndërmerr aktivitete të veçanta për sigurimin e shërbimeve cilësore shëndetësore dhe me qasje të lehtë për komunitetin Romë, Ashkali, dhe Egjiptas. Përkushtim i veçantë do të kenë aktivitetet për integrimin e plotë në sistemin shëndetësor të vendit të shërbimeve shëndetësore në komunat me shumicë të komunitetit serb.

5.12. Sektori privat

Sektori publik dhe ai privat në shëndetësi nuk duhet të shihen si përjashtues/zëvendësues të njëri-tjetrit, por si dy sisteme që e komplementojnë njëra-tjetrën. Institucionet shëndetësore private do të kenë trajtim të barabartë konkurrues dhe komplementar në sistemin shëndetësor në të mirë të qytetarit. Qeveria do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar se institucionet shëndetësore private zbatojnë me përpikëri gjithë legjislacionin e vendit që rregullon këtë sektor në funksion të ofrimit të shërbimeve shëndetësore kualitative. Suksesi i

arritur në sektorin e farmaceutikëve dhe shërbimit dentar, që është në duar private, ka dëshmuar se nxitja e nismës private në fusha të tjera të sektorit të shëndetësisë, nuk do të shërbejë vetëm për të ulur barrën e buxhetit për këtë sektor si dhe ngarkesën e sektorit shtetëror të shëndetësisë, por edhe do të mundësojë më shumë ofertë, më shumë konkurrencë me më shumë cilësi e çmime të leverdishme.

5.13. Orientimet programore sipas niveleve të shërbimeve shëndetësore

Niveli parësor:

- Implementimi i konceptit të Mjekësisë Familjare - hartimi i një plani të veprimit për sigurimin e numrit të mjaftueshëm të specialistëve të Mjekësisë Familjare për secilën komunë; sipas nevojës edhe stimulimi i mjekëve nga ana e komunave për kryerjen e specializimit të MF-së;
- Sigurimi i shërbimeve unike parësore në të gjitha komunat;
- Përcaktimi i pakos bazike të shërbimeve shëndetësore të ofruara në KPSH;
- Fuqizimi i kapaciteteve diagnostikuese, me theks të veçantë në lëmin e radiologjisë dhe të laboratorit (investimi në pajisje mjekësore të reja dhe moderne);
- Fuqizimi i shërbimeve emergjente para spitalore;
- Motivimi dhe stimulimi i komunave për themelimin/fuqizimin e shërbimit shtëpiak/ofrimi i shërbimeve shëndetësore shtëpiake paliative për grupet vulnerable (personat me nevoja të veçanta, pacientët me sëmundje të rënda kronike, ata me sëmundje malinje, si dhe të moshuarit);

Niveli dytësor:

- Themelimi i Spitalit të Prishtinës, si një nga prioritetet kryesore;
- Decentralizimi dhe autonomia menaxheriale e këtyre institucioneve shëndetësore brenda sistemit të integruar të SHSKUK-së;
- Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve/resurseve profesionale;
- Fuqizimi i kapaciteteve diagnostike;
- Standardizimi dhe racionalizimi i pajisjeve mjekësore;
- Zhvillimi dhe implementimi i protokolleve standarde /unike; ofrimi i shërbimeve shëndetësore unike në të gjitha spitalet (institucionet e nivelit dytësor) e Kosovës; aty ku ka mundësi-kapacitete, fuqizimi i shërbimeve të caktuara - zhvillimi i ekspertizës në lëmi të caktuara për të ofruar shërbime të subspecializuara.

Niveli tretësor – QKUK-ja:

- Riorganizimi i QKUK-së përfshirë edhe mundësinë e themelimit të Spitalit të Prishtinës brenda QKUK-së;
- Shndërrimi i QKUK-së në institucion të mirëfilltë të nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor që përveç shërbimeve shëndetësore ofron edhe shërbime edukative, hulumtuese dhe shkencore;
- Përfshirja e gjithë personelit shëndetësor në procesin mësimor edukativ me titull akademik klinik apo shkencor (në koordinim me MASHT-in);
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe furnizimi me pajisje mjekësore; mirëmbajtja dhe servisimi i tyre në përputhje me standardet evropiane;

- Nevojë imediate - zhvillimi i kapaciteteve menaxheriale në kuptim të rritjes së përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies së strukturave menaxheriale.

5.14. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Përveç sigurimit të koordinimit të plotë me komunitetin e donatorëve në sektorin e shëndetësisë të vendit, Qeveria do të angazhohet për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe Rrjetin Shëndetësor të Evropës Juglindore, si dhe pjesëmarrjen e sajë aktive në bashkëpunime bilaterale dhe multilaterale në fushën e shëndetësisë ndërkombëtare.